



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 205 Akti

Nr. 304 Vendimi
Tiranë, më 6.10.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Etleđa Çiftja	Relatore
Firdes Shuli	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datën 2.10.2020, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Neritan Cena**, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet “A”, “Ç”, “D”, “DH”, “E” dhe “Ë” të Aneksit të Kushtetutës;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, z. Neritan Cena, dhe pasi

shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Z. Neritan Cena është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në momentin e shortimit, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar” dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

2. Z. Neritan Cena, bazuar në nenin 14, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit duke u shortuar në datën 15.11.2018, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët: Roland Ilia, Etleda Çiftja dhe Firdes Shuli.

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31–33, të ligjit nr. 84/2016, nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 – 39, të ligjit nr. 84/2016, si dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim referuar si KLGJ), sipas neneve 40 – 44, të ligjit nr. 84/2016.

4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni) me vendimin nr. 1, datë 26.11.2018, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesues të trupit gjykues, komisionerin Roland Ilia. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Në datën 19.2.2019, me anë të postës elektronike¹, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) fillimin e procesit të rivlerësimit; (ii) anëtarët e trupit gjykues të shortuar për të zhvilluar procesin e rivlerësimit; (iii) deklarin nëse ishte në kushtet e konfliktit të interesit me ndonjë nga anëtarët e trupit gjykues; si dhe (iv) përgjigjet e pyetjeve të pyetësorit standard, me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave, që kanë lidhje me procedurat e rivlerësimit.

5. Trupi gjykues, me vendimin nr. 2, në datën 8.9.2020, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Neritan Cena, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, referuar nenit 52, të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në

¹ E-mail datë 19.02.2019, ora 2:55, “Komisioni – njoftim për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe kërkesë për informacion shtesë”.

përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, dhe me nenet 45 – 47 dhe 35 – 40, të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarimin e konfliktit të interesit, me të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

6. Në datën 9.9.2020, përmes postës elektronike², trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën, brenda datës 22.9.2020; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, dhe me nenet 45 – 47 dhe 35 – 40, të Kodit të Procedurave Administrative. Subjekti i rivlerësimit nuk u paraqit për t'u njohur me dosjen e hetimit.

9. Në datën 17.9.2020, subjekti i rivlerësimit, përmes postës elektronike, kërkoi kohë shtesë për të paraqitur shpjegimet dhe provat në mbështetje të barrës së provës, kaluar me relacionin mbi rezultatet e hetimit kryesisht, pra, më shumë kohë se data e përcaktuar më 9.9.2020, duke qenë se priste një dokument nga shteti austriak.

10. Në datën 22.9.2020, subjekti i rivlerësimit, përmes postës elektronike³, paraqiti shpjegimet kaluar me relacionin mbi rezultatet e hetimit kryesisht, bashkë me prova të reja në mbështetje të barrës së provës.

11. Në vendimin nr. 3, datë 24.9.2020, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Neritan Cena, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u njoftua përmes postës elektronike se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 2.10.2020, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, kati 0, Tiranë. Ky vendim për ftesë në seancë dëgjimore iu dërgua subjektit me anë të postës elektronike⁴ së bashku me njoftimin se Komisioni pranon kërkesën për shtyrje afati, pasi subjekti do të merrte një dokument nga shteti austriak, duke i lënë kohë deri ditën e seancës dëgjimore më 2.10.2020.

12. Bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Neritan Cena, bazuar në të tri kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës, si dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

II. SEANCA DËGJIMORE

14. Në datën 2.10.2020, ora 10:00, u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit, si edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në seancë.

15. Relatori i çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryer mbi të tria kriteret e rivlerësimit dhe të kaluara si barrë prove, apo për shpjegime.

² E-mail, datë 9.9.2020, ora 14:48: "Komisioni – njoftim mbi përfundimin e hetimit kryesisht për procesin e rivlerësimit".

³ E-mail datë 22.9.2020, ora 11:32: "Re: Komisioni – njoftim mbi përfundimin e hetimit kryesisht për procesin e rivlerësimit".

⁴ E-mail datë 24.9.2020, ora 16:18: "Komisioni – Ftesë për seancë dëgjimore".

16. Z. Neritan Cena shprehu qëndrimin e tij pasi dëgjoi relacionin, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij.

17. Në seancën dëgjimore të datës 2.10.2020, subjekti i rivlerësimit, z. Neritan Cena, kërkoi konfirmimin në detyrë. Seanca për pretendimin e subjektit u ndërpre për të rifilluar në datën 6.10.2020.

18. Në përfundim të seancës së datës 6.10.2020, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi ta konsiderojë të përfunduar procesin e rivlerësimit për subjektin Neritan Cena, si dhe shpalli vendimin e trupit gjykues.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

19. Subjekti i rivlerësimit, z. Neritan Cena, ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit në përputhje me nenin 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

20. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” sipas kreut IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”: (i) ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror; (ii) DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit; (iii) KLGj-ja është organi përkatës i vlerësimit profesional, i cili përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pasi përfundon shqyrtimi i dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe përzgjedhja e pesë dokumenteve sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

21. Referuar vendimit nr. 2/2017⁵, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli

⁵ Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2, të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1, të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

V. RIVLERËSIMI I PASURISË

A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

22. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Neritan Cena, e cila është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2004, me nr. indeksi *** dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

23. Subjekti ka dorëzuar deklaratat e interesave private për vitet 2004 – 2016 dhe në datën 25.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016 ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar, *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personave të lidhur, është konstatuar:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimet e pasurive;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

24. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*, të vitit 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI për vitet 2004–2016; (ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit dhe, në vijim, deri ditën e seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit; (e) deklaratimet në seancë dëgjimore

25. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar në pikën 5, të nenit 33, ligjit nr. 84/2016.

Personat e lidhur apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit që janë hetuar

Për efekt të procesit të rivlerësimit personat që janë hetuar si të lidhur të përfshirë në certifikatën familjare apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit janë konsideruar: **(1)** znj. S.C./person i lidhur, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit; **(2)** z. B.C. (babai) – konsiderohet person tjetër i lidhur si rezultat i dhënies së huas në shumën 250.000 lekë në vitin 2011 dhe 3.400 euro në vitin 2018; dhurimit të shumës 550.000 lekë dhe 22.757 euro; deklarimit të jetesës së përbashkët gjatë periudhës 1.5.2012 – 1.11.2016; **(3)** znj. E.C. (motra) – konsiderohet person tjetër i lidhur si rezultat i dhurimit të shumës 16.150 euro; **(4)** znj. E.Sh. (kunata) – konsiderohet person tjetër i lidhur si rezultat i dhënies së huas në shumën 9.000 euro; **(5)** z. F.C. (kushëri) – konsiderohet person tjetër i lidhur si rezultat i dhënies së huas në shumën 2.000 euro; **(6)** znj. M.Sh. dhe z. A.Sh. (kunata dhe bashkëshorti) – konsiderohen persona të tjerë të lidhur si rezultat i dhënies së huasë në shumën 8.988 euro dhe 5.400.000 lekë

Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur

1. Pasuri e paluajtshme – njësi tregtare, në B., Gjermani, me vlerë 25.000 euro.

1.1. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: blerë në datën 15.12.2015 nga S. I., GmbH, me anë të kontratës me nr. regjisri ***, të lidhur para noterit publik L. W., me seli në B., Gjermani, pasuria e paluajtshme e përshkruar, si vijon: **(a)** 30/100 pjesë e pronës në bashkëpronësi në truallin në rajonin V., L. ***, korridori ***, pjesa 34/300 M.S. ***, sipërfaqe godine dhe e lirë sip. 256 m²; **(b)** 1/44 pjesë e pronës në bashkëpronësi në truallin në rajonin V., L. ***, korridori ***, pjesa 34/173, K., rrugë, sip. 115 m²; **(c)** 1/44 pjesë në bashkëpronësi në truallin në rajonin V., L. ***, korridori ***, pjesa 34/132 në afërsi të B. W., rrugë, sip. 13 m². Vlera: 25.000 euro. Pjesa takuese: 100 %.

1.2. Si burim krijimi subjekti deklaron: **(a)** me anë të shumën prej 550.000 lekësh të përfituara nga babai me transfertën e datës 28.12.2015. Kjo shumë përbën kursime të babait të subjektit nga puna si mjek në Qendrat Shëndetësore K., Mal të Zi, Sh. dhe G.-Ç., Kukës; **(b)** me anë të shumës prej 22.757 euro të përfituara si dhuratë nga babai me transfertën e datës 19.1.2016. Kjo shumë është përfituar nga shitja e një banese në Kukës me kontratën e datës 30.12.2015, në vlerën 22.910 euro.

1.3. Subjekti për vërtetimin e deklarimeve të tij ka paraqitur dokumentacion ligjor provues⁶.

⁶ Kontratë shitblerje për një pjesë pasurie (njësi tregtare) regjistruar me nr. *** regjistri, datë 15.12.2015; vërtetim përkthimi nr. *** datë 31.12.2015; kërkesë për transfertë fondesh, datë 22.2.2016, nëpërmjet “Raiffeisen Bank”; njoftim debitimi i “Raiffeisen Bank”, datë 19.1.2016; njoftim debitimi i “Raiffeisen Bank”, datë 28.12.2015; shkresë datë 18.2.2016 e avokatit/noterit L.W., + vërtetim nr. ***, datë 2.3.2016 për konfirmim përkthimi; nxjerrje llogarie e z. Neritan Cena në “Raiffeisen Bank”, datë 13.1.2017; kërkesë për transfertë fondesh, datë 14.1.2016, nëpërmjet NBG-së; njoftim debitimi i NBG-së, datë 14.1.2016; nxjerrje llogarie në NBG, e z. B.C., pagesa e swiftit për transfertën e llogarisë në NBG; deklaratë noteriale nr. ***, datë 9.1.2016, për plotësim kushti të kontratës së shitblerjes, datë 30.12.2015, nr. ***; kartelë pasurie për apartament me sip. 67.20 m² + hartë treguese e regjistrimit; kërkesë për transfertë fondesh, datë 7.1.2016 nëpërmjet NBG-së + mandati i depozitimit të shumës 8.500 euro + kursi i këmbimit në NBG, datë 7.1.2016; certifikatë për vërtetim pronësie, datë 21.8.2006; kontratë shitblerje nr. ***, datë 30.12.2015; prokurë e poasaçme nr. ***, datë 14.5.2013; dhe prokurë e poasaçme nr. ***, datë 23.12.2015.

1.4. Referuar dokumentacionit të dorëzuar në deklaratën *Vetting*, është lidhur kontrata e shitblerjes për një pjesë pasurie (njësi tregtare) regjistruar me nr. *** regjistri, datë 15.12.2015, në gjuhën gjermane dhe përkthyer në shqip, lidhur ndërmjet S. I. GmbH, përfaqësuar nga znj. S. R. R. – F., si palë shitëse dhe shtetasit Neritan Cena, përfaqësuar nga znj. E. G., si palë blerëse, me çmim 25.000 euro të pronës, si vijon: **(a)** 30/100 pjesë e pronës në bashkëpronësi në truallin në rajonin V. L ***, korridori ***, pjesa 34/300 M. S. ***, sipërfaqe godine dhe e lirë, sip. 256 m², e lidhur me pronën e veçantë të mjediseve që nuk shërbejnë për banim (emëruar nr.***) (*sipërfaqe korresponduese e subjektit 76.8 m²*); **(b)** 1/44 pjesë e pronës në bashkëpronësi në truallin në rajonin V. L ***, korridori ***, pjesa 34/173, K., rrugë, sip. 115 m²; **(c)** 1/44 pjesë në bashkëpronësi në truallin në rajonin V., L ***, korridori ***, pjesa 34/132 në afërsi të B. W., rrugë, sip. 13 m².

1.5. Sipas shkresës së datës 18.2.2016, së noterit L. W., subjekti i rivlerësimit në cilësinë e blerësit është njoftuar për transferimin e çmimit të blerjes në shumën 25.000 euro, në emër të S. I. GmbH, me përshkrimin: “*Çmimi i blerjes në kuadër të kontratës së shitblerjes me S. I. GmbH për Cena, sipas Ur – Nr. ****”.

1.6. Në dokumentacionin e administruar nga “Raiffeisen Bank”⁷, konstatohet se në datën 7.9.2016 nga llogaria e subjektit janë transferuar 25.068 euro (68.5 euro komisione) në favor S. I. GMBH, me përshkrimin: “*gift*” (në dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti në deklaratën *Vetting* është administruar urdhërshirimi bankar ku evidentohet se përshkrimi është – “*kaufpreises kaufvertrag S. I. GmbH an Cena Gemur-nr. ****” dhe burimi i fondeve “*dhuratë nga babai*”)

1.7. Në DPV-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar se në datën 15.12.2015, ka nënshkruar kontratë para noterit publik në Gjermani me nr. ***, për blerjen nga S. I. GmbH të 30/100 pjesë të një godine me sip. 256 m², të ndodhur në M. S. ***, B. Gjermani (blerë si banesë – përshkruhet në kontratë). Vlera: 25.000 euro (nuk është paguar çmimi deri më 31.12.2015). Pjesa takuese: 100 %.

1.8. Më tej, subjekti në DPV-në e vitit 2015, deklaroi përfituar nga babai shuma prej 550.000 lekësh, me transfertën bankare në datën 28.12.2015, në “Raiffeisen Bank”. Kjo shumë ka qenë gjendje në llogarinë e subjektit deri në datën 31.12.2015.

1.9. Ndërkohë, në DPV-në e vitit 2016, subjekti deklaroi se ka paguar në datën 22.2.2016, çmimin prej 25.000 euro, për blerjen nga shoqëria S. I. GmbH, të pasurisë së paluajtshme në zbatim të kontratës së lidhur me këtë të fundit nr. *** (*deklaruar në vitin 2015*). Burimi i krijimit është i njëjtë me atë që ka deklaruar në deklaratën *Vetting*.

1.10. Në përgjigje të pyetësorit standard 01⁸, subjekti deklaroi se këtë pasuri ia ka dhënë me qira shtetasit A.H. në shumën 970 euro/muaj, nga të cilat 665 euro përbën qiranë mujore bazë ndërsa shuma prej 144 euro paguhet për ngrohje dhe shuma prej 161 euro/muaj paguhet për shpenzime operacionale.

⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 22.2.2019.

⁸ E-mail datë 27.2.2019, ora 15:44.

1.11. Subjekti deklaron se duke qenë se nuk ka llogari bankare në shtetin Gjerman, qiraja e sipërcituar fillimisht është kaluar në llogarinë bankare të shtetasit E.M., i cili ka qenë në pozitën e përfaqësuesit të subjektit në lidhjen e kontratës, si dhe më pas dhe aktualisht kalohet në llogarinë bankare të shtetasit S.M. që ky i fundit ka në Postbank Gjermani me nr. ***.

1.12. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga qiraja gjatë vitit 2017, subjekti ka paguar tatimin pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë në vitin 2018 në shumën 159.141 lekë në zërin: *“Pagim i tatimit në burim për të ardhura të krijuara jashtë territorit të Shqipërisë”*. Pagesa pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë është bërë në respektim të: *“Marrëveshjes për shmangien e tatimit të dyfishtë të lidhur ndërmjet Shqipërisë dhe Gjermanisë”*. Në referim të kësaj marrëveshjeje tatimi mbi të ardhurat mund të paguhet edhe në vendin ku personi përfitues ka vendbanimin. Meqenëse vendbanimi subjekti është në Republikën e Shqipërisë ka zgjedhur që tatimin mbi të ardhurat e përfituara nga dhënia me qira e pasurisë ta paguajë në Republikën e Shqipërisë meqenëse këtu ka vendbanimin.

Lidhur me burimin e krijimit

i) Shuma prej 550.000 lekësh dhënë nga babai/personi tjetër i lidhur/ z. B.C.

1.13. Për të vërtetuar dhënien e shumës prej 550.000 lekësh, në deklaratën *Vetting* subjekti ka dorëzuar transfertën bankare të kësaj vlere në “Raiffeisen Bank”, kaluar në favor të subjektit nga personi tjetër i lidhur, z. B.C., në datën 28.12.2015, me përshkrimin: *“transfertë në llogarinë e djalit”*. Subjekti ka deklaruar se kjo shumë përbën kursime të babait nga puna si mjek në Qendrat Shëndetësore K., Mal të Zi, Sh. dhe G.-Ç., Kukës.

1.14. Në dokumentacionin e administruar nga “Raiffeisen Bank”⁹ konfirmohet kryerja e këtij transaksioni bankar.

1.15. Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor në përputhje me dispozitat e nenit 32, të ligjit nr. 84/2016 dhe të nenit të D, pika 3, të Aneksit të Kushtetutës, për të provuar burimin e shumës prej 550.000 lekësh.

1.16. Me anë të pyetësorit nr. 2¹⁰, subjektit iu kërkua të paraqesë të ardhurat e babait (nga pagat, shitje e pasurive të paluajtshme etj), numrin e personave të përbërjes familjare, si dhe shpenzime të kryera për jetesë apo dhe të tjera, nëse ka investuar në pasuri (të luajtshme, të paluajtshme, llogari bankare etj), me qëllim përlllogaritjen e mundësisë së tij për të dhënë hua apo për të dhuruar.

1.17. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2¹¹, në cilësinë e provës subjekti paraqiti dokumentet që vërtetojnë burimin e të ardhurave që ka përfituar si mjek në rrethin e Kukësit nga viti 1965 dhe në vazhdim¹². Gjithashtu, subjekti ka dorëzuar edhe të ardhurat e përfituara nga nëna, znj.

⁹ Shkresë nr. *** prot., dt. 22.2.2019.

¹⁰ E-mail, datë 30.4.2020, ora 12:52.

¹¹ E-mail, datë 11.5.2020, ora 10:45.

¹² Kopjen e transfertës bankare; vërtetim lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës, datë 21.11.2014; vërtetim nr. *** prot, datë 30.10.2014, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Kukës në të cilin përshkruhet se babai i subjektit, z,

E.C.¹³, për periudhën nga 1.10.1997 dhe në vazhdim. Më tej, subjekti deklaroi se të ardhurat e prindërve, ndër vite, janë shumë herë më të larta, por konsideron të mjaftueshme provat e paraqitura për të provuar mundësinë e babait për të dhënë shumën 550.000 lekë.

1.18. Si konkluzion, në lidhje me shumën prej 550.000 lekësh, dhënë nga babai i subjektit, si burim krijimi, Komisioni arrin në përfundimin se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar nga hetimi.

ii) Shuma prej 22.757 euro dhuratë nga babai/personi tjetër i lidhur, z. B.C.

1.19. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka dorëzuar transfertën bankare të “Raiffeisen Bank”, datë 19.1.2016, nga personi tjetër i lidhur, z. B.C., të shumës prej 22.757 euro, në favor/përfitues subjekti i rivlerësimit, me përshkrimin: *dhuratë djalit*. Vërtetuar kjo edhe me nxjerrje llogarie të subjektit të rivlerësimit në “Raiffeisen Bank” në datën 13.1.2017, ku evidentohet kreditimi më 19.1.2016, i shumës 22.757 euro, si dhuratë nga z. B.C.

1.20. Për të vërtetuar se shuma e mësipërme është përfituar nga shitja e një apartamenti, subjekti në deklaratën *Vetting* ka paraqitur si prova: **(1)** Kontratën e shitblerjes me rezervë nr. ***, datë 30.12.2015, me palë shitëse B., E. dhe E.C., palë shitëse L. dhe L.I., për shitjen e apartamentit me sip. 67.2 m², ndodhur në Kukës me çmim 22.910 euro. Nga kjo shumë blerësi do të likuidojë *cash* shumën prej 7.910 euro në llogarinë e noterit. Shuma prej 15.000 euro do të likuidohet sapo të miratohej kredia në NBG.¹⁴ **(2)** Kërkesë për transfertë fondesh, datë 7.1.2016, nëpërmjet NBG-së me urdhërues L. I. dhe përfitues B.Gj. (noter), të shumës 14.800 euro, me përshkrimin: “*L. I. depozituar sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 30.12.2015*”. **(3)** Nxjerrje llogarie në NBG e z. B.C., në të cilën evidentohet kreditimi në datën 13.1.2016 i shumës prej 22.910 euro, nga shtetasi B.Gj. me përshkrimin: “*Sa kalohet vlera e shitblerjes së banesës, shitësit B.C., referuar kontratës nr. ***, datë 30.12.2015*”. **(4)** Deklaratën noteriale nr. ***, datë 9.1.2016, për plotësim kushti të kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 30.12.2015, sipas së cilës shtetasi B.C., E.C. dhe E.C. si palë shitëse dhe shtetasi L. dhe L.I., si palë blerëse, deklarojnë se është plotësuar kushti i vendosur në kontratën e shitjes me rezervë, datë 30.12.2015, për pagesën e shumës prej 15.000 euro, për shitjen e apartamentit me sip. 67.2 m². Shuma ka kaluar në llogarinë e noterit në NBG.

B.C., ka ushtruar funksionin e drejtorit pranë kësaj drejtorie për periudhën 1.1.2001 – 3.10.2003; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare të lëshuar nga DRSKSH-ja Kukës; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare të lëshuar nga Qendra Shëndetësore K.; vërtetim me nr. *** prot., datë 5.5.2020; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare; vërtetim nr. *** prot., datë 4.11.2018, të Drejtoria e Qendrës Shëndetësore MALZI, Kukës; vërtetim nr. *** prot., datë 4.11.2018, nga Drejtoria e Qendrës Shëndetësore Sh., Kukës; vërtetim nr. *** prot., datë 4.11.2018, nga Drejtoria e Qendrës Shëndetësore G. – Ç., Kukës.

¹³ Vërtetim nr. *** prot., datë 21.11.2014, nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Kukës; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare për periudhën shtator 2009 – dhjetor 2012, nga Bashkia Kukës; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare për periudhën janar 2013 – tetor 2014, nga Bashkia Kukës; vërtetim nr. *** prot., datë 24.1.2019, nga Insituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale; vërtetim nr. *** prot., datë 23.1.2019, të lëshuar nga Bashkia Kukës.

¹⁴ Prokurë e poasçme nr. ***, datë 14.5.2013, sipas së cilës shtetësja E.C. emëron babain e subjektit, z. B.C., përfaqësues ligjor të saj në lidhje me veprime mbi pasurinë apartament me nr. pasurie ***, Kukës; prokurë e poasçme nr. ***, datë 23.12.2015, sipas së cilës shtetësja E.C. emëron b/shortin B.C. përfaqësues ligjor të saj në lidhje me veprime mbi pasurinë apartament me nr. pasurie ***, Kukës.

1.21. Në dokumentacionin e administruar nga ABI Bank (ish-NBG)¹⁵, konfirmohet se në datën 14.1.2016, noteri B.Gj. ka transferuar shumën prej 22.910 euro në llogarinë e personit tjetër të lidhur/B.C. Në të njëjtën datë, ky i fundit ka transferuar shumën prej 22.845,6 euro në llogarinë e tij në “Raiffeisen Bank”. Më tej, në dokumentacionin e përcjellë nga “Raiffeisen Bank”¹⁶, konfirmohet se në datën 19.1.2016 është transferuar shuma prej 22.757 euro nga llogaria e personit tjetër të lidhur/B.C., te llogaria e subjektit të rivlerësimit me përshkrim: “*dhuratë djalit*”

1.22. Për të provuar që apartamenti i shitur ishte në bashkëpronësi të babait/personit tjetër të lidhur/B.C., subjekti dorëzoi në deklaratën *Vetting* certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë dhe hartën treguese të apartamentit të shitur, regjistruar në vitin 1998, ku evidentohet se ky apartament ka qenë në pronësi të shtetasve B., E. dhe E.C. Pasuria është rivlerësuar në datën 7.5.2012, në shumën prej 4.000.000 lekësh.

1.23. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2¹⁷, gjithashtu, subjekti deklaroi se ka përfutur si dhuratë nga babai shumën prej 22.757 euro, provuar me dakumentin, nxjerrje llogarie, nga “Raiffeisen Bank”, ku pasqyrohen veprimet në llogarinë e subjektit për periudhën 8.1.2016 – 20.10.2016, dhe kalimi i shumës 22.757 euro, përfutur nga shitja e apartamentit në Kukës në pronësi të shtetasve B., E. dhe E.C. Ky apartament është përfutur me anë të privatizimit në shumën 10.120 lekë dhe është shitur në vlerë 22.910 euro. Për vërtetimin e deklaramëve të tij, subjekti paraqiti dokumentacion provues¹⁸.

1.24. Babai i subjektit ka të drejtë të dhurojë vetëm 1/3 e vlerës së përfutur nga shitja e kësaj prone në shumën 22.910 euro, për aq kohë sa nuk rezultoi të jetë lëshuar një deklaratë noteriale nga e ana e babait, nënës dhe motrës së subjektit lidhur me dhurimin e pjesës së tyre respektive subjektit të rivlerësimit. Megjithatë, referuar transfertës bankare nga babai i subjektit me përshkrimin: “*dhuratë djalit*”, Komisioni mori në konsideratë në analizë financiare vetëm vlerën prej 1.026.113 lekësh (1/3 e pjesës që i takon babait të subjektit).

1.25. Nga faktet e analizuara, bazuar në nenin 52, të ligjit 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit se ka mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues lidhur me shumën prej 2.052.226 lekësh dhuruar nga nëna dhe motra e subjektit pas përfutimit të të ardhurave nga shitja e apartamentit në Kukës.

1.26. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij në përgjigje të barrës së provës, shpjegoi se për shkak të marrëdhënieve të posaçme në raportet baba – bir, nënë – bir dhe vëlla – motër nuk ka qenë e nevojshme që të merrej ndonjë deklaram me shkrim i posaçëm për dhurimin e shumës së sipërcituar nga ana e babait, nënës dhe motrës, në kushtet kur ato nuk kanë paraqitur

¹⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 22.2.2019.

¹⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 22.2.2019.

¹⁷ E-mail datë 11.5.2020, ora 10:45.

¹⁸ Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 11.6.1993; kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 30.12.2015; certifikatë për vërtetim pronësie, prokurë e posaçme nr. ***, datë 14.5.2013, lëshuar nga znj. E.C.; prokurë e posaçme nr. ***, datë 23.12.2015, lëshuar nga znj. E.C.; deklaratë noteriale nr. *** rep., datë 9.01.2016, e emërtuar: “*deklaratë noteriale për plotësim kushti të kontratës së shitblerjes Datë 30.12.2015*”, nr. ***; transfertë bankare, datë 7.1.2016; transfertë bankare datë 14.1.2016; transfertë bankare NBG.

ndonjëherë ndonjë kundërshtim lidhur me përfitimin si dhuratë të shumës së sipërcituar. Sipas përcaktimeve të neneve 80 dhe 83 të Kodit Civil, nuk rezulton që nga ana e ligjvënësit të jetë parashikuar ndonjë formë e posaçme lidhur me dhurimin e mjeteve monetare.

1.27. Subjekti, në cilësinë e provës, paraqiti: (i) deklaratë noteriale nr. ***, datë 12.9.2020, të shtetasit E.C., në të cilën deklaroi se nga bisedat që ka zhvilluar me bashkëpronarët e tjerë, shtetasit B. dhe E.C., kanë rënë dakord që shumën prej 22.910 euro, të përfituar nga shitja e apartamentit në Kukës, t'ia dhurojnë subjektit të rivlerësimit dhe se nuk ka asnjë pretendim lidhur me pjesën e saj takuese. (ii) deklaratë e personit tjetër të lidhur, motra e subjektit, znj. E.C. dërguar me *e-mail*, vërtetuar nga noteri publik. Referuar kësaj deklaratë, znj. E.C. shpreh se ka rënë dakord që shumën prej 22.910 euro, të përfituar nga shitja e apartamentit, t'ia dhuronin subjektit dhe nuk ka asnjë pretendim lidhur me pjesën e saj takuese, si dhe për shkak të marrëdhënies së posaçme që ka me të vëllanë, ka vlerësuar që nuk ishte e nevojshme që dhurimi i pjesës së saj të bëhej me akt noterial.

Arsyetimi ligjor në lidhje me provat dhe ligjin e zbatueshëm

1.28. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratat e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se:

1.29. Sipas certifikatës për vërtetim pronësie, nr. ***, datë 21.8.2006, dhe kartelës së pasurisë lëshuar në datën 30.12.2015, rezulton se janë bashkëpronar të kësaj pasurie shtetasit B., E. dhe E.C. Pronësia mbi këtë apartament është fituar me anë të ligjit mbi privatizimin.

1.30. Sipas nenit 208 të Kodit Civil, tjetërsimi i sendit të përbashkët, mund të bëhet vetëm me pëlqimin e të gjithë bashkëpronarëve, gjë që vërtetohet me anë të kontratës së shitjes, ndëkohë që sipas nenit 200 të Kodit Civil, çdo bashkëpronar ka të drejtë të përfitojë nga të ardhurat e sendit të përbashkët në përpjesëtim me pjesën e tij.

1.31. Në prapësimet e tij në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit paraqiti deklaratat nga të dy bashkëpronarët e tjerë, respektivisht E. dhe E.C., të cilat deklarojnë se kanë rënë dakord që shumën prej 22.910 euro, të përfituar nga shitja e apartamentit në bashkëpronësi, t'ia dhurojnë subjektit të rivlerësimit, gjithashtu deklarojnë se nuk kanë asnjë pretendim në lidhje me pjesën e tyre takuese.

1.32. Pretendimi i subjektit se për shkak të marrëdhënieve të posaçme në raportet baba – bir, nënë – bir dhe vëlla – motër, nuk ka qenë e nevojshme që të merrej ndonjë deklaratë me shkrim i posaçëm për dhurimin e shumës së sipërcituar nga ana e babait, nënës dhe motrës së subjektit në kushtet kur ato nuk kanë paraqitur ndonjëherë ndonjë kundërshtim lidhur me përfitimin si dhuratë të shumës së sipërcituar, nuk qëndron, pasi shumën e përfituar nga shitja e apartamentit i përket të 3 bashkëpronarëve në mënyrë të barabartë dhe në prokurën e posaçme nuk është

parashikuar qartë se z. B.C. mund të dhuronte të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij apartamenti.

1.33. Gjithsesi, duke mbajtur parasysh se: (i) bashkëpronarët kanë deklaruar se nuk kanë asnjë pretendim për pjesën takuese, të përfitur nga shitja e apartamentit në Kukës, sipas deklarimeve; (ii) shumën e përfitur nga shitja e kontratës është transferuar nga blerësi te shitësi sipas formës së kërkuar nga ligji, me anë të noterit publik; si dhe (iii) transferimin e shumës me anë të bankës, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka provuar se këto të ardhura i janë dhuruar nga nëna dhe motra e tij, sipas pjesëve të tyre takuese, me vullnetin e tyre të lirë, edhe pse jo në momentin fillestar të transferimit të këtyre shumave.

1.34. Si konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka burime të ligjshme të shoqëruara me dokumentacion justifikues për të krijuar këto të ardhura.

2. Apartament banimi me sip. 101.42 m², në vlerën 5.400.000 lekë, ndodhur në Selitë, Tiranë

2.1 Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: blerë së bashku me bashkëshorten, znj. S.C. në datën 18.10.2016, nga shtetasit B. dhe E.C. me kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. ***, apartament banimi me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me sip. 101.42 m², ndodhur në Selitë, Tiranë. Vlera: 5.400.000 lekë. Pjesa takuese: 50 %.

2.2 Si burim krijimi subjekti deklaron huan e marrë kunatës, znj. M.Sh. në shumën 5.400.000 lekë me transfertën bankare të datës 10.8.2016 nga “Raiffeisen Bank”. Një shumë të tillë kunata e subjektit, znj. M.Sh., sikurse përshkruhet edhe në dokumentin e lëshuar nga “Raiffeisen Bank,” H., Austri¹⁹, rezulton ta ketë përfitur nga shitja e një prone në adresën *** H., Austri, si dhe nga kursimet.

2.3 Subjekti për vërtetimin e deklarimeve ka paraqitur dokumentacion ligjor provues²⁰.

2.4 Referuar dokumentacionit të administruar nga ZVRPP-ja Tiranë²¹, figuron e regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, e lloji, apartament me sip. 101.42 m².

2.5 Subjekti i rivlerësimit me kontratën nr. ***, datë 18.10.2016, ka blerë nga shtetasit B. dhe E.C. (prindërit) apartamentin me sip. 101.42 m², në Selitë, Tiranë, me çmim 5.400.000 lekë, paguar në datën e nënshkrimit të kontratës.

2.6 Nga hetimi i Komisionit, rezulton se këtë apartament prindërit e subjektit e kanë blerë me kontratën nr. ***, datë 14.4.2012, nga pala shitëse, z. A.R., në shumën 400 euro/ m², me sip. 101.4 m² dhe sip. 23.20 m² (verandë) e pahipotekueshme, pagesat janë kryer jashtë zyrës

¹⁹ Shkresë “Raiffeisen Bank”, H., datë 19.10.2016 (dorëzuar nga subjekti).

²⁰ Kontratë shitblerje nr. ***, datë 18.10.2016, e partament me sip. 101.42 m²; certifikatë pronësie nr. ***, datë 20.4.2012; kartelë pasurie, dy njoftime debitimi të “Raiffeisen Bank”, datë 18.10.2016; nxjerrje llogarie e S.C. në “Raiffeisen Bank”, datë 26.10.2016; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 2.11.2016; kartelë pasurie për apartament me sip. 101.42 m² në emër të Neritan e S.C.; si dhe verandë me sip. 23.2 m² + hartë treguese e regjistrimit.

²¹ Shkresa nr. *** prot., datë 7.3.2019.

noteriale. Vërtetuar me certifikatë pronësie nr. ***, datë 20.4.2012, dhe kartelave të pasurisë, në emër të personit tjetër të lidhur, z. B.C., ku evidentohet se në datën 2.9.2016, pasuria rivlerësohet në shumën 6.541.590 lekë, në përshkrimin e veçantë shënohet verandë me sip. 23.2 m².

2.7 Nga hetimi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë²² dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë²³, nuk u provua qenia e subjektit të rivlerësimit, në kushtet e konfliktit të interesit me shitësit/ndërtuesit e këtij apartamenti²⁴.

2.8 Në DPV-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar arredimin e shtëpisë së prindërve ku jeton në shumën prej 700.000 lekësh, me burim kredinë e marrë pranë “Societe Generale Albania”. Në po këtë vit, subjekti deklaroi se ka lidhur kontratën e kredisë afat mesme në shumën prej 700.000 lekësh me afat 5 vjet për mobilim e shtëpisë ku jeton. Gjithashtu, në deklaratën *Vetting* subjekti deklaroi se ka nënshkruar së bashku me bashkëshorten në datën 7.5.2015, kontratë kredie afatmesme me “Societe Generale Albania” për marrje kredi të shumës 700.000 lekë me afat 5-vjeçar. Qëllimi i marrjes së kredisë: *për mobilimin e shtëpisë ku jetoj në adresën: Rr. “***”, pallati “***”, kulla ***, ap. ****. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur pa shlyer deri në datën e dorëzimit të deklaratës është 498.928 lekë.

2.9 Komisioni vëren se referuar dokumentacionit të administruar nga “Societe Generale Albania” me shkresën nr. ***, datë 18.3.2019, konfirmohet marrja e kredisë në datën 7.5.2015, në vlerën 700.000 lekë, me datë maturimi 7.5.2020.

2.10 Si konkluzion, në lidhje me deklarimin e subjektit, Komisioni arrin në përfundimin se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit.

2.11 Gjithsesi, nisur nga rrethanat e konstatuara si: (i) babai i subjektit i punësuar në Kukës me kohë të plotë, blen një apartament në Tiranë, ku jeton subjekti bashkë me familjen e tij, ndërkohë që për efekt të shpenzimeve jetike, subjekti deklaroi se babai nga viti 2012 – 2016 qëndronte më shumë në Kukës, pasi ishte i punësuar atje; (ii) subjekti i rivlerësimit i ka marrë hua kunatës/personit tjetër të lidhur/M.Sh. shumën prej 5.400.000 lekësh për të likuiduar babanë e tij, i cili është shitësi, ndërkohë që babai i subjektit i dhuron shumën prej 25.000 euro për të blerë një shtëpi në B., Gjermani; (iii) për më tepër që kjo hua nuk është shlyer për 3 vjet ndaj kunatës, Komisioni, gjatë hetimit nuk u bind që këto transaksione financiare shitblerjeje dhe huaje të ishin të vërteta dhe të sakta.

2.12 Për këto arsye dhe duke qenë se vërehet një marrëdhënie e qëndrueshme interesi mes subjektit të rivlerësimit dhe babait që përfshin: **(1)** huanë e dhënë nga babai në shumën 250.000 lekë në vitin 2011; **(2)** dhurimin e shumës 550.000 lekë nga babai në vitin 2015 për blerjen e pasurisë së parë në B., Gjermani; **(3)** dhurimin e shumës 22.757 euro nga babai, nëna dhe motra e subjektit në vitin 2016 për blerjen e pasurisë së parë në B., Gjermani; **(4)** jetesën e përbashkët të familjes së subjektit (subjekti, bashkëshortja dhe fëmijët) me prindërit e tij gjatë periudhës 1.5.2012 – 1.11.2016, deklaruar nga subjekti në pyetësorin nr. 3 (në një apartament i cili është

²² Shkresë nr. *** prot., datë 7.7.2019.

²³ Shkresë nr. *** prot., datë 7.7.2019.

²⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 14.7.2020, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe shkresa nr. *** prot., datë 10.7.2020, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

blerë më vonë prej tij); **(5)** huan e dhënë nga babai në shumën 3.400 Euro në vitin 2018 për blerjen e apartamentit në Lukovë, Komisioni vlerësoi nevojën për të hetuar çdo fakt, rrethanë apo dyshim mbi pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e prindërve të subjektit/z. B.C. dhe znj. E.C., sipas parashikimeve të nenit 45 të ligjit nr. 84/2016.

2.13 Komisioni me anë të pyetësorit nr. 4, i kërkoi subjektit të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues: **(i)** për të ardhurat e prindërve; **(ii)** për të provuar pagesën për blerjen e apartamentit në Rr. “***”, pallati “***” (mandatarkëtimi dhe/ose transferta bankare); **(iii)** lidhur me investime të tjera apo pasuri të paluajtshme/të luajtshme të prindërve të tij, si dhe informacion lidhur me adresat ku kanë jetuar prindërit e tij prej vitit 2004 e në vazhdim.

2.14 Në përgjigje, subjekti dorëzoi dokumentacion ligjor justifikues për të ardhurat e prindërve dhe investimet në pasuri të paluajtshme të kryera nga ana e tyre, në bazë të të cilave janë konstatuar faktet e mëposhtme:

Analizimi i burimeve të krijimit të pasurive dhe të të ardhurave për prindërit e subjektit të rivlerësimit

a. Lidhur me pasuritë e paluajtshme të babait të subjektit

Nga hetimi i Komisionit, në emër të shtetasit B.Xh.C. figurojnë pasuri në pronësi dhe të transkriptuara, si vijon:

2.15 Pasuri në pronësi – garazh me sip. 37 m², në Selitë, Tiranë, që sipas dokumentacionit bashkëlidhur shkresës së ASHK-së²⁵, është blerë me kontratë nr. ***, datë 16.1.2016 nga shoqëria “***” sh.p.k., me çmim blerje 11.915 euro dhe është paguar në datën 18.1.2016 në llogarinë e noteres D.P. në “Raiffeisen Bank”. Sipas dokumentacionit të përcjellë nga DPSHTRr-ja²⁶, shtetasi B.C. nuk disponon automjet.

2.16 Pasuri në pronësi – ndërtesë me sip. 88,5 m², në Yzberisht, Tiranë, për të cilën është përcjellë leja e legalizimit nr. ***, datë 30.5.2017, dhe raporti i vlerësimit hartuar në maj të vitit 2017 nga “***” studio, për objektin truall me sip. 265,5 m², nga e cila 88,5 m² zënë nga ndërtesa. Bazuar në këtë raport, për të cilin janë përdorur referencat e çmimeve të vitit 2016, trualli është vlerësuar me 2.364.543 lekë, ndërsa ndërtesa është vlerësuar me 3.688.370 lekë, në total në vlerën 6.053.000 lekë. Në pyetësin nr. 4, subjekti ka shpjeguar se në prill të vitit 1998, babai ka blerë nga shtetasja Xh.Rr. një objekt të përshtatur në banesë prej kësaj të fundit të ndodhur në Yzberisht, Tiranë, por nuk disponon aktin e blerjes për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar. Për të provuar kohën se kur është blerë ky objekt, shtesën e kryer nga babai në periudhën 2000 – 2002 dhe se gjendja e objektit ka mbetur e pandryshuar nga viti 2002 e në vazhdim, subjekti ka paraqitur ortofoto dhe imazhe satelitore të realizuara nga inxhinieri gjeodet A.B., konkretisht, ortofoto të viteve 1994, 2007, 2017, si dhe imazhe satelitor të qershor 2002, shkurt 2003, maj 2004.

²⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 7.3.2019.

²⁶ Shkresë nr. *** , datë 13.5.2020.

2.17 Komisioni konstaton se në DPV-në e vitit 2004, subjekti ka deklaruar “shtëpi dhe truall me sip. 100 m², ndodhur në Yzberisht, Tiranë, regjistruan në regjistrin hipotekor me nr. pasurie ***, datë 16.4.1998”, pjesa takuese e babait 100 %, vlera 950.000 lekë, vlerë e cila u konsiderua nga Komisioni në analizën financiare (në mungesë të informacionit). Në procesverbalin e datës 24.10.2014²⁷, mbajtur mes përfaqësuesve të ILDKPKI-së dhe subjektit të rivlerësimit, është pyetur se ku ka banuar nga viti 2004 deri më 31.12.2013. Subjekti deklaroi se ka jetuar në ambientin e përshtatur si banesë në Yzberisht, Tiranë, blerë nga babai në vitin 1998, objekti ka mbetur paregjistruar, ndërsa trualli me sip. 100 m² rezultoi të ketë qenë me qira. Banesa është pothuajse e rrëzuar dhe nuk është e banueshme që nga viti 2004 (*kanë jetuar në periudhën 1998 – 2004*).

2.18 Pasuri në pronësi - arë me sip. 500 m², në Yzberisht, Tiranë, e cila, sipas dokumentacionit bashkëlidhur shkresës së ASHK-së²⁸, është blerë me kontratë nr. ***, datë 14.2.2000 nga shitësit B.H., Sh.H., E.H., L.H., me çmim blerje 250.000 lekë. Bazuar në shënimin në kartelë, kjo pasuri është rivlerësuar në datën 22.5.2017, në vlerën 5.933.840 lekë.

2.19 Pasuri në pronësi (në zonë të pamenaxhuar) – apartament me sip. 66,2 m² dhe garazh me sip. 13 m², të ndodhur në Himarë, Vlorë, e cila sipas dokumentacionit të përcjellë nga notere M.Gj.²⁹, rezultoi e blerë me kontratë shitje nr. ***, datë 2.5.2017 nga shoqëria “****” sh.p.k., me çmim 4.140.000 lekë dhe e porositur në datën 7.12.2012, ndërkohë që çmimi është likuiduar para kësaj date, si vijon: (1) në datën 18.12.2012, depozim në vlerën 2.000.000 lekë dhe depozitim 1.000 euro me përshkrim: “*B.C., derdh për apartament në Himarë*”; (2) në datën 11.6.2013, depozim në vlerën 600.000 lekë me përshkrim: “*B.C., pag. për apartament në Himarë*”; (3) në datën 19.6.2013, depozim në vlerën 1.400.000 lekë me përshkrim “*B.C., derdh likuid. apartament në Himarë*”. Në përgjigje të pyetësorit nr. 4, ku subjekti është pyetur lidhur me pasuritë e paluajtshme të babait, nuk e ka deklaruar pasurinë në fjalë.

2.20 Pasuri e transkriptuar - në dokumentacionin e përcjellë nga ASHK-ja, figuron e transkriptuar pasuria apartament me sip. 101.42 m², blerë me kontratë nr. ***, datë 14.4.2012, nga shtetasi A.R. me çmim 400 euro/m² dhe shitur subjektit të rivlerësimit në datën 18.10.2016, me kontratën nr. ***. Në pyetësorin nr. 4, subjekti paraqiti dokumentacion ligjor justifikues, konkretisht, kontratë porosie datë 19.11.2004, lidhur midis “****” dhe z. B.C. (jo e lidhur përpara noterit), ku parashikohet grafiku i kryerjes së pagesave, duke përcaktuar: shuma 7.000 euro në datën e lidhjes së kontratës më 19.11.2004; shuma 1.000 euro në datën 31.7.2006; shuma 6.000 euro në datën 30.7.2007; shuma 6.000 euro në datën 30.07.2008; shuma 6.000 euro në datën 30.7.2009; shuma 6.000 euro në datën 30.7.2010; dhe shuma 2.968 euro në datën 30.3.2011.

2.20.1 Subjekti paraqiti dhe kopje të mandatarëtimeve, konkretisht: (1) nr. ***, datë 19.11.2004, në vlerën 7.000 euro; (2) nr. ***, datë 31.7.2006, në vlerën 11.000 euro; (3) nr. ***, datë 30.07.2007, në vlerën 6.000 euro; (4) nr. ***, datë 30.7.2008, në vlerën 6.000 euro; (5) nr. ***, datë 30.07.2009, në vlerën 6.000 euro; (6) nr. ***, datë 30.7.2010, në vlerën 6.000

²⁷ Administruar me shkresë nr. ***, datë 5.5.2020, nga Komisioni.

²⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 7.3.2019.

²⁹ Shkresë nr. ***, datë 22.7.2020, notere M.Gj.

euro, pra, në total vlera prej 42.000 euro. Lidhur me këstin e fundit, subjekti shpjegon se nga biseda e zhvilluar me babanë, ky i fundit i ka deklaruar se kësti i fundit në shumën prej 2.968 euro nuk është paguar prej tij për shkak të disa të metave të konstatuara në cilësinë e punimeve të kryera nga pala sipërmarrëse shoqëria “****” sh.p.k. Më tej, subjekti sqaron se babai i ka deklaruar se në marrëveshje me administratorin e shoqërisë “****” sh.p.k., dhe konkretisht në marrëveshje me shtetasin A.R., nga i cili më pas rezultoi që të ketë blerë edhe apartamentin e porositur me kontratën e porosisë të datës 19.11.2004, është rënë dakord që të metat e konstatuara të riparoheshin prej babait të subjektit. Nga biseda e zhvilluar me babanë, ky i fundit i ka deklaruar se vlera e riparimeve të kryera për rregullimin e të metave të konstatuara ishte pothuajse e barabartë me vlerën e këstit të fundit. Komisioni konstaton se shitësi i apartamentit është personi fizik “A.R.”, ndërkohë që mandatarkëtimet janë lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k.

2.20.2 Gjithashtu, konstatohet se në pyetëtorin e mbajtur në ILDKPKI³⁰, lidhur me apartamentin e ndodhur në Rr. “****”, Tiranë, subjekti deklaroi se nga babai i tij është prenotuar që në vitin 2006 dhe i është dorëzuar në vitin 2007, ndërkohë që bazuar në përgjigjet e pyetësorit, rezultoi që kontrata e porosisë është lidhur në vitin 2004, dhe po në këtë vit kanë filluar edhe pagesat, të cilat kanë vijuar deri në vitin 2010, pra, edhe pas dorëzimit të apartamentit.

2.20.3 Lidhur me çmimin e këtij apartamenti, Komisioni konstatoi se çmimi i referencës (kosto e shitjes lekë/m²/sip shfrytëz/për tregun e lirë), në vitin 2004 ka qenë 68.571 lekë/m² referuar Udhëzimit nr. 1, datë 4.3.2004, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive, të vlerave të tregut të lirë të banësive dhe të koeficientit “K””, ndërkohë që çmimi sipas kontratës së mësipërme ka qenë 50.852 lekë/m² (400 euro x 127.13).

2.20.4 Komisioni kërkoi informacion pranë notere M.Ç. për kontrata të ngjashme në të njëjtin objekt dhe në përgjigje³¹, u vunë në dispozicion të Komisionit 5 (pesë) kontrata shitje, ku konstatohet se çmimi i shitjes varioi nga 400 euro/m² në 600 euro/m².

2.21 Pasuri me kontratë sipërmarrje - në pyetëtorin nr. 4, subjekti ka deklaruar se referuar kontratës së sipërmarrjes me nr. ***, datë 1.12.2014, rezultoi që para noteres publike V.S. të jetë lidhur një kontratë sipërmarrjeje (për prenotim apartamenti) nga njëra anë babai i subjektit/B.C. dhe vëllai i subjektit/shtetasi M.C., me cilësinë e blerësve, dhe nga ana tjetër shoqërisë “****” sh.p.k. në cilësinë e palës shitëse, me objekt shitblerjen e një ambjenti - **apartament me sipërfaqe totale 88 m²**, që po ndërtohej nga shoqëria “****” sh.p.k., në fshatin Selitë të Komunës Farkë, me çmim 61.600 euro, vlerë e cila do të shlyhet pjesërisht në vlerën 40.000 euro menjëherë pas nënshkrimit të kësaj kontrate me para në dorë (*cash*) dhe pjesa e në vlerën prej 21.600 euro do të shlyhet me dy këste, kësti i parë në shumën 10.000 euro do të shlyhet me fillimin e shtrimit të pllakave të brendshme në apartament, ndërsa kësti i dytë në shumën 11.600 euro do të shlyhet në momentin e përfundimit të apartamentit. Subjekti deklaroi se nga biseda e zhvilluar me babanë, ky i fundit i ka deklaruar se në momentin e

³⁰ Në procesverbalin e datës 24.10.2014, administruar nga Komisioni me shkresë nr. *** prot., datë 5.5.2020.

³¹ Shkresë datë 3.6.2020, protokolluar me nr. ***, datë 15.6.2020.

lidhjes së kontratës së sipërcituar shuma prej 26.000 euro është paguar nga blerësi M.C. ndërsa diferenca prej 14.000 euro është paguar prej babait.

Komisioni iu drejtua shoqërisë “****” sh.p.k., e cila në përgjigjen³² e saj, përcolli kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 1.2.2014, kontratën për nënkontraktimin e punimeve ndërtuese për ndërtimin e një godine banimi dhe shërbimi nr. ***, datë 10.11.2014, lidhur ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shoqërisë “****” sh.p.k., si edhe dokumentacion justifikues për pagesat e kryera, konkretisht: (1) mandatar-këtimi nr. ***, datë 1.12.2014, shuma 40.000 euro, lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k. dhe arkëtuar nga z. M.C. me përshkrimin: “*likuidim kësti i sipas kontratës nr. ***, datë 1.12.2014 sipas aktmarrëveshjes *** – ****”; (2) lëvizje llogarie në BKT të shoqërisë “****” sh.p.k., ku në datën 8.6.2015 evidentohet veprimi *cash deposit* në shumën 1.900.000 lekë, z. B.C. derdh në llogari të shoqërisë “****” sh.p.k, pagesa e këstit të shtëpisë (kësti i dytë); (3) lëvizje llogarie në BKT të shoqërisë “****” sh.p.k., ku në datën 9.2.2016 evidentohet *cash* veprimi *cash deposit* në shumën 6.200 euro, M.C. pagesë kësti për blerje apartamenti për shoqërinë “****” sh.p.k.

Për sa më sipër, në analizën financiare u paraqitën shuma 14.000 euro në datën 1.12.2014 dhe shuma 1.900.000 lekë në datën 8.6.2015.

b. Në lidhje me të ardhurat e prindërve

2.22 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 dhe nr. 4, subjekti dorëzoi dokumentacion ligjor justifikues për të vërtetuar të ardhurat e prindërve të tij³³

³² Shkresë datë 25.6.2020, protokolluar me nr. ***, datë 3.7.2020.

³³ *Dorëzuar në pyetësin nr. 02*: (1) vërtetim Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës, datë 21.11.2014; (2) vërtetim nr. *** prot., datë 30.10.2014 Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Kukës; (3) vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare DRFSDKSH Kukës; (4) vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare Qendra Shëndetësore K., Kukës; (5) vërtetim me nr. *** prot., datë 5.5.2020, “Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare” Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Kukës, (6) vërtetim me nr. *** prot., datë 4.11.2018, Drejtoria e Qendrës Shëndetësore MALZI, Kukës; (7) vërtetim me nr. *** prot., datë 4.11.2018, Drejtoria e Qendrës Shëndetësore Sh., Kukës; (8) vërtetim me nr. *** prot., datë 04.11.2018 Drejtoria e Qendrës Shëndetësore G. – Ç., Kukës, (9) certifikatë familjare lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile të Bashkisë Kukës; (10) vërtetim me nr. *** prot., datë 21.11.2014. të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Kukës; (11) vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare për periudhën shtator 2009 – dhjetor 2012 Bashkia Kukës; (12) vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare për periudhën janar 2013 – tetor 2014 Bashkia Kukës; (13) vërtetim me nr. *** prot., datë 24.1.2019, Insituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Kukës; (14) vërtetim me nr. *** prot., datë 23.1.2019, Bashkia Kukës. *Dorëzuar në pyetësin nr. 4*: (1) diplomë Universiteti Shtetëror i Tiranës për shtetasin B.C.; (2) vërtetim me nr. *** prot., datë 2.7.2020, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës; (3) vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës për të siguruarin B.C. për periudhën 1.1.1994 – 31.12.1997; (4) vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës për B.C. periudhën 1.1.1998 – 1.2.2001; (5) vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë për të siguruarin B.C. për periudhën 16.1.2001 – tetor 2003; (6) vërtetim për bazën e

2.23 Për sa i përket të ardhurave të babait përpara vitit 1993, subjekti ka dorëzuar vërtetimin nr. *** prot., datë 2.7.2020, të lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës, ku konfirmohen periudhat e punësimit të babait deri në 31.10.2000 dhe ku theksohet se para vitit 1994 ka mungesë dokumentacioni.

2.24 Komisioni, duke u bazuar edhe në arsyetimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit³⁴, vëren se mungesa e të ardhurave të babait të subjektit të rivlerësimit përpara vitit 1992, nuk e ndikon analizën financiare. Ndërsa për vitin 1993, për të cilin sërish ka mungesë dokumentacioni për të ardhurat, Komisioni nuk përlllogariti as shpenzime jetese.

2.25 Në lidhje me shpenzimet jetike, ato janë përlllogaritur³⁵: (i) 66% e të ardhurave për periudhën 1994 – 1999; (ii) bazuar në shkresën nr. ***, datë 4.3.2019, të ILDKPKI-së për periudhën 2000 – 2016³⁶.

2.26 Lidhur me adresat e banimit të prindërve, në përgjigje të pyetësorit nr. 4 subjekti deklaroi se: (i) gjatë periudhës 2004 – maj 2012, prindërit kanë jetuar në apartamentin e tyre në Kukës; (ii) gjatë periudhës 1.5.2012 - 1.11.2016 kanë jetuar me subjektin dhe familjen e tij, duke sqaruar këtu se në këtë periudhë në mënyrë të vazhdueshme ka jetuar vetëm nëna e tij, për shkak se babai ishte në marrëdhënie pune në Kukës dhe vinte kryesisht vetëm në fundjavë, ndërsa gjatë periudhës tjetër të javës qëndronte në Kukës; (iii) nga data 1.11.2016 dhe në vazhdim prindërit jetojnë me shtetasin M.C. në apartamentin e porositur në Tiranë, pranë shoqërisë “****” sh.p.k.

2.27 Në dokumentacionin e përcjellë nga notere E.A.³⁷, Komisioni konstatoi se në kontratën nr. ***, datë 18.10.2016, është shënuar se: “[...] unë noterja E.A.” u paraqita personalisht në adresën e shitësve B. dhe E.C., me kërkesën e kontraktuesve, për vërtetimin e kësaj kontrate me kushtet e mëposhtme...[...]

 dhe, më tej, si adresë të shitësve citon Rr. “****”, ndërsa si adresë të blerësve, shtetasve Neritan dhe S.C. citon Rr. “****”, pallati “****”, pranë Kopshtit Botanik.

2.28 Për sa më sipër, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me jetesën e përbashkët me prindërit duken kontradiktore dhe për këtë arsye, Komisioni hetoi mbi mundësitë financiare të

vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare lëshuar nga Qendra Shëndetësore K. për B.C. për periudhën 1.11.2003 – 31.12.2006; (7) vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare Qendra Shëndetësore K. për të siguruarin B.C. për periudhën 1.1.2007 – 31.12.2008; (8) vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare Qendra Shëndetësore Sh. për të siguruarin B.C. për periudhën gusht 2014 – tetor 2015; (9) vërtetim Drejtoria e Qendrës Shëndetësore G. – Ç. me nr. ***, datë 4.11.2018, në të cilin pasqyrohen të ardhurat nga paga të shtetasit B.C. për periudhën tetor 2015 – nëntor 2018

³⁴ Vendim nr. 19-2019 (JR), datë 26.7.2019, [...] *trupit gjykues vëren se të ardhurat e përfituara nga individët në Shqipëri deri në vitin 1992, për shkak të krizës drastike financiare që kaloi vendi atë vit për shkak të ndryshimeve të natyrës politike, janë të papërfillshme*³⁴, për shkak të inflacionit deri në 400 për qind (%) që kaloi ekonomia shqiptare. Si rrjedhojë, shkresat e sjella nga subjekti i rivlerësimit për të vërtetuar kursime të konsiderueshme, përbëjnë prova të cilat ndonëse të rregullta dhe të besueshme, kërkojnë të provojnë një pretendim i cili bie ndesh me fakte të njohura botërisht dhe informacionin zyrtar. Për pasojë, këto shkresa u çmuan me vlerë provuese të kufizuar në kontekstin e rivlerësimit dhe pa efekt në vendimmarrjen e trupit gjykues [...].

³⁵ Për 1994-1999: 66% x 610.771 lekë; për vitin 2000 dhe 2001: 4 persona dhe bazuar në shkresën nr. *** prot. të ILDKPKI; për periudhën 2002 dhe në vazhdim 2 persona dhe bazuar në shkresën nr. *** prot., të ILDKPKI-së.

³⁶ Vlera për vitin 2007 e saktësuar sipas shkresës nr. ***, datë 27.5.2008, së INSTAT-it, drejtuar ILDKPKI-së.

³⁷ Shkresë datë 11.5.2020, e protokolluar me nr. ***, datë 13.5.2020.

babait për të blerë apartamentin ku subjekti i rivlerësimit deklaroi se jetonin bashkë për periudhën 1.5.2012 - 1.11.2016 dhe që më vonë u ble nga subjekti i rivlerësimit.

Lidhur me analizimin e burimit të blerjes së apartamentit prej personit tjetër të lidhur/babait të subjektit

2.29 Për efekt të analizës financiare, Komisioni kreu dy analiza financiare të ndara, veçmas për subjektin dhe personat e lidhur, dhe veçmas për prindërit e subjektit, për shkak se: (i) prindërit e subjektit gjatë periudhës së jetesës së përbashkët me subjektin kanë investuar në pasuri të paluajtshme; (ii) prindërit e subjektit gjatë periudhës së jetesës së përbashkët i kanë dhuruar 550.000 lekë subjektit; dhe (iii) mungon informacioni lidhur me gjendje të mundshme likuiditeti *cash* të prindërve jashtë sistemit bankar.

2.30 Në përfundim të arsyetimit më lart, Komisioni kreu analizën financiare për të ardhurat, pasuritë dhe shpenzimet e prindërve të subjektit me qëllim verifikimin e burimeve të ligjshme të tyre për blerjen e apartamentit në Rr. “***”, Tiranë si vijon:

Analizë financiare (periudha 1994 – 2011)

Periudha	1994 – 2011
Të ardhura babai i subjektit ³⁸	7,462,844
Të ardhura nëna e subjektit ³⁹	2,223,933
Të ardhura nga interesa bankare	111,356
TOTAL TË ARDHURA	9,798,133
Shpenzime jetike	3,954,607
Hua subjektit	250,000
TOTAL SHPENZIME	4,204,607
Tokë dhe ndërtesë 88.5 m ² , datë 16.4.1998, përfshirë shtesën	950,000
Blerje tokë arë, sip. 500 m ² , datë 14.2.2000, në Yzberisht	250,000
Pagesa për blerjen e apartamentit në pallatin “***”, Tiranë	5,368,348
Shpenzime për riparimet në apartamentin në pallatin “***” (2.968 euro)	410,474
Gjendje e llogarive bankare, datë 31.12.2011 ⁴⁰	3,539,661
TOTAL PASURI	10,518,484
BALANCA E FONDEVE	- 4,924,958

³⁸ (1) Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës (966.751 lekë); (2) vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë janar 2001 – tetor 2003 (782.475 lekë); (3) vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të lëshuar nga Qendra Shëndetësore K. (4.027.541 lekë) - referuar vërtetimit, në muajin tetor paga bruto është më e ulët se paga *neto* (bruto 68.311 lekë - *neto* 117.963 lekë), u konsiderua pagë neto vlere 57.849 leke bazuar në vërtetimin e parë të dorëzuar nga subjekti në pyetësorin nr. 2; (4) vërtetim për bazën neto të vlerësueshme Drejtoria Rajonale Kukës nr. ***, datë 5.5.2020 (1.686.077 lekë)

³⁹ (1) Vërtetim nr. *** prot., datë 7.5.2020, drejtuar Komisionit (1.552.233 lekë); (2) vërtetim ISSh-së, Bashkia Kukës. (671.700 lekë)

⁴⁰ (1) Llogari B.C. Union në lekë, nr. *** (21.403 lekë); (2) llogari B.C. Credins në lekë, nr. *** (1.019.637 lekë); (3) llogari B.C. Raiffeisen në lekë, nr. *** (45 lekë); (4) llogari B.C. Raiffeisen në lekë, nr. *** (260.576 lekë); (5) depozita B.C. “Raiffeisen Bank” në lekë, nr. *** (2.238.000 lekë)

2.31 Nga faktet e analizuara, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me mungesën e burimeve financiare të ligjshme, të mjaftueshme për blerjen e apartamentit në Rr. “*”, pasurive të tjera të cituara më lart, si dhe kryerjen e shpenzimeve, me një balancë negative në shumën 4.924.958 lekë, referuar të ardhurave për periudhën 1994 – 2011, në kuadër të dyshimit të transaksionit të shitblerjes midis babait dhe subjektit të rivlerësimit.**

2.32 Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij në përgjigje të barrës së provës, shpjegoi duke deklaruar se Kolegji i Posaçëm i Apelit në vendimet e tij nr. 15, datë 17.7.2019 dhe nr. 20, datë 31.7.2019, ka arritur në përfundimin se: *“Në vijim të këtij arsytimi, Kolegji çmon se në rastet kur subjekti i rivlerësimit gjendet para situatës së parashikuar prej pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, duhet të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të asaj pasurie, e cila është objekt dhurimi apo huaje, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur. Interpretimi në të kundërt i kësaj dispozite konsiderohet se shkel parimin e proporcionalitetit, pasi e ngarkon subjektin me një barrë përtej asaj që ai ligjërisht është ngarkuar të mbajë dhe barazon statusin e një shtetasi tjetër, personit tjetër të lidhur, që përgjithësisht nuk ka figuruar të ketë qenë subjekt deklarues, me atë të vetë subjektit të rivlerësimit, një mision që del jashtë qëllimit të ligjit e për më tepër duket edhe i pamundur”.*

2.33 Subjekti i referohet vendimeve nr. 15, datë 17.7.2019 dhe nr. 20, datë 31.7.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, vendime të cilat rezultojnë të kenë kufizuar barrën e provës së subjektit deri në ligjshmërinë e burimit të krijimit të asaj pasurie që është objekt dhurimi apo huaje.

2.34 Në vijim, subjekti sqaron se në pikën 2, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet shprehimisht se: *“Kolegji i Apelit, në arsyetimin e vendimit të tij, orienton Komisionin për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme”.*

2.35 Si përfundim, subjekti ka deklaruar se në përputhje me dispozitën e sipërcituar dhe përfundimet e arritura nga Kolegji i Posaçëm i Apelit në vendimet e tij të sipërcituara arrihet në përfundimin se **si subjekt nuk kam barrë prove për të provuar balancat negative të konstatuara nga Komisioni në analizën financiare të prindërve B. dhe E.C., për periudhën 1994 – 2011.**

2.36 Lidhur me periudhën e jetesës së përbashkët, subjekti ka shpjeguar se në pyetësorin nr. 3 ka deklaruar se ka bashkëjetuar me prindërit nga maj i vitit 2012 deri tetor të vitit 2016. Sipas tij, ky deklaram nuk nënkupton që ka jetuar me prindërit deri në fund të muajit tetor të vitit 2016 sikurse në mënyrë të gabuar interpretohet nga Komisioni, pasi kur ka thënë muaji tetor nuk e ka përfshirë të plotë këtë muaj. Subjekti vijon të shpjegojë se ka jetuar me prindërit deri në ditët e para të muajit tetor, për shkak se këto të fundit u zhvendosën në banesën që babai B.C. dhe shtetasi M.C. kishin porositur së bashku me kontratën e datës 1.12.2014.

2.37 Në seancën dëgjimore të datës 2.10.2020, subjekti deklaroi se shtëpinë në B., Gjermani e ka blerë referuar rekomandimit të shokut të tij, z. E.M., në nëntor të vitit 2015, kohë kur

subjekti ishte në Gjermani me ftesë të shokut të tij. Gjithashtu, subjekti shpjegoi se nuk kishte një banesë në Tiranë, por njeriu vendos dhe logjikën në rradhë të parë, tregohet racional dhe i fitohet, dhe mendoi se nëse blen këtë apartament dhe e jep me qira, meqë ishte koha e sirianëve që lëvruan të gjithë në Gjermani, do të kishte mundësi të merrte një shtëpi, të paguante edhe qiranë në qoftë se do dilte në shtëpi me qira, për shkak se marrëdhëniet mund të përkeqësoheshin, sikurse ndodhi në vitin 2016, kur u detyrua bashkëshortja të gjente zgjidhje te motra e saj dhe subjektit i ishte dukur shumë e leverdisshme, ndërkohë nëse do investonte në Shqipëri, nuk kishte çfarë të blinte me vlerën prej 25.000 euro.

Arsyetimi ligjor në lidhje me provat dhe ligjin e zbatueshëm

2.38 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provave shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se:

2.39 Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se nuk ka detyrimin të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit mbi balancën negative të prindërve, me argumentin se Kolegji i Posaçëm i Apelit në vendimet nr. 15, datë 17.7.2019 dhe nr. 20, datë 31.7.2019, kanë kufizuar mundësinë për të hetuar personat e tjerë të lidhur, nuk qëndron, pasi, pavarësisht se prindërit e subjektit nuk konsiderohen persona të tjerë të lidhur sipas pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016 në lidhje me shitblerjen e këtij apartamenti, ky fakt nuk mund të cenojë apo të shmangë detyrimin që ka Komisioni për të kryer hetime për çdo pasuri për të cilën ka dyshime të arsyeshme se është një pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit.

2.40 Për këtë arsye, Komisioni kreu një hetim të thelluar mbi pasuritë të ardhurat dhe shpenzimet e prindërve, referuar po të njëjtit vendim të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i cili pas paragrafit të referuar nga subjekti i rivlerësimit, në vendimin nr. 15, datë 17.7.2019, arsyeton se : *“Pavarësisht, ky arsyetim në asnjë rast nuk duhet të pengojë organet e rivlerësimit që të hetojnë çdo situatë të dyshuar se personat e tjerë të lidhur mbajnë pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit, ..., dyshim i cili duhet të ngrihet mbi rrethana objektive”*. Dhe në vendimin 20, datë 31.7.2019, arsyeton se: *“Kolegji vlerëson se për sa kohë që personat e tjerë të lidhur nuk janë subjekte rivlerësimi, analiza dhe vlerësimi i pasurisë së tyre duhet të bëhet në kufijtë e pasurisë së dhënë hua apo dhuruar dhe sipas një vlerësimi logjik e të arsyeshëm, referuar rasteve konkrete e rrethanave specifike të tyre, përveç rasteve të ekzistencës së dyshimeve për pasuri të fshehura në emër të personave të tjerë të lidhur”*.

2.41 Sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016: *“Anëtarët e Komisionit, gjyqtarët e Kolegjit të Apelit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit.”*

2.42 Më tej , “pasuri” - sipas përcaktimit të nenit 3, paragrafi 11, të ligjit nr. 84/2016 - janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas

parashikimit të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit. Ky përcaktim qartazi përfshin edhe pasuritë në përdorim të subjektit të rivlerësimit, i cili ka deklaruar se e ka përdorur këtë apartament dhe ka jetuar bashkë me prindërit⁴¹.

2.43 Komisioni vlerëson se ekzistojnë disa fakte dhe rrethana në lidhje me këtë transaksion të shitblerjes midis babait të subjektit dhe subjektit, të cilat nuk janë plotësisht të besueshme, si vijon: **(i)** mungesa e burimeve financiare të ligjshme për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve nga babai i subjektit/ z. Neritan Cena, me një balancë negative 4,924,958 lekë; **(ii)** blerja e këtij apartamenti në Tiranë nga babai i subjektit, ndërkohë që ky i fundit jetonte dhe punonte në Kukës⁴² dhe njëkohësisht kishte në pronësi dhe një ndërtesë tjetër dhe truall në Yzberisht; **(iii)** deklarin e subjektit se së bashku me bashkëshorten dhe fëmijët, ka filluar të banojnë në këtë apartament në të njëjtën kohë që kjo pasuri ka filluar të përdoret edhe nga pronarët e saj (prindërit e subjektit); **(iv)** mospërputhjet në deklarin e subjektit me provat e administruara në lidhje me periudhën e jetesës së përbashkët me prindërit në këtë apartament; **(v)** marrja hua kumatës/personit tjetër të lidhur/M.Sh. shumën 5.400.000 lekë për të blerë apartamentin te babai i tij, ndërkohë që kunata e subjektit mund të kishte investuar këtë shumë në “Raiffesen Invest” dhe të kishte fituar interesat, si dhe mos shlyerja e shumës së marrë hua deri në vitin 2018; **(vi)** shpjegimet e subjektit gjatë seancës dëgjimore se blerja e apartamentit nga prindërit kishte ardhur si rezultat i mosmarrëveshjeve midis bashkëshortes së subjektit dhe nënës së tij, shkak i cili nuk ishte pretenduar asnjëherë gjatë hetimit, dhe për më tepër, sërish në vitin 2018, babai i jep subjektit hua në shumën 3.400 euro për blerjen e një apartamenti në plazh.

2.44 Për sa i përket pretendimit të subjektit se Komisioni ka interpretuar gabim deklarin e subjektit në pyetësin nr. 3, lidhur me periudhën e jetesës së përbashkët me prindërit, nuk qëndron, pasi duke analizuar përgjigjen, subjekti ka deklaruar: [...] Në vitin 2016 për periudhën nga data 1.1.2016 deri në muajin tetor 2016 kam jetuar me bashkëshorten S.C. dhe 2 (dy) vajzat e mia I. dhe A.C., si dhe me 2 (dy) prindërit e mi B. dhe E.C. [...], dhe më tej ka vijuar [...]. Për periudhën 1.11.2016 deri më 31.12.2016, kam jetuar me bashkëshorten S.C. dhe 2 (dy) vajzat I. dhe A.C. [...]. Gjithashtu, në pyetësin nr. 4, ku subjekti është pyetur për adresat e banimit të prindërve, ka deklaruar se për periudhën 1.5.2012 – 1.11.2016 prindërit e tij kanë jetuar me subjektin dhe familjen e tij. Pra, subjekti ka përcaktuar qartë dhe pa ekuivokë se ka jetuar me prindërit deri më 1.11.2016. Për këtë arsye, me anë të deklarin të noteres E.A. në kontratën nr. ***, datë 18.10.2016, ku specifikohen vendbanime të ndryshme të prindërve dhe të subjektit në momentin e hartimit të kontratës, **provohet se subjekti nuk ka deklaruar në**

⁴¹ Referohu DPV-ve të viteve 2013, 2014, 2015 dhe 2016 dhe deklarinëve në pyetësin standard të subjektit, përgjigje e pyetjes nr. 1, i cili deklaron se: “Nga viti 2012 dhe aktualisht kam banuar në adresën e shënuar në vetdeklarim dhe konkretisht në adresën : Rruga “****”, Pallati “****”, Kulla ***, Ap ****”.

⁴² Sipas deklarin të vetë subjektit të rivlerësimit për efekt të shpenzimeve jetike ku pretendon se babai nga vitit 2012 – 2016 qëndronte më shumë në Kukës, dhe sipas disa kontratave të ndryshme të administruara nga noterët, për efekt hetimit, ku shtetasi B.C. ka qënë palë, konstatohet se në të shumtën e rasteve vendbanimi i tij i deklaruar është në Kukës, një herë Yzberisht, Tiranë dhe një herë Tiranë, pa përcaktuar adresë të saktë.

mënyrë të saktë periudhën e jetesës së përbashkët me prindërit në apartamentin e tyre, apartament i cili më vonë është blerë nga subjekti i rivlerësimit.

2.45 Komisioni e nënvizon faktin se në këtë rast, babai i subjektit të rivlerësimit ka detyrimin për të provuar burimet e ligjshme të blerjes së kësaj pasurie referuar nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, nen i cili lejon organet e rivlerësimit të hetojnë në drejtim të verifikimit e kontrollit të pasurisë çdo situatë, fakt apo cilësi, në funksion të realizimit të qëllimit të këtij procesi, lejim i cili jo detyrimisht lidhet me cilësimin e personave të tretë si persona të tjerë të lidhur në lidhje me këtë pasuri.

2.46 Në vijim të kësaj analize, Komisioni konstaton se shpjegimet që subjekti i rivlerësimit ka dhënë në lidhje me marrëdhënien me këtë pasuri, janë kontradiktore, nuk bindin për vërtetësinë e deklaramit të tij se ka pasur vetëm të drejta përdorimi nga vitit 2012 – 2016 mbi këtë apartament, por ngrenë dyshime forta për paraqitjen e rrethanave të rreme, të cilat tentojnë të fshehin nga kontrolli apo verifikimi një marrëdhënie të një natyre tjetër, që është ajo e pronësisë me këtë pasuri që nga momenti i porositjes dhe, më tej, blerjes nga babai i subjektit.

2.47 Për më tepër, sipas shkresës së Gjendjes Civile, shtetasit B.C. dhe E.C. në datën 18.6.2009 e kanë transferuar vendbanimin e tyre nga njësia nr. ***, Tiranë, në lagjen nr. ***, pallati ***, h. ***, ap. ***, Kukës.

2.48 Referuar disa kontratave të ndryshme të administruara nga noterët, ku shtetasi B.C. ka qënë palë, konstatohet se në të gjitha rastet vendbanimi i tij është Kukës, përjashtuar në rastet një herë Yzberisht, Tiranë dhe një herë Tiranë, pa përcaktuar adresë.

2.49 Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore të viteve 2012, 2013, 2014 dhe 2015, nuk ka deklaruar të drejtat reale mbi këtë pasuri, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.

2.50 Referuar analizës ligjore më lart, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e rezultateve të hetimit në lidhje me mungesën financiare nga burime të ligjshme të prindërve për të blerë këtë apartament, në një balancë negative prej 4.924.958 lekësh, në cilësinë e një personi të tretë mbi të cilin ka rrethana të tilla që nuk provojnë mundësinë financiare për blerjen e këtij apartamenti.

2.51 Në përfundim të analizës së sipërpërmendur, duke pasur parasysh:

- mospërputhjen e deklaramive të subjektit me provën e administruar nga notere E.A., për sa i përket jetesës së përbashkët me prindërit në këtë apartament;
- deklarimet kontradiktore mbi kohën e porositjes së këtij apartamenti nga ana e babait;
- mos deklarimi i përdorimit të këtij apartamenti në DPV-të vjetore 2012, 2013, 2014 dhe 2015;
- subjekti ka filluar të jetojë bashkë me familjen e tij në këtë apartament në të njëjtën kohë më pronarët e këtij apartamenti (prindërit e tij);
- faktin që babai i subjektit banonte dhe punonte në Kukës sipas dokumentacionit të administruar, por dhe vetë deklaramive të subjektit;

- kishte pasuri të tjetër në Tiranë dhe duket se nuk ka pasur nevojë për blerjen e këtij apartamenti;
- mungesën e burimeve financiare të ligjshme të babait për të blerë këtë apartament nga të ardhurat e tij 1994 – 2011, në një balancë negative prej 4.924.958 lekësh.

2.52 Komisioni, bazuar në sa më lart dhe në bindjen e brendshme, në zbatim të rregullit të parashikuar në nenin 51 të ligjit nr. 84/2016, arrin në përfundimin se kjo pasuri është një pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit dhe se është përpjekur të ndryshojë faktet që tregojnë natyrën e marrëdhënies së tij me këtë pasuri, duke u gjendur në këtë mënyrë para parashikimeve të pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 33, pika 5, germa “c”, të ligjit nr. 84.2016.

Lidhur me të ardhurat, pasuritë dhe shpenzimet e prindërve për periudhën 2012 – 2018

2.53 Më tej, Komisioni përllorarit të ardhurat, shpenzimet, detyrimet dhe pasuritë e prindërve të subjektit të rivlerësimit për periudhën 2012 – 2018.⁴³

2.54 Nga faktet e analizuara, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me balancat negative të analizës financiare për vitet 2012 në shumën **2,908,499 lekë**, 2013 në shumën **1,326,327 lekë** dhe 2015 në shumën **1,256,548 lekë**, vite gjatë të cilave subjekti ka deklaruar se ka jetuar me prindërit (1.5.2012 – 1.11.2015) duke kontribuar së bashku në shpenzimet e jetesës.

2.55 Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij në përgjigje të barrës së provës, shpjegoi duke deklaruar se balanca pozitive në vitin 2014 në shumën 3.072.218 lekë ka shërbyer për të mbuluar balancën negative të krijuar gjatë vitit 2015. Shuma 1.900.000 lekë e derdhur *cash* në arkën e shoqërisë “****” sh.p.k. rezulton që të jetë derdhur nga babai i subjektit me një pjesë të shumës prej 3.803.640 lekë të tërhequra nga llogaria e tij bankare në vitin 2014.

2.56 Subjekti vijon duke shpjeguar se referuar tabelës financiare në të cilën pasqyrohen të ardhurat, pasuritë dhe shpenzimet e prindërve për periudhën 2012 – 2018 rezulton që për vitin 2014 të jetë pasqyruar si shpenzim për prindërit vetëm shuma prej 1.961.540 lekësh me përshkrimin: “*Pagesa për blerjen e apartamentit ***/***, Tiranë*”, që është shpenzimi i vetëm që prindërit e tij kanë bërë për vitin 2014. Një fakt i tillë, deklaron subjekti, të çon në përfundimin se nga shuma 3.803.640 lekë e tërhequr nga llogaria bankare në vitin 2014 të jetë paguar shuma 1.961.540 lekë për llogari të shoqërisë “****/****”, ndërsa diferenca prej 1.842.100 lekësh rezulton që të jetë mbajtur *cash* me qëllim pagimin e këstit tjetër në vitin 2015.

2.57 Subjekti sqaron se referuar kuadrit ligjor në Republikën e Shqipërisë nuk rezulton që në vitet 2014 dhe 2015 të ketë pasur ndonjë kufizim për shtetasit shqiptarë lidhur me shumën në *cash* që duhet të mbaheshin nga ana e tyre jashtë sistemit bankar. Subjekti shpjegon se në tabelën financiare për vitin 2015 janë pasqyruar si të ardhura të prindërve të tij shuma prej 1.333.965 lekësh dhe, më tej, referuar faktit se shuma prej 1.900.000 lekësh nga babai i tij

⁴³ Në vitin 2018, subjektit ka marrë hua nga babai shumën 3.400 euro për blerjen e apartamentit në Lukovë.

është paguar me një pjesë të shumës prej 3.803.640 lekësh të tërhequra nga llogaria e tij bankare në vitin 2014 nga ku rezulton se pas zbritjes së shpenzimeve jetike në shumën 448.552 lekë, si dhe pas zbritjes edhe të shumës prej 550.000 lekë të përfituar nga babai, rezulton që balanca të mbetet pozitive në shumën 335.413 lekë, diferencë kjo që është e mjaftueshme për të mbuluar edhe shumën prej 60.000 lekësh që mbetet si diferencë për t'u mbuluar nga gjendja *cash* që ka pasur në vitin 2015 në shumën prej 1.842.100 lekë të përshkruar më lart.

Arsyetimi ligjor në lidhje me provat dhe ligjin e zbatueshëm

2.58 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provave shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se:

2.59 Pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se tërheqjet e kryera nga babai në llogaritë bankare në vitin 2014 janë përdorur për të kryer pagesat e dy kësteve të shoqërisë “****” sh.p.k., mbulimin e shpenzimeve jetike dhe dhuratën prej 550.000 lekësh për subjektin, qëndron pasi në lëvizjet e llogarive bankare konstatohet se tërheqjet janë kryer gjatë përiudhës tetor-nëntor të vitit 2014⁴⁴, ndërkohë që pagesat e kësteve janë kryer në datën 1.12.2014 dhe në datën 6.5.2015, si dhe shuma dhuratë prej 550.000 lekësh është transferuar më 28.12.2015.

2.60 Për sa i përket ligjshmërisë së krijimit të likuditeve të tërhequra nga llogaritë bankare, Komisioni i ka kaluar barrën e provës, të cilën subjekti e ka refuzuar.

2.61 Si konkluzion, lidhur me balancat negative të viteve 2012 dhe 2013, subjekti nuk paraqiti argumente apo shpjegime dhe për këtë arsye, pretendimet e tij lidhur me marrjen përsipër nga ana e babait të një vlere prej 100.000 lekësh të shpenzimeve jetike të famijes së subjektit për vitet në fjalë nuk u morën në konsideratë për sa kohë prindërit e tij rezultojnë me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të mbuluar shpenzimet e tyre dhe për blerjen e pasurive.

Lidhur me analizimin e burimit të blerjes së apartamentit nga subjekti i rivlerësimit

2.62 Në deklaratën *Vetting*, subjekti deklaroi se si burim krijimi i këtij apartamenti është huamarrja nga kunata e tij (motra e bashkëshortes), në shumën 5.400.000 lekë. Si dokument provues ka paraqitur derdhjen e kësaj shumë në “Raiffeisen Bank” në datën 10.8.2016, me objekt “dhënie hua motrës” nga M.Sh. me përfitues S.C. Gjithashtu, subjekti ka dorëzuar shkresën e datës 19.10.2016, nga “Raiffeisen Bank”, H., sipas së cilës, me kërkesës të personit tjetër të lidhur/M.Sh. është bërë transferata bankare jashtë shtetit në shumën 41.744 euro, kryer

⁴⁴ Tërheqje në shumën 1.000.000 lekë nga “Credins Bank” në datën 28.10.2014 dhe në shumën 2.797.700 lekë nga “Raiffeisen Bank” në datën 10.11.2014.

në datën 10.8.2015 dhe shuma 50.000 euro në datën 24.8.2015. Këto shuma kanë si burim shitjen e një shtëpie në adresën *** H. dhe nga librezat e kursimit në “Raiffeisen Bank”, H.

2.63 Me pyetëtorin nr. 2⁴⁵, subjektit iu kërkua të paraqesë dokumentacion justifikues ligjor në lidhje me të ardhurat e ligjshme nga personat e tjetër të lidhur M. dhe A.Sh., numrin e personave të përbërjes familjare, shpenzime të kryera për jetesë apo dhe të tjera, si dhe nëse kanë investuar në pasuri, me qëllim përlogaritjen e mundësisë së tyre për të dhënë hua.

2.64 Në përgjigje të pyetëtorit nr. 2⁴⁶, subjekti dorëzoi në cilësinë e provës vërtetimin e lëshuar nga “Raiffeisen Bank”, Austri, datë 25.7.2019, me përshkrimin: “*Transfertë parash për në Shqipëri në vlerën 41.744,39 euro, në datën 10.8.2015 dhe në vlerën 50.000,00 euro, në datën 24.8.2015 – vërtetim mbi prejardhjen e të ardhurave*”, ku përcaktohet se të ardhurat e transferuara në Shqipëri në vlerën 41.744,39 euro (41.850,39 euro përfshirë taksat) të dërguara në datën 10.8.2015 dhe në vlerën 50.000,00 (50,106.00 euro përfirë taksat) të dërguara në datën 24.8.2015, vijnë nga shitja e një prone (shitje shtëpie në *** H.) dhe nga librezat e kursimeve në “Raiffeisen Bank”, H.

2.65 Gjithashtu, subjekti dorëzoi: (1) kontratën e shitjes, datë 21.7.2015, të lidhur ndërmjet shtetasve M. dhe A.Sh. nga njëra anë me cilësinë e shitësve dhe shtetas J. W. në cilësinë e blerëses, për shitjen e një banesë të ndodhur në H., Austri, me çmim 60.000 euro, ku parashikohet: “*pagesa e çmimit të blerjes që duhet të paguhet nga administruesi i besuar brenda 2 javësh nga nënshkrimi i kontratës nga të gjitha palët kontraktuese do të bëhet me anë të një besimi përmes kontraktuesit në përputhje me marrëveshjen përkatëse të besimit*”; dhe (2) kontratën e blerjes, datë 10.12.2014, të lidhur ndërmjet shtetas U.S. nga njëra anë me cilësinë e shitëses dhe shtetasit A.Sh. në cilësinë e blerësit, për blerjen e pasurisë me sipërfaqe ndërtimi 112 m² dhe kopësht me sip. 1.120 m², të ndodhur në ***, me çmim 90.000 euro, ku në pikën III parashikohet: “*Çmimi i blerjes prej 90.000 euro, si dhe llogaritja e taksave në vlerën 3.150 euro do të paguhet brenda 14 ditësh nga përpilimi i kontratës në llogarinë e administrimit të besuar*”. Më tej, subjekti dorëzoi të ardhurat e z. A.Sh. për vitet 2015 – 2018, si dhe znj. M.Sh. për vitet 2015 dhe 2016.

2.66 Në dokumentacionin e administruar nga “Raiffeisen Bank”⁴⁷ konfirmohet se në datën 10.8.2016 është transferuar shuma prej 5.400.000 lekësh nga znj. M.Sh. te bashkëshortja e subjektit me përshkrim: “*dhënie hua motrës*”.

2.67 Për të hetuar origjinën e kësaj shume, Komisioni analizoi transaksionet në llogaritë bankare të personit tjetër të lidhur/M.Sh., ku evidentohet se janë kredituar këto shuma: (1) në datën 25.8.2015 janë transferuar 49.940 euro, shumë e cila vjen nga shitja e apartamentit në Austri dhe kursimet, bazuar në vërtetimin e lëshuar në datën 25.7.2019 nga dega e “Raiffeisen Bank” në H., Austri, dhe në kontratën e shitjes së depozituar nga subjekti; (2) në datë 12.8.2015 janë depozituar *cash* 5.000 euro; (3) në datën 12.8.2015 janë transferuar 41.694 euro nga shtetasja A.V./motra e M.Sh. me përshkrim: “*kalim motrës, kthim detyrimi*”.

⁴⁵ E-mail datë 30.4.2020, ora 12:52.

⁴⁶ E-mail datë 11.5.2020, ora 10:45 .

⁴⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 4.5.2020.

2.68 Pas kreditimeve të mësipërme, është kryer një konvertim në datën 2.9.2015, duke debituar llogarinë në euro në shumën 82.000 euro dhe duke kredituar llogarinë në lekë në shumën 11.988.400 lekë. Kjo e fundit, së bashku me një depozitim *cash* në shumën 3.300.000 lekë në datë 31.8.2015 më përshkrim: “*të ardhura nga emigrimi në Austri*”, ka shërbyer për një investim në vlerën 15.200.000 lekë në fondin “*Raiffeisen Prestige*”. Shuma e dhënë hua në vlerën 5.400.000 lekë e ka burimin nga nga shlyerja pjesore e këtij fondi në datën 8.8.2016, në vlerën 6.586.072 lekë.

2.69 *Lidhur me kthimin e huasë*, Komisioni konstaton se deri në fund të vitit 2018, kjo hua është ende e pashlyer.

2.70 Në pyetësonin nr. 5, subjektit iu kërkua që të vendosë në dispozicion të Komisionit: (i) lëvizjet e llogarive bankare të personave të tjerë të lidhur/M. dhe A.Sh. në “*Raiffeisen Bank*”, H.; (ii) dokumentacion justifikues ligjor në lidhje me të ardhurat e ligjshme të personave të tjerë të lidhur/M. dhe A.Sh. (nga pagat, shitje e pasurive të paluajtshme etj), numrin e personave të përbërjes familjare, si dhe shpenzime e kryera për jetesë apo dhe të tjera, nëse kanë investuar në pasuri (të luajtshme, të paluajtshme, llogari bankare etj), me qëllim për të analizuar mundësitë e tyre financiare për të blerë pasuri dhe mundësinë për të dhënë një hua në vlerën 5.400.000 lekë, e cila rezulton e pashlyer.

2.71 Në përgjigje të pyetësonit, subjekti i rivlerësimit i qëndron shpjegimeve dhe provave të paraqitura në deklaratën *Vetting*, si dhe gjatë pyetësorve të mëparshëm, si: (i) vërtetim të lëshuar nga “*Raiffeisen Bank*”, Austri që mban datën 25.7.2019, me objekt: “*Transfertë parash për në Shqipëri në vlerën 41.744,39 euro në datën 10.8.2015 dhe në vlerën 50,000.00 euro në datën 24.08.2015 – vërtetim mbi prejardhjen e të ardhurave*”; (ii) lidhur me të ardhurat e kumatës, M.Sh. dhe bashkëshortit të saj A.Sh., subjekti shpjegon se ka dërguar me cilësinë e provës të ardhurat e përfituara prej bashkëshortit të kumatës, shtetasit A.Sh. për vitet 2015 – 2018, si dhe të ardhurat e kumatës M.Sh. për vitet 2015 dhe 2016 të përkthyer dhe të noterizuar.

2.72 Gjithsesi, Komisioni referuar provave dhe shpjegimeve të dërguara deri më tani, nuk krijon bindjen se personi tjetër i lidhur të ndodhej në kushtet e favorshme ekonomike për të dhënë hua pa interes, referuar vërtetimeve të të ardhurave për vitin 2015 dhe 2016, nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, duke përfshirë të ardhurat *neto*, shpenzimet jetike sipas standardit të varfërisë në Austri, personat e tjerë të lidhur/M. dhe A.Sh. dalin me balancë pozitive minimale për vitin 2015, në shumën 5.286,35 euro, vit në të cilin i kanë dhënë edhe një hua tjetër subjektit për blerje makine dhe për vitin 2016 me balancë pozitive në shumën 11.961,73 euro.

2.73 **Nga faktet e analizuara, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D, të Aneksit të Kushtetutës**, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me dyshimet mbi aftësitë financiare të personave të tjerë të lidhur për të dhënë hua shumën prej 5.400.000 lekësh, pasi: (i) personat e tjerë të lidhur/M. dhe A.Sh. sipas analizës financiare rezultojnë me balancë pozitive minimale për vitin 2015, në shumën 5.286,35 euro (vit në të cilin i kanë dhënë edhe një hua tjetër subjektit për blerje makine) dhe për vitin 2016 me balancë pozitive në shumën 11.961,73 euro; (ii) mungon dokumentacioni justifikues ligjor në lidhje me të ardhurat

e ligjshme të personave të tjerë të lidhur/M. dhe A.Sh., për të ardhurat (përveç viteve 2015 dhe 2016), llogaritë bankare dhe shpenzime të tjera për periudhën 2010 – 2016. Pavarësisht këtyre dyshimeve, Komisioni lidhur me ligjshmërinë e burimit të huas në vlerën 5.400.000 lekë, njoftoi subjektin se kjo shumë është përfshirë në analizën financiare deri në paraqitjen e shpjegimeve dhe provave të subjektit

2.74 Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij në përgjigje të barrës së provës, shpjegoi duke deklaruar se: *Nëse shumat e transferuara në vitin 2015 nga Austria për në Shqipëri nga ana e A. dhe M.Sh. dhe konkretisht nëse shumat prej 41.744,39 euro (41.850,39 euro përfshirë taksat) të dërguara në datën 10.8.2015 dhe 50.000,00 (50,106.00 euro përfshirë taksat) të dërguara në datën 24.8.2015, nuk do të ishin shuma të ligjshme, si dhe nëse mbi këto shuma nuk do të ishte paguar tatimi mbi të ardhurat ose fitimin, nuk do të lejohej transferimi i tyre për në Shqipëri. Referuar përmbajtjes së vërtetimit bankar të dorëzuar në deklaratën Vetting, rezulton të jetë përcaktuar qartë se një pjesë e shumës dhe konkretisht shuma prej rreth 31.000 euro të jenë kursime.*

2.75 Referuar analizës financiare rezulton që shuma prej 31.000 euro nuk do të mund të kursehej nga A. dhe M.Sh. vetëm në vitin 2015. Një fakt i tillë të shpie në përfundimin se kemi të bëjmë me kursime të akumuluar ndër vite.

2.76 Subjekti deklaron se në referim të faktit të sipërcituar nuk e vlerëson të arsyeshme të paraqes vërtetimet mbi të ardhurat e shtetasve A. dhe M.Sh. para vitit 2015, për shkak se i ka konsideruar të mjaftueshme provat e paraqitura.

2.77 Megjithatë, subjekti deklaron se paraqet në cilësinë e provës edhe vërtetimet mbi të ardhurat nga puna të shtetasve A. dhe M.Sh. për vitet 2013 dhe 2014 dhe i referohet përsëri vendimit të Kolegjit, në kushtet kur marrëdhënia e huas me A. dhe M.Sh. ka filluar në vitin 2013, me anë të transferimit në rrugë bankare prej tyre në vitin 2013 të shumës prej 5.000 euro.

2.78 Subjekti shpjegon se të ardhurave neto për shtetasit A. dhe M.Sh. (për vitin 2013 rezulton të jenë në shumën 24.444,2 euro; për vitin 2014 në shumën 24.109,79 euro; për vitin 2015 në shumën 34.593,1 euro; për vitin 2016 në shumën 41.863,73 euro), duhet t'u shtohen edhe shuma që shteti Austriak jep për rritjen e fëmijëve. Një fakt i tillë provohet referuar shkresës së datës 4.4.2019, të lëshuar nga Zyra e Financës E., në të cilën konfirmohet marrja e ndihmës për fëmijët K. dhe M.Sh. respektivisht për periudhën tetor 2007 – qershor 2021 dhe nëntor 2006 – nëntor 2024. Kjo ndihmë referuar çekut që subjekti paraqitet në cilësinë e provës është në shumën 414 euro/muaj.

2.79 Për rrjedhojë të sa më lart, subjekti sqaron se në total të ardhurat për familjen të shtetasve A. dhe M.Sh. për vitin 2013 janë 29.412,2 euro; për vitin 2014 janë 29.077,79 euro; për vitin 2015 janë 39.561,1 euro; për vitin 2016 janë 46.831,73 euro.

2.80 Më tej, subjekti i referohet përfundimeve të arritura nga Kolegji i Pasaçëm i Apelimit, duke shpjeguar se me qëllim për të provuar mundësinë e dhënies hua të shumës prej 5.400.000 lekësh nga A. dhe M.Sh. do të ishte e mjaftueshme vetëm shuma prej 60.000 euro që kanë përfituar nga shitja e banesës. Shuma e investuar në vitin 2015 prej 15.200.000 lekësh, me përshkrimin: *“Të ardhura nga emigrimi në Austri”*, tregon një qëndrueshmëri financiare të

shtetasve A. dhe M.Sh. Referuar analizës së Komisionit rezulton që të ardhurat e A. dhe M.Sh. të jenë në rritje dhe jo në zbritje. Një fakt i tillë të shpie në përfundimin se kanë qëndrueshmëri financiare.

2.81 Subjekti pretendon se Komisioni nuk ka përlogaritur saktë minimumin jetik çift me 2 fëmijë në Austri dhe se shuma e nxjerrë bie në kundërshtim me të dhënat zyrtare për Austrinë të publikuara nga Komisioni European, pasi referuar faqes zyrtare të Komisionit European, rezulton se në Austri në vitin 2019 standardet minimale janë: personat e vetëm, prindërit e vetëm rreth 885 euro/muaj; çiftet (për person) afro 664 euro/muaj; standardet minimale për fëmijët e mitur përcaktohen ndryshe në secilën provincë. Standartet minimale për fëmijët e mitur janë midis 159 euro dhe 239 euro/muaj në varësi të provincës. Në përgjithësi 25 % e standardeve minimale janë për mbulimin e kostove të strehimit.

2.82 Për sa më sipër, vijon subjekti, kostoja minimale e jetesës në vitin 2019 në *land-in* ku jetojnë A. dhe M.Sh. janë 21.672 euro, do të zbritet 25 % në kushtet kur kanë jetuar në banesën e tyre në H. Sipas kësaj llogjike subjekti ka përlogaritur kostot për vitet 2015 dhe 2016.

2.83 Subjekti deklaroi se ka kërkuar informacion pranë INSTAT në Austri, për periudhën 2013 – 2020, me qëllim përcaktimin sa më saktë të kostos minimale të jetesës në Austri, si dhe kërkoi që kjo pjesë të rishikohet pas ardhjes së përgjigjes me *e-mail*.

2.84 Më tej, në datën 30.9.2020, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në Komision⁴⁸ disa prova shtesë lidhur me këto pretendime, konkretisht: **(i)** përgjigjen me *e-mail* nga Instituti i Statistikave të Austrisë⁴⁹, ku citohet se të dhënat e kërkuara janë në dispozicion vetëm për vitet 2017 – 2019, ndërsa për sa i përket ndihmës financiare për fëmijët në Austri ekzistojnë një mori përfitimesh, për përmbledhjen e të cilave referon një faqe interneti⁵⁰; **(ii)** një tabelë në gjuhën gjermane me të dhëna statistikore për vitin 2019; **(iii)** tre tabela të përkthyer në gjuhën shqipe me informacion për vitet 2017, 2018 dhe 2019; **(iv)** një *e-mail* drejtuar shtetasit A.Sh., ku, në përgjigje të kërkesës së këtij të fundit, specifikohen shumat e ndihmës familjare për fëmijët e personave të tjerë të lidhur/A.Sh. dhe M.Sh., për periudhën janar 2013 – dhjetor 2016, si edhe informacion ligjor të federatës (ILF) lidhur me këto ndihma.

2.85 Referuar tabelave të cituara më lart, subjekti shpjegon se kostoja minimale e jetesës (për familje) në *land-in* e B., ku jeton kunata e tij së bashku me bashkëshortin dhe dy fëmijët, është në vlerën 598 euro/muaj për vitin 2017, në vlerën 772 euro/muaj për vitin 2018 dhe në vlerën 783 euro/muaj për vitin 2019.

Arsyetimi ligjor në lidhje me provat dhe ligjin e zbatueshëm

2.86 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratën e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provave shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe

⁴⁸ Protokolluar me nr. *** prot., datë 30.9.2020.

⁴⁹ Përkthyer nga përkthyes i licensuar dhe vërtetuar nga noteri public.

⁵⁰https://www.***.

provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se:

2.87 Në lidhje me koston e jetesës në Austri, duke analizuar shpjegimet dhe provat e dorëzuara në datën 22.9.2020 dhe atyre në seancë dëgjimore, Komisioni konstaton se në *e-mailin* e datës 16.9.2020, drejtuar zyrës së statistikave në Austri, subjekti u ka kërkuar disa të dhëna statistikore duke specifikuar “[...] për efektet e këtij kontrolli autoritetet shqiptare kanë përshirë gjithashtu disa të dhëna për sigurimin minimal në Austri. Këto të dhëna janë marrë nga autoritetet shqiptare duke iu referuar faqes www.appssso.eurostat.ec.europa.eu. Sidoqoftë këto të dhëna nuk tregojnë se sa ka qenë sigurimi minimal në Austri për vitet 2013-2020”

2.88 Më tej, konstatohen të dhënat statistikore të përcjella nga subjekti në datën 30.9.2020, referuar emërtimit të tabelës në gjuhën shqipe, kanë të bëjnë me shumën e përfitimit minimal të sigurimeve shoqërore për kategorinë e komunitetit të përfitimeve si mesatare vjetore për vitet 2017, 2018 dhe 2019, sipas *land-eve* gjermane.

2.89 Pra, vërehet se këto të dhëna nuk kanë të bëjnë me koston minimale të jetesës në *land-e* të caktuara, sikurse pretendon subjekti në shpjegimet e tij, por me përfitimin minimal të ofruar nga shteti për kategoritë e njerëzve që përfitojnë asistencë sociale.

2.90 Gjithashtu, në përgjigjen me *e-mail* të zyrës së statistikave të shtetit austriak citohet “[...] për sa i përket ndihmës financiare për fëmijët në Austri ekzistojnë një mori përfitimesh [...]”, ndërkohë që në kërkesën e drejtuar nga subjekti nuk është parashtruar një kërkesë e tillë, çka çon në përfundimin se subjekti ka pasur komunikime të tjera me këtë zyrë, të cilat nuk i ka vendosur në dispozicion të Komisionit.

2.91 Në analizë të pretendimit të subjektit se shuma e përlogaritur për shpenzimet e jetesës rezulton që të vijë në kundërshtim edhe me vetë të dhënat zyrtare për Austrinë të publikuara nga Komisioni Europian, Komisioni çmon të theksojë se vlera e këtyre shpenzimeve është gjeneruar pikërisht nga faqja zyrtare e internetit të Komisionit Europian, metodologji e cila bazohet në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit⁵¹ dhe *link-u* konkret i është vënë në dispozicion subjektit në relacionin mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

2.92 Në vijim pasqyrohet edhe pamja e gjeneruar nga faqja zyrtare *online* lidhur me të dhënat për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016.

At-risk-of-poverty thresholds - EU-SILC and ECHP surveys

Last update: 09-09-2020

HHTYP: Two adults with two children younger than 14 years
INDIC_IL: At risk of poverty threshold (60% of median equivalised income)
CURRENCY: Euro

TIME ▶	2013	2014	2015	2016
GEO ▼				
Austria	27,812	29,245	29,308	29,855

No footnotes available

⁵¹ Vendim nr. 19-2019 (JR), datë 26.7.2019; vendim nr. 28-2019 (JR), datë 30.10.2019; vendim nr. 32-2019 (JR), datë 21.11.2019.

2.93 Lidhur me pretendimin e subjektit gjatë prapësimeve për përlllogaritjen e shpenzimeve jetike bazuar në *land*-in ku jetojnë personat e tjerë të lidhur/A. dhe M.Sh., pra, në B., Komisioni iu referua të dhënave statistikore të raportit “*verbrauchsausgaben – 2014 – 2015*”, i publikuar në faqen zyrtare në zyrës federale të statistikave⁵² në shtetin austriak, ku vërehet se në faqen nr. 151 pasqyrohen të dhëna statistikore lidhur me shpenzimet mujore⁵³ për një familje⁵⁴ në këtë *land* dhe shuma mujore e shpenzimeve për familje në vitin 2014-2015 rezulton të ketë qenë 2.810 euro/muaj (33.720 euro/vit).

2.94 Në përmbledhje të sa më lart, rezulton se pretendimi i subjektit për përlllogaritjen e shpenzimeve jetike për një familje që jeton në Austri në shumën 7.176 euro/vit, nuk qëndron, pasi sipas faqes zyrtare të Komisionit European, pragu i varfërisë në Austri ka qenë në shumën 27.812 euro/familje për vitin 2013; në shumën 29.245 euro/familje për vitin 2014; në shumën 29.308 euro/familje për vitin 2015; në shumën 29.855 euro/familje për vitin 2015 dhe sipas faqes së statistikave në Austri, shpenzimet e jetesës në B. për vitin 2014-2015 kanë qenë 33.720 euro/vit.

2.95 Komisioni vlerëson se në rast se subjekti do t’i ishte përgjigjur barrës së provës, duke dorëzuar lëvizjet e llogarive bankare të personave të tjerë të lidhur/A.Sh. dhe M.Sh., do të mund të përcaktohej në mënyrë konkrete dhe sa më pranë realitetit, vlera e shpenzimeve të kryera nga familja Sh., të ardhurat *neto* nga punësimi dhe ndihma e përfituar për fëmijët.

2.96 Për sa më sipër, për efekt të analizës financiare, Komisioni mori në konsideratë shpenzimet jetike në prapun e varfërisë, duke iu referuar kështu faqes zyrtare të Komisionit European

2.97 Lidhur me ndihmën e përfituar për fëmijët, subjekti shpjegon se shumës së të ardhurave vjetore të shtetasve M. dhe A.Sh. duhet t’u shtohet edhe shuma që shteti austriak jep për rritjen e fëmijëve, ku konkretisht për vitin 2013 rezulton që për fëmijët K. dhe M.Sh. të kenë përfituar një shumë prej 2.793,60 euro. Për rrjedhojë, sqaron subjekti, të ardhurat totale të famijes Sh. duhen përlllogaritur në shumën 27.237,80 euro për vitin 2013, në shumën 26.903,39 euro për vitin 2014, në shumën 37.386,70 euro për vitin 2015, në shumën 44.657,33 euro për vitin 2016.

2.98 Bazuar në provat e dorëzuara dhe shpjegimet e subjektit, Komisioni përlllogariti të ardhurat vjetore nga ndihma për fëmijët, e detajuar në tabelën në vijim, nga ku rezulton se për vitin 2013 shuma e ndihmës për fëmijët ka qenë në shumën 4.233,90 Euro, për vitin 2014 në shumën 4.497,60 euro, për vitin 2015 në shumën 4.604,60 euro dhe për vitin 2016 në shumën 4.706,40 euro.

⁵²https://www.statistik.at/web_de/statistiken/menschen_und_gesellschaft/soziales/verbrauchsausgaben/konsumerhebung_2014_2015/index.html

⁵³ *Monthly expenditure of private households - Expenditure per household*

⁵⁴ a) Madhësia mesatare e familjes në këtë sondazh ka qenë 2.23 persona (*Die durchschnittliche Haushaltsgröße in der Konsumerhebung 2014/15 beträgt 2,23 Personen*); b) llogaritja sipas shkallës së BE-së: i rrituri i parë = 1, çdo person i rritur shtesë mbi 14 vjeç = 0,5, çdo fëmijë nën 14 vjeç = 0,3 (*Berechnung nach der EU-Skala: Erste erëachsene Person = 1, jede äitere Person im Haushalt ab 14 Jahren = 0,5, Kinder unter 14 Jahren = 0,3*).

Viti	Periudha	Vajza	Djali	Ndihma 1 / total në muaj për 2 fëmijë	Ndihma 2 / total në muaj për 2 fëmijë ⁵⁵	Total periudhe
2013	Janar - Maj 2013	112.70 €	112.70 €	225.40 €	116.80	1,711.00 €
2013	Qershor - Gusht 2013	112.70 €	123.60 €	236.30 €	116.80	1,059.30 €
2013	Shtator 2013 - Qershor 2014	119.10 €	130.00 €	249.10 €	116.80	1,463.60 €
2014		119.10 €	130.00 €	249.10 €	116.80	2,195.40 €
2014	Korrik 2014 - Dhjetor 2015	142.90 €	124.00 €	266.90 €	116.80	2,302.20 €
2015		142.90 €	124.00 €	266.90 €	116.80	4,604.40 €
2016	Janar - Tetor 2016	145.70 €	126.50 €	272.20 €	116.80	3,890.00 €
2016	Nëntor - Dhjetor 2016	145.70 €	145.70 €	291.40 €	116.80	816.40 €

2.99 Në përfundim të sa më sipër, Komisioni përlloritari të ardhurat dhe shpenzimet e personave të tjerë të lidhur/A. dhe M.Sh., nga ku rezultoi: (1) për vitin 2013 rezulton një balancë pozitive prej 866,1 euro⁵⁶; (2) për vitin 2014 rezulton një balancë negative prej 637.61 euro⁵⁷; (3) për vitin 2015 rezulton një balancë pozitive prej 5.902,75 euro⁵⁸; (4) për vitin 2016 rezulton një balancë pozitive prej 16.668,13 euro⁵⁹.

2.100 Përsa i përket ligjshmërisë së huasë prej 5.400.000 lekë, Komisioni vlerëson se në këtë rast është i panevojshëm arsyetimi lidhur me mundësitë financiare të personave të tjerë të lidhur/A. dhe M.Sh. referuar konkluzionit në paragrafin 2.52

3. Pasuri e paluajtshme – banesë, në B., Gjermani, me vlerë 48.500 euro

Faktet nga hetimi i administrativ kryesisht

3.1 Në deklaratën Vetting të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Blerë në datën 28.9.2016, nga shtetasi E.M. me kontratën me nr. regjistri ***, të lidhur para noterit publik L. W. me seli në B., Gjermani. Kjo kontratë është lidhur me shtetasin E.M. pas tërheqjes nga kontrata e lidhur para të njëjtit noter me këtë shtetas me nr. ***. Pasuria është blerë me shumën e dërguar me transfertë më parë në datën 7.9.2016 për kontratën nr. ***. Me kontratën nr. ***, të lidhur në datën 28.9.2016, është blerë kjo pasuri e paluajtshme: 91/10.000 pjesë e pronës në bashkëpronësi në truallin në rajonin V., L, korridori ***, sipërfaqja e korridorit ***/***, E. – E. – Str. *** -*** (numra tek) dhe I. – K. – S. ***-*** (numra tek) dhe H. – H. – S. ***-***, ndërtesë dhe sipërfaqe e lirë, sipërfaqe e korridorit ***/***, E. – E. – Str. ***-*** (numra tek) dhe I. – K. – S. ***-*** (numra tek) dhe H. – H. – S. ***, ***, ***, ndërtesë dhe sipërfaqe e lirë, sipërfaqja totale 13.400 m2 e lidhur me pronën e veçantë në banesën e emërtuar në plan me nr. ***. Vlera 48.500 Euro. Pjesa takuese 100%.

3.2 Si burim krijimi subjekti deklaron: (a) Shumën prej 20.000 euro, përfituar nga shitja e automjetit me targa ***, shtetasit I.S. me kontratën e shitblerjes së automjetit me nr. ***, datë 21.7.2016. Automjeti i shitur shtetasit I.S. është blerë nga subjekti me kontratën nr. ***, datë 16.5.2015 të lidhur me shtetasin F.C. në shumën 14.000 Euro. Shuma 14.000 euro që ka

⁵⁵ Ndihma e dytë e konfirmuar edhe në link: <https://www.frauen-familien-jugend.bka.gv.at/familie/finanzielle-unterstuetzungen/familienbesteuerung/kinderabsetzbetrag.html>

⁵⁶ Të ardhurat *neto* 24.444,20 euro, ndihma për fëmijët 4.223,90 euro, shpenzime jetike 27.812 euro.

⁵⁷ Të ardhurat *neto* 24.109,79 euro, ndihma për fëmijët 4.497,60 euro, shpenzime jetike 29.245 euro.

⁵⁸ Të ardhurat *neto* 34.594,35 euro, ndihma për fëmijët 4.604,40 euro, shpenzime jetike 29.308 euro.

⁵⁹ Të ardhurat *neto* 41.816,73 euro, ndihma për fëmijët 4.706,40 euro, shpenzime jetike 29.855 euro.

shërbyer për blerjen e makinës me targa *** nga shtetasi F.C. është siguruar nga shitja e makinës që subjekti ka pasur në pronësi me targa *** me kontratën e shitjes nr. ***, datë 25.4.2015, shtetasit A.Xh. në shumën 850.000 lekë. Shumën prej 3.988 euro marrë hua kumatës M.Sh. me anë të transfertave të datave 4.5.2015, si dhe pjesa tjetër nga kursimet nga paga si gjyqtar. Makina me targa ***, që i është shitur shtetasit A.Xh. është blerë me të ardhurat e siguruara nga shitja e automjetit me targa ***, që ka pasur më parë në pronësi dhe me kontratën eshitjes nr. ***, datë 9.12.2011, e ka shitur në vlerën 400.000 lekë dhe pjesa tjetër nga kursimet nga paga si gjyqtar. (b) Shumën prej 16.150 euro e ka përfituar si dhuratë nga motra znj. E.C. me anë të deklaratës së datës 16.4.2016, e konfirmuar edhe me transfertën bankare të “Raiffeisen Bank” dhe me tërheqjen e shumës prej 4.890 euro nga “Intesa Sanpaolo Bank”, të depozituara në emër të motrës së subjektit E.C. (c) Shumën prej 2.000 euro të përfituara me transfertën e datës 11.7.2016 nga djali i xhaxhait të subjektit, z. F.C. (ç) Shumën prej 9.000 euro të marrë si hua kumatës znj. E.Sh. me transfertën e datës 30.8.2016. (d) Shumën prej 1.108,54 euro, të kursyera nga paga si gjyqtar.

3.3 Subjekti për vërtetimin e deklarimeve të tij ka paraqitur dokumentacion ligjor provues⁶⁰.

3.4 Referuar dokumentacionit të dorëzuar në deklaratën *Vetting*, rezulton e lidhur kontrata nr. *** regjistri, datë 28.9.2016 (në gjuhën gjermane), ndërmjet shtetasit E.M., si palë shitëse dhe shtetasit Neritan Cena, përfaqësuar nga znj. E. G. si palë blerëse, për shitjen e një banese me çmim 48.500 euro. Sipas kontratës, çmimi i blerjes është paguar.

3.5 Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit me anë të kërkesës për transfertë fondesh, datë 7.9.2016, nëpërmjet “Raiffeisen Bank”, ka transferuar në favor të shitësit/E.M., shumën 48.500 euro.

3.6 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka dorëzuar edhe një deklaratë noteriale, lidhur në shtetin gjerman nr. ***, datë 28.9.2016, ndërmjet shtetasit E.M. dhe shtetasit Neritan Cena, përfaqësuar nga E.G., sipas së cilës palët në datën 4.7.2016, kanë lidhur një kontratë noteriale shitblerje ndërmjet tyre me nr. ***, për një banesë. Nëpërmjet kësaj deklaratë, palët kanë revokuar kontratën e lidhur (nr. ***).

⁶⁰ Kontratë shitblerje nr. *** regjistri, datë 28.9.2016, lidhur ndërmjet shtetasit E.M., si palë shitëse dhe shtetasit Neritan Cena, përfaqësuar nga znj. E.G. si palë blerëse; vërtetim përkthimi nr. ***, datë 11.10.2016, deklaratë nr. ***, datë 28.9.2016, ndërmjet shtetasit E.M. dhe shtetasit Neritan Cena, përfaqësuar nga E.G.; vërtetim përkthimi nr. ***, datë 11.10.2016; kërkesë për transfertë fondesh, datë 7.9.2016, nëpërmjet “Raiffeisen Bank”, me përfitues E.M., shuma 48.500 euro, urdhërues Neritan Cena; aktshitblerje nr. ***, datë 25.4.2015 + Rbs + njoftim depozitimi *cash* në llogari nga Neritan Cena; aktshitblerje nr. ***, datë 9.12.2011 për shitjen nga Neritan Cena të automjetit “Mercedes Benz tip 124”, prodhim i vitit 1989, me targa ***, deklaratë noteriale nr. ***, datë 16.4.2016 + kartë identiteti italiane E.C. + njoftim debitimi në llogari të E.C. shuma 4.890 Euro, datë 29.6.2016, në “Intesa Sanpaolo Bank” + tërheqje nga llogaria e Bank”, datë 15.7.2016 e Neritan Cena 77.000 lekë + depozitim në llogari personale në “Raiffeisen Bank”, datë 15.7.2016, Neritan Cena 500 euro/70.000 lekë + depozitim në llogari personale në “Raiffeisen Bank”, datë 22.4.2016, E.C. 500 Euro + depozitim në llogari personale në “Raiffeisen Bank”, datë 29.6.2016, Neritan Cena 4.890 euro + njoftim debitimi i “Raiffeisen Bank”, datë 6.5.2016, urdhërues E.C., përfitues Neritan Cena shuma 11.260 euro, nxjerrje llogarie e “Raiffeisen Bank”, datë 19.5.2015, e S.C. + tërheqje nga llogarie në “Raiffeisen Bank”, datë 5.5.2015 S.C. shuma 3.985 euro; nxjerrje llogari page e E.Sh. në “Raiffeisen Bank”, datë 21.10.2016, për periudhën 6.12.2012 – 21.10.2016; nxjerrje llogarie e Neritan Cena në “Raiffeisen Bank”, datë 13.1.2017.

3.7 Në DPV-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar blerjen e kësaj pasurie dhe burimin e krijimit, deklarim i ngjashëm me deklaratën *Vetting*.

3.8 Në përgjigje të pyetësorit standard 01⁶¹, subjekti deklaroi se këtë pasuri nga data 1.1.2018, ia ka dhënë me qira shtetasve A. dhe E.N., në shumën 688,56 euro/muaj, nga të cilat shuma prej 480 euro përbën qiranë mujore bazë, ndërsa shuma prej 208,56 euro paguhet për shpenzime operacionale.

3.9 Nga hetimi i Komisionit rezulton se subjekti ka lëshuar prokurën e posaçme nr. ***, datë 21.6.2016⁶², sipas së cilës emëron përfaqësuesen shtetasen ruse E.G. të kryejë të gjitha veprimeve ligjore për blerjen e këtij apartamenti. Ajo ka të drejtë që në kontratën e shitblerjes të pasqyrojë faktin e marrëveshjes me pronarin, sipas së cilës pronari ka të drejtë të qëndrojë në shtëpinë ekzistuese për 3 vjet pa qira nga data e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes, pronari nga dita e shitjes merr përsipër të paguajë të gjitha shpenzimet sekondare (drita, ujë, ngrohje, kondomino) deri në momentin e dorëzimit të banesës. Përfaqësuesja e mësipërme disponon miratimin e subjektit të lidhë më vonë kontrata qeraje me persona të tretë.

Lidhur me burimin e krijimit

Burimi I: shuma 20.000 euro, nga shitja e automjetit me targa ***

3.10 Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se një prej burimeve të krijimit të pasurisë banesë është shuma 20.000 Euro, përfituar nga: **(1) shitja e makinës me targa *****, në shumën **14.000 euro**. Kjo shumë është siguruar nga shitja e makinës që ka pasur në pronësi me targa *** blerë në datën 25.4.2015, në shumën 850.000 lekë, kjo e fundit blerë me të ardhurat e siguruar nga shitja e automjetit me targa *** në vlerën 400.000 lekë dhe pjesa tjetër kursimet nga paga si gjyqtar – me shumën pej **3.988 euro**, marrë hua kunatës M.Sh. me anë të transfertave të datave 4.5.2015 – si dhe pjesa tjetër nga **kursimet nga paga si gjyqtar**.

Burimi i krijimit të këtij automjeti – trajtuar në mënyrë të detajuar në vijm.

3.11 Subjekti i rivlerësimit me kontratën nr. ***, datë 21.7.2016, e ka shitur këtë automjet kundrejt çmimit prej 20.000 euro, vërtetuar me transfertën bankare, datë 21.7.2016, në BKT.

3.12 Komisioni vëren se mjeti është shitur pas 14 muajsh me një diferencë prej 6.000 euro më shumë nga çmimi i blerjes.

3.13 Në përgjigjen e përcjellë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë⁶³, nuk evidentohet pagesa e detyrimeve tatimore për vlerën e fitimit të realizuar nga shitja e këtij automjeti (diferenca prej 6.000 euro mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes) dhe për këtë arsye vlera e fitimit të realizuar vlerësohet si e ardhur e paligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe kjo vlerë i zbritet të ardhurës të arkëtuar.

⁶¹ E-mail, datë 27.2.2019, ora 15:44.

⁶² Administruar nga praktika e noterit S.M., shkresa nr. *** prot., datë 7.5.2020.

⁶³ Shkresë nr. ***prot., datë 5.3.2019.

Burimi II: shuma 16.150 euro, dhuratë nga motra/personi tjetër i lidhur/E.C.

3.14 Në deklaratën *Vetting* subjekti deklaroi se shumën prej 16.150 euro e ka përfituar si dhuratë nga motra E.C. me deklaratën e datës 16.4.2016, konfirmuar me transfertat bankare të “Raiffeisen Bank” dhe “Intesa Sanpaolo Bank”.

3.15 Personi tjetër i lidhur/E.C. me deklaratë noteriale nr. ***, datë 16.4.2016, deklaroi se që nga viti 1997 jeton dhe punon me bashkëshortin në B., Itali, dhe nuk kanë fëmijë. Nga kursimet e saj ka depozituar në “Raiffeisen Bank” dhe në “Intesa Sanpaolo Bank” në Shqipëri rreth 16.000 euro, të cilat së bashku me interesat që mund të krijojnë ia ka dhuruar pa kusht vëllait të saj/subjektit, i cili ka edhe autorizim për të vepruar në këto llogari. Ky dhurim bëhet për të kontribuar në rritjen dhe edukimin e mbesave/vajzave të vëllait.

3.16 Për sa më sipër vërtetohet me: (i) transfertën bankare në “Raiffeisen Bank” në vlerën 11.260 euro, datë 6.5.2016, nga llogaria e znj. E.C. në llogarinë e subjektit të rivlerësimit me përshkrim: “*kalim në llogari*”; dhe (ii) tërheqjen *cash* nga subjekti i rivlerësimit të vlerës 4.890 euro, datë 29.6.2016, nga llogaria e znj. E.C. në “Intesa Sanpaolo Bank”, me përshkrim: “*shpenzime familjare*”

3.17 Në përgjigje të pyetësorit standard 01⁶⁴, subjekti deklaroi se ka përfituar si dhuratë nga motra shumën prej 16.150 euro, të ardhura të siguruara nga personi tjetër i lidhur/E.C. nga puna e saj, ndër vite, në shtetin italian, si dhe nga puna e bashkëshortit, z. G.G. (shtetas italian).

3.18 Me pyetësorin nr. 2⁶⁵, subjektit iu kërkua të paraqesë dokumentacion justifikues ligjor në lidhje me të ardhurat e personit tjetër të lidhur/E.C., numrin e personave të përbërjes familjare, si dhe shpenzime të kryera për jetesë apo dhe të tjera, nëse ka investuar në pasuri (të luajtshme, të paluajtshme, llogari bankare etj), me qëllim përllogaritjen e mundësisë së saj për të dhuruar.

3.19 Lidhur me burimin e shumës 11.260 euro, subjekti ka depozituar – kërkesë për lëshimin e mandatit postar – të BancoPosta lëshuar nga znj. E.C. në shumën 10.003 euro (10.000 euro vlera e mandatit dhe 3 euro komisione), datë 6.6.2014. Ky çek është depozituar në datën 19.6.2014 në llogarinë e personit tjetër të lidhur/E.C. në “Intesa Sanpaolo Bank”.

3.20 Në datën 25.8.2014 janë transferuar 9.996,99 euro nga llogaria në “Intesa Sanpaolo Bank” te llogaria në “Raiffeisen Bank”. Në datën 1.9.2014 këto fonde janë investuar në fondin “Raiffeisen *Prestige*” dhe, më tej, janë shlyer në datën 12.4.2016. Në datën 7.4.2016 shtetasja E.C. ka depozituar 1.000 euro dhe 500 euro në datë 22.4.2016, duke e cuar tepicën e llogarisë në vlerën 11.277,07 euro. Në datën 6.5.2016 janë transferuar 11.260 euro me përshkrim: “*kalim në llogari*”, nga llogaria e personit tjetër të lidhur/E.C. në llogarinë e subjektit të rivlerësimit.

3.21 Lidhur me burimin e shumës 4.890 euro, subjekti ka depozituar – kërkesë për lëshimin e mandatit postar – të BancoPosta lëshuar nga znj. E.C. në shumën 4.903 euro (4.900 euro vlera e mandatit dhe 3 euro komisione), datë 1.4.2016, veprimi i cili është i pasqyruar edhe në librezën e kursimeve si debitim nga llogaria. Më tej, ky çek është depozituar në datën 8.4.2016 në llogarinë e personit tjetër të lidhur/E.C. në “Intesa Sanpaolo Bank”. Në datën 29.6.2016

⁶⁴ E-mail, datë 27.2.2019, ora 15:44.

⁶⁵ E-mail, datë 30.4.2020, ora 12:52.

subjekti ka tërhequr nga kjo llogari shumën 4.890 euro me përshkrim: “*shpenzime familjare*”, shumë të cilën e ka depozituar në të njëjtën datë në llogarinë e tij në “Raiffeisen Bank”.

3.22 Gjithashtu me cilësinë e provës subjekti paraqiti librezën postare të kursimeve të personit tjetër të lidhur/E.C. në shtetin italian. Referuar përmbajtjes së çertifikatës së martesës lëshuar nga Bashkia Salo, Provinca e Breshias, rezulton e provuar se ka lidhur martesë në datën 11.11.2000 me shtetasin italian G.G., familja përbëhet nga ajo dhe bashkëshorti. Më tej, subjekti dorëzoi pasqyrën e të ardhurave,, ndër vite të bashkëshortit të personit tjetër të lidhur/E.C.⁶⁶.

3.23 Komisioni konstaton se subjekti nuk ka dorëzuar dokumentacion për të ardhurat e motrës së tij, personit tjetër të lidhur/E.C., por vetëm për të ardhurat e bashkëshortit të saj, shtetasit G.G., për periudhën 1979 – 2018.

3.24 Për të analizuar faktin nëse personat e tjerë të lidhur justifikojnë me burime të ligjshme dhurimin e shumës prej 16.150 euro, u konsideruan të ardhurat e ligjshme të këtyre personave në raport me shpenzimet e konsumuara për jetesë përgjatë periudhës nga viti 2001⁶⁷ (viti i martesës) deri në fund të vitit 2015⁶⁸.

3.25 Për sa i përket të ardhurave *neto*, pavarësisht kërkesës së Komisionit për paraqitjen e tyre, në dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti janë pasqyruar vetëm të ardhurat *bruto*, të cilat për periudhën 2001 – 2015 kanë qenë në shumën 203.977,43 euro.

3.26 Në kushtet e mungesës së informacionit për të ardhurat *neto*, Komisioni përlllogarit të ardhurat *neto*⁶⁹ vjetore në rajonin e Lombardisë bazuar në të ardhurat vjetore *bruto* për të cilat është dorëzuar dokumentacion⁷⁰.

3.27 Për përlllogaritjen e shpenzimeve minimale jetike, Komisioni iu referua faqes zyrtare *online* të statistikave në shtetin italian⁷¹. Në mungesë të të dhënave për vitin 2001 – 2004, Komisioni mori si referencë të dhënat e vitit 2005 duke i indeksuar me normën e inflacionit⁷² për vitet 2001, 2002, 2003 dhe 2004.

3.28 Për sa më sipër, Komisioni përlllogarit të ardhura bruto totale në shumën 203.997,23 euro, të ardhura neto totale në shumën 160.993,80 euro dhe shpenzime jetike në total 167.138,52 euro.

3.29 Në dokumentacionin e përcjellë nga noter S.M.⁷³ është administruar deklarata noteriale nr. ***, datë 19.6.2017, ku shtetasja E.C. ka deklaruar se ka në zotërim një sipërfaqe

⁶⁶ Formulari INPS në të cilin pasqyrohen të ardhurat e bashkëshortit të motrës së subjektit për periudhën 1979 – 2018.

⁶⁷ Referuar përmbajtjes së certifikatës së martesës së lëshuar nga Bashkia Salo, provinca e Brescia-s, rezulton që motra e subjektit/personi tjetër i lidhur/E.C. të ketë lidhur martesë në datën 11.11.2000 me shtetasin italian G.G.

⁶⁸ Mandatet e BancoPosta të lëshuara nga E.C. i përkasin vitit 2014 dhe 2015.

⁶⁹https://neuvoo.it/calcolatore-di-stipendio/?iam=&uet_calculate=calculate&salary=12%2C518.92+&from=year®ion=Lombardia

⁷⁰ 21% për vitin 2001; 20% për vitin 2002; 13% për vitin 2003; 17% për vitin 2005; 5% për vitin 2007; 25% për vitin 2008; 24% për vitin 2009; 26% për vitin 2010 dhe 2011; 27% për vitin 2012; 23% për vitin 2013.

⁷¹ <https://ëëë.istat.it/it/dati-analisi-e-prodotti/contenuti-interattivi/soglia-di-poverta>, me kritere kritere kërkimi: veri; 2 persona të moshës 18-59; komunë nën 10.000 banorë.

⁷² <https://it.inflation.eu/tassi-di-inflazione/italia/inflazione-storica/cpi-inflazione-italia-2004.aspx>

⁷³ Shkresë nr. *** prot., datë 7.5.2020.

ndërtimore mbi 40 m², ndërtuar në Yzberisht, Tiranë, e cila është ndërtuar me të ardhurat e realizuara nga kursimet e saj familjare ndër vite.

Burimi III: shuma 2.000 euro, hua dhënë nga personi tjetër i lidhur/F.C.

3.30 Në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar huan në vlerë 2.000 euro, marrë nga djali i xhaxhait të tij, z. F.C., përfituar me transfertën e datës 11.7.2016, ku pasqyrohen veprimet në llogarinë e subjektit për periudhën 8.1.2016 – 20.10.2016, sipas të cilës personi tjetër i lidhur/F.C. ka transferuar nga llogaria në “UniCredit Bank”, Itali shumën prej 2.000 euro, në llogarinë e subjektit në “Raiffeisen Bank”.

3.31 Me pyetësin nr. 2⁷⁴, subjektit iu kërkua të paraqesë dokumentacion justifikues ligjor në lidhje me të ardhurat e ligjshme nga djali i xhaxhait/personi tjetër i lidhur/F.C. Në përgjigje të pyetësit nr. 2⁷⁵, subjekti ka dorëzuar ekstraktin e llogarisë bankare të personit tjetër të lidhur/F.C., lëshuar nga “UniCredit Bank”, Itali, ku rezulton që në datën 30.6.2016 të ketë pasur gjendje shumën 7.362,4 euro. Në datën 7.7.2016, ka transferuar në llogarinë e subjektit shumën 2.045,65 euro me përshkrim: “*Ordine di bonifico su estero 2.000 euro*”. Sipas këtij ekstrakti në datën 18.7.2016, është kredituar nga shoqëria “***” paga për muajin qershor 2016 në shumën 1.785 euro. Më tej, subjekti deklaroi se shtetasi F.C. nga viti 2006 dhe në vazhdim është në marrëdhënie pune pranë kësaj shoqërie. Subjekti paraqiti në cilësinë e provës: **(i)** deklaratën noteriale nr. ***, datë 16.08.2019, lëshuar nga personi tjetër i lidhur/F.C., i cili deklaroi se në datën 11.07.2016 i ka dhënë hua subjektit një shumë prej 2.000 euro, pa interes dhe me të drejtë shlyerje pa afat, dërguar me transfertë bankare nga llogaria bankare në shtetin italian, ku ka rezidencën; **(ii)** lejen e qëndrimit në shtetin italian, me adresë vendbanimi: “***, ***, Itali”; **(iii)** formular nr. ***, formulari deklarimit të të ardhurave për vitin 2016, në shumën 23.364 euro.

3.32 Lidhur me kthimin e huas, Komisioni konstaton në deklaratën noteriale⁷⁶ nr. ***, datë 16.8.2019, shtetasi F.C. deklaroi se po në këtë datë subjekti i ka shlyer shumën prej 1.000 euro.

3.33 Lidhur me ligjshmërinë e burimit, bazuar në deklaratën e të ardhurave për vitin 2016, konstatohet se personi tjetër i lidhur/F.C. për vitin 2016 ka realizuar 23.364 euro të ardhurat bruto. Bazuar në kërkimin online, për vitin 2016 të ardhurat neto⁷⁷ kanë qenë 17.114 euro dhe shpenzimet jetike⁷⁸ për një person kanë qenë 8.385,36 euro. Duke e përlllogaritur në mënyrë përpjestimore për 5 muaj⁷⁹, shuma e mundshme për kursim është 3.637 euro, duke e tejkaluar kështu vlerën 2.000 euro të huas së dhënë.

⁷⁴E-mail datë 30.4.2020, ora 12:52.

⁷⁵E-mail datë 11.5.2020, ora 10:45.

⁷⁶Dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në pyetësin nr. 2.

⁷⁷https://neuvoo.it/calcolatore-di-stipendio/?iam=&uet_calculate=calculate&salary=23364&from=year®ion=Lazio.

⁷⁸<https://www.istat.it/it/dati-analisi-e-prodotti/contenuti-interattivi/soglia-di-poverta>, me kritere kërkimi: qendër; 1 person i moshës 18-59; komunë nën 10.000 banorë.

⁷⁹Bazuar në lëvizjen e llogarisë bankare të dorëzuar nga subjekti, paga e muajit qershor 2016 është transferuar në llogari pas dhënies së huasë .

3.34 Në lidhje me burimin e tretë Komisioni nuk i kaloi barrë prove pasi personi tjetër lidhur kishte mundësi për të dhënë shumën 2.000 euro

Burimi IV: shuma 9.000 euro, hua nga motra/personi tjetër i lidhur/E.Sh.

3.35 Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se shumën prej 9.000 euro e ka marrë hua nga kunata e tij, personi tjetër i lidhur/E.Sh. me transfertën e datës 30.8.2016⁸⁰.

3.36 Subjektit iu kërkua të paraqesë dokumentacion justifikues ligjor në lidhje me të ardhurat e personit tjetër të lidhur/E.Sh., numrin e personave të përbërjes familjare, si dhe shpenzime të kryera për jetesë dhe nëse ka investuar në pasuri, me qëllim përlllogaritjen e mundësisë së saj për të dhënë hua.

3.37 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2⁸¹, subjekti paraqiti deklaratën noteriale nr. ***, datë 14.10.2019, lëshuar nga personi tjetër i lidhur/E.Sh., e cila deklaron se në datën 30.8.2016 i ka dhënë hua pa interes dhe pa afat subjektit të rivlerësimit në shumën 9.000 euro, me transfertë në “Raiffeisen Bank”. Kjo shumë është siguruar me kursimet, ndër vite, nga të ardhurat nga paga. Më tej, në cilësinë e provës, subjekti paraqiti kopje të lëvizjeve të llogarive, datë 14.10.2019, të “Raiffeisen Bank” dhe certifikatë familjare të kësaj shtetase.

3.38 Subjekti deklaron se personi tjetër i lidhur/E.Sh. ka filluar marrëdhëniet e punës në pozicionin ekonomiste nga viti 2010 dhe në vazhdim. Referuar certifikatës familjare të dorëzuar në cilësinë e provës, familja përbëhet vetëm nga znj. E.Sh. Më tej, subjekti deklaron se nga fillimi i vitit 2013 dhe në vazhdim bashkëjeton me shtetasin me initiale E. A. në Tiranë dhe nga bashkëjetesa me të cilin muajin e kaluar ka lindur një fëmijë.

3.39 Në dokumentacionin e administruar nga “Raiffeisen Bank”⁸², konstatohet se për periudhën 10.12.2012 – 22.8.2016 në llogarinë bankare të shtetasës E.Sh. janë kredituar paga në shumën totale 2.045.400 lekë.

3.40 Në datën 30.8.2016 nga llogaria e kësaj shtetase janë transferuar 9.000 euro në favor të subjektit të rivlerësimit me përshkrim: “*dhënë hua me të drejtë kthimi*”. Komisioni konstaton se kjo shumë e ka burimin në dy transferta: **(1)** konvertimi në datën 20.4.2016 i shumës 1.000.000 lekë nga llogaria në lekë në atë në euro për shumën ekuivalente 7.204,61 euro. Burimi i shumës 1.000.000 lekë është një depozitim *cash* në vlerën 900.000 lekë në datën 1.4.2016 dhe në vlerën 100.000 lekë gjendje në llogari nga pagat; **(2)** konvertimi në datën 30.8.2016 i shumës 167.000 lekë nga llogaria në lekë në atë në euro për shumën ekuivalente 1.210,14 euro. Burimi i shumës 167.000 lekë është vlera 65.000 lekë kalim page në datën 22.8.2016 dhe një depozitim *cash* në vlerën 60.000 Lekë në datën 30.8.2016.

3.41 Lidhur me kthimin e huas, bazuar në lëvizjet e llogarisë bankare në “Raiffeisen Bank”, janë shlyer 7.000 euro në vitin 2018 dhe 2.000 euro në vitin 2019, dhe konkretisht janë kryer veprimet bankare në vijim: **(i)** në datën 20.4.2018 janë transferuar 1.500 euro nga subjekti i

⁸⁰ Nxjerrje llogari page e E.Sh. në “Raiffeisen Bank”, datë 21.10.2016, për periudhën 6.12.2012 – 21.10.2016.

⁸¹ E-mail datë 11.5.2020, ora 10:45.

⁸² Shkresë nr. *** prot., datë 4.5.2020.

rivlerësimit me përshkrim: “*kthim i pjesshëm huaje*”, shumë e cila është tërhequr në datën 27.4.2018; **(ii)** në datën 14.6.2018 janë transferuar 1.500 euro nga subjekti i rivlerësimit me përshkrim: “*kthim i pjesshëm huaje*”, shumë e cila është tërhequr në datën 26.6.2018; **(iii)** në datën 9.7.2018 janë transferuar 1.500 euro nga subjekti i rivlerësimit me përshkrim: “*kthim i pjesshëm huaje*”, shumë e cila është në datën 13.7.2018 dhe më 30.7.2018; **(iv)** në datën 6.9.2018 janë transferuar 1.000 euro nga subjekti i rivlerësimit me përshkrim: “*kthim i pjesshëm borxhi*”, shumë e cila është tërhequr në datën 7.9.2018 dhe më 14.9.2018; **(v)** në datën 6.11.2018 janë transferuar 800 euro nga subjekti i rivlerësimit me përshkrim: “*kthim i pjesshëm huaje*”. Nga kjo shumë 650 euro janë tërhequr në datën 13.11.2018 dhe më 19.11.2018, ndërsa pjesa tjetër është përdorur për pagesën e kredisë; **(vi)** në datën 5.12.2018 janë transferuar 700 euro nga subjekti i rivlerësimit me përshkrim: “*kthim i pjesshëm huaje*”, shumë e cila është tërhequr në datën 13.12.2018; **(vii)** në datën 9.1.2019 janë transferuar 800 euro nga subjekti i rivlerësimit me përshkrim: “*kthim i pjesshëm huaje*”. Nga kjo shumë 770 euro janë tërhequr në datën 11.1.2019 dhe pjesa tjetër është përdorur për pagesa; **(viii)** në datën 6.2.2019 janë transferuar 1.200 euro nga subjekti i rivlerësimit me përshkrim: “*shlyerje përfundimtare huaje*”, shumë e cila është tërhequr në datën 19.2.2019

3.42 Nga hetimi i Komisionit rezulton se kjo shtetase ka marrë një kredi në shumën 316.200 lekë, në datën 4.8.2017, në “Raiffeisen Bank”.⁸³

Lidhur me ligjshmërinë e burimit

3.43 Për të analizuar faktin nëse personi tjetër i lidhur/E.Sh. justifikon me burime të ligjshme shumën prej 9.000 euro, Komisioni mori në konsideratë të ardhurat e ligjshme të saj në raport me shpenzimet e konsumuara për jetesë, blerjen e një automjeti sipas informacionit të përcjellë nga DPSHTRr-ja⁸⁴, si dhe vlerën e huas prej 9.000 euro, nga ku rezultoi një balancë negative prej 197.521 lekë

Burimi V: shuma 1.108,54 euro, kursime nga paga

3.44 Bazuar në deklaratimet e subjektit lidhur me burimin e krijimit, konkretisht: dhuratat *cash* në shumën 16.150 euro; hua në shumën totale 11.000 euro; dhe të ardhura nga shitja e automjetit në shumën 20.000 euro, Komisioni konstaton se diferenca e mbetur është në shumën 1.350 euro

3.45 Komisioni kreu analizën financiare për pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit dhe personave të lidhur për vitin 2016 (pavarësisht jetesës së përbashkët me prindërit, siç është arsyetuar në paragrafin 2.29), duke e ndarë në 3 pjesë, ku në pjesën I u paraqit analiza financiare për apartamentin në B. me vlerë 25.000 euro, në pjesën II u paraqit analiza financiare për huat dhe dhuratat në likuiditete për apartamentin e dytë në B., ndërsa në pjesën III u

⁸³ Shkresë nr. *** prot., datë 4.5.2020.

⁸⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 3.6.2020, ngs DPSHTRr-ja.

pasqyrua analiza financiare për vitin 2016, nga ku rezultoi një balancë negative në shumën 810.105 lekë

3.46 Nga faktet e analizuara, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me 5 burimet e krijimit, si vijon:

Në lidhje me burimin e parë, Komisioni i kaloi barrë prove:

3.47 (i) duket e dyshimtë shitja e automjetit me targa ***, pas 14-muajsh me një diferencë prej 6.000 euro më shumë nga çmimi i blerjes, duke llogaritur edhe koston e amortizimit të mjetit; (ii) duket se ka mungesë dokumentacioni ligjor justifikues për pagesën e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit me targa ***.

Në lidhje me burimin e dytë, Komisioni i kaloi barrë prove:

3.48 Duket se personi tjetër i lidhur/E.C. dhe bashkëshorti i saj kanë qenë në pamundësi financiare për të përballuar edhe shpenzimet e jetesës sipas nivelit të varfërisë absolute dhe, si pasojë, nuk duket e mundur të kenë pasur mjete financiare të ligjshme të tjera që mund të shërbenin për dhuratën në shumën 16.150 euro, duke mos marrë në konsideratë asnjë investim në pasuri të paluajtshme/të luajtshme nga personi tjetër i lidhur

Në lidhje me burimin e katërt, Komisioni i kaloi barrë prove:

3.49 Personi tjetër i lidhur/E.Sh. nuk të krijon bindjen se kishte mundësi t'i jepte hua shumën prej 9.000 euro subjektit për shkak se: (i) nga analiza e të ardhurave në raport me shpenzimet jetike me kosto në pragun e varfërisë dhe shpenzime për blerje automjeti, nuk arrin të mbulojë shumën e dhënë hua; (ii) shuma e dhënë hua përfaqëson 60 % të të ardhurave të huadhënësës në një periudhë 4-vjeçare; (iii) huadhënësja i jep hua 9.000 euro subjektit dhe një vit më vonë merr hua nga "Raiffeisen Bank", shumën prej 316.200 lekësh.

Në lidhje me burimin e pestë, Komisioni i kaloi barrë prove:

3.50 Duket se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë patur pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive gjatë vitit 2016, me një balancë negative në shumën 810.105 lekë

Në lidhje me vlerësimin tërësor të burimeve që kanë shërbyer për blerjen e këtij apartamenti

3.51 Në analizë tërësore të huave dhe dhurimeve nga persona të tjerë të lidhur për apartamentin në B. me vlerë 48.500 euro, duket se subjekti i rivlerësimit ka mungesës të burimeve të ligjshme, shoqëruar me dokumnetacion ligjor justifikues në shumën prej 31.150 euro.

3.52 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ dhe në seancën dëgjimore, deklaroi se:

Në lidhje me barrën e provës për burimin e parë

3.53 Për shkak të marrëdhënies së posaçme dhe lidhjes gjinore të afërt që ka me shitësin F.C., ia ka shitur përkundrejt vlerës prej 14.000 euro, pra, më poshtë se vlera reale e automjetit. Është shitur në shumën prej 20.000 euro, pasi automjeti ishte në gjendje shumë të mirë dhe pothuajse i papërdorur nga subjekti, ky çmim përfaqëson vlerën reale të automjetit.

3.54 Lidhur me diferencën prej 6.000 euro të përfituar si fitim, subjekti deklaroi se ka paguar tatimin e fitimit dhe një fakt i tillë provohet referuar përmbajtjes së shkresës nr. *** prot., datë 14.9.2020, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, në të cilën përcaktohet se është paguar tatim fitimi i realizuar në shumën 101.667 euro, shkresë të cilën e ka paraqitur në cilësinë e provës.

Në lidhje me barrën e provës për burimin e dytë

3.55 Subjekti deklaroi se motra e tij dhe bashkëshorti, z. G.G., nuk kanë fëmijë dhe ka qenë vullnet i tyre i përbashkët që një pjesë të kursimeve të tyre t'ua dhuronin vajzave të subjektit. Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti deklaratën e datës 15.9.2020, të lëshuar nga bashkëshorti i motrës, z. G.G.⁸⁵, i cili deklaroi se ka bashkëjetuar me znj. E.C. që nga viti 1997 dhe janë martuar më 11.11.2000. Meqenëse nuk kanë fëmijë, vendosën së bashku t'u dhuronin një pjesë të kursimeve të tyre mbesave të gruas së tij, për të kontribuar në arsimimin e tyre. Këto kursime janë para që i kanë kursyer për periudhën 1979 – 2016.

3.56 Subjekti pretendoi të merren në analizë të ardhurat e kunatit, z. G.G., nga viti 1979, kur dhe rezultoi që të ketë filluar marrëdhëniet e punës, deri në vitin 2016, dhe jo vetëm të ardhurat gjatë periudhës së martesës.

3.57 Shuma prej 15.000 euro ka qenë e depozituar në Bankën Italiane të quajtur B.P., e cila ka lëshuar në emër të E.C. 2 (dy) çeqe njëri me vlerë 10.000 euro dhe tjetri me vlerë 4.900 euro. Në rast se paratë e sipërcituara nuk do kishin burim të ligjshëm nuk do të ishte lejuar thyerja e këtyre çeqeve si nga Banka Italiane ashtu edhe nga “Intesa Sanpaolo Bank”

3.58 Subjekti paraqiti në cilësinë e provës librezën e kursimeve të motrës së tij, znj. E.C., në B.P. Italiane, sipas së cilës ka depozitime të herëpashershme në librezën kursimit në shtetin Italian, gjë që tregon mundësinë e saj për të akumuluar kursime nga puna, ndër vite, së bashku me bashkëshortin.

3.59 Subjekti pretendon se Komisioni ka bërë një përlllogaritje të gabuar të taksave për z. G.G. dhe ka paraqitur një raport të realizuar nga një ekspert kontabël në shtetin Italian Dr. G.P., Studio P.,. Në këtë analizë, është arritur në përfundimin se për periudhën 2000 – 2016. Shtetasit G.G. dhe E.C. në periudhën kohore të marrë si referencë potencialisht mund të linin mënjane

⁸⁵ Deklarata është dërguar me e-mail, në adresën e subjektit dhe është përkthyer dhe noterizuar.

kursime për një shumë të përgjithshme rreth 20.000 euro. Kësaj shume i mblidhet edhe shpërblimi i dëmit që ka përfituar znj. E.C. prej 4.094,64 euro, sipas vendimit nr. ***, datë 17.6.2011, të Gjykatës së Brescia dhe, për rrjedhojë, shuma potenciale e lënë mënjanë është rreth 24.000 euro. Nëse konsiderohet edhe periudha e bashkëjetesës nga viti 1997, viti i fillimit të bashkëjetesës deri në vitin 1999, shuma potenciale e lënë mënjanë është rreth 34.000 euro.

Në lidhje me barrën e provës për burimin e katërt

3.60 Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti deklaratën noteriale nr. ***, datë 17.9.2020, të shtetasit E.A., i cili shprehet se që në fillim të vitit 2013 bashkëjeton me znj. E.Sh., nga bashkëjetesa kanë një fëmijë të lindur në vitin 2020. Nga momenti i bashkëjetesës, të gjitha shpenzimet e jetesës së përbashkët janë mbuluar nga ana e tij me të ardhurat prej 7.000.000 lekë, që ka përfituar në vitin 2011 nga shoqëria “****” sh.a., si dëmshpërblim nga aksidenti automobilistik i datës 29.11.2008, si dhe nga shuma prej 40.000 euro, që ka përfituar në rrugë bankare nga shitja e një shtëpie⁸⁶.

3.61 Sipas subjektit, për sa më sipër, provohet deklarimi i tij se kunata, znj. E.Sh., ka bashkëjetuar me shtetasin E.A., provohet se shtetasi E.A. ka pasur mundësi financiare për të mbuluar shpenzimet e jetesës së përbashkët. Shpenzimet e jetesës së përbashkët që nga momenti i fillimit të bashkëjetesës deri në datën 30.08.2016, kur dhe rezulton që znj. E.Sh. më anë të transfertës bankare i ka dhënë hua shumën prej 9.000 euro, rezulton të jenë mbuluar nga bashkëjetuesi i saj, arrihet në përfundimin se ka pasur mundësi për të dhënë hua shumën e sipërcituar.

3.62 Për të provuar bashkëjetesën e këtyre shtetasve, subjekti paraqiti në cilësinë e provës kontratën e shitblerjes me kusht nr. ***, datë 14.12.2018, të lidhur ndërmjet shtetasve A. Z. dhe N. Z. me cilësinë e shitësve dhe shtetasve E.A. dhe E.Sh. me cilësinë e blerësve, si dhe deklaratën noteriale nr. ***, datë 12.01.2018, të nënshkruar nga këto palë. Me tej, subjekti paraqiti edhe transfertën bankare, datë 14.12.2018.

3.63 Subjekti shpjegoi se referuar dokumenteve të mësipërme, rezulton që kësti i parë për blerjen e apartamentit në shumën 1.140.800 lekë, të jetë paguar nga znj. E.Sh. në pjesën më të madhe të saj rezulton të jetë paguar me shumën prej 7.000 euro që subjekti i kishte kthyer deri në datën 5.12.2018.

3.64 Lidhur me huan që znj. E.Sh. ka marrë “Raiffeisen Bank” në shumën 316.200 lekë, subjekti deklaroi se ajo e ka marrë një vit më vonë nga huaja prej 9.000 euro që i ka dhënë në vitin 2016 dhe se në korrik të vitit 2017, i ka kërkuar kthimin e huas për nevoja të saj, por duke qenë se subjekti ishte në pamundësi që t’i shlyente pjesërisht huan, ajo ka marrë kredi.

⁸⁶ Për të provuar deklaratën e tij, shtetasi E.A. ka bashkëlidhur aktet: certifikatë familjare, datë 17.9.2020, shkresën nr. *** prot., datë 14.9.2020, të lëshuar nga shoqëria “****” sh.a., kontratën nr. ***, datë 30.5.2011, të lidhur ndërmjet deklaruesit E.A. dhe shoqërisë së sigurimeve “****” sh.a., bashkëlidhur së cilës ndodhet edhe lëvizja e llogarisë në të cilën pasqyrohet kalimi i shumës prej 7.000.000 lekë, ekstrakt bankar i lëshuar nga “Intesa Sanpaolo Bank”, datë 19.6.2020, ekstrakt bankar i lëshuar nga “Alpha Bank”, datë 15.9.2020.

Në lidhje me barrën e provës për burimin e pestë

3.65 Lidhur me balancën negative të vitit 2016, subjekti paraqiti analizën e tij financiare ku balanca vjetore rezulton në shumën 38.909 lekë dhe shpjegoi qëndrimin e tij, si vijon⁸⁷: **(i)** Nga Komisioni nuk është përfshirë në analizën financiare të vitit 2016 shuma prej 6.000 euro e fituar nga shitja e automjetit me targa ***, për të cilën ka dorëzuar shkresën nr. *** prot., datë 14.9.2020, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, në të cilën përcaktohet pagesa e tatimit fitimit të realizuar nga shitja e automjetit me targa *** duke paguar për këtë qëllim shumën 101.667 lekë. **(ii)** Në analizën financiare të vitit 2016 nuk është përfshirë qiraja që ka përfituar për periudhën 8.10.2016 – 31.12.2016 nga shtetasi sirian A.H. në shumën 222.064 lekë. Më tej, deklaron se prej tij lidhur me këtë qira është paguar edhe tatim fitimi dhe se një fakt i tillë provohet referuar përmbajtjes së shkresës me nr. *** prot., datë 14.9.2020, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë. **(iii)** Në analizën financiare të vitit 2016 nuk është përfshirë edhe garancia prej 1.330 euro e lënë nga qiramarrësi A.H., në zbatim të kontratës së qirasë së datës 8.10.2016 të lidhur me këtë të fundit. Subjekti sqaron se siç e ka deklaruar edhe në pyetësonin nr. 4 shuma e garancisë prej 1.330 euro është përdorur me qëllim për të paguar një pjesë të tatimit në shumën 2.425 euro. Më tej, vijon duke shpjeguar se sikurse ka sqaruar edhe në pyetësonin shtesë nr. 4, pagesa ndaj Zyrës së Financës B., në datën 30.12.2016 është realizuar me anë të të ardhurave të përfituara nga dhënia me qira në datën 8.10.2016 të pasurisë së paluajtshme të ndodhur në adresën ***, B., Gjermani, si dhe me një pjesë të garancisë së dhënë nga qiramarrësi A.H. në shumën 1.330 Euro. **(iv)** Në lidhje me gjendjen *cash* në fund të çdo viti kalendarik, subjekti shpjegon se nga Komisioni nuk rezulton që të jenë marrë në konsideratë kursimet, ndër vite, të deklaruara prej tij dhe të bashkëshortes dhe, konkretisht, në analizën financiare të vitit 2016 është përfshirë edhe shuma prej 290.000 lekësh si shumë kursimesh *cash* të akumuluar nga puna e tij dhe e bashkëshortes ndër vite. **(v)** Shpenzimet për jetesë duhet të reduktohen me 100.000 (njëqind mijë) lekë si rezultat i jetesës së përbashkët me prindërit për periudhën 1.1.2016 – 1.10.2016.

Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

3.66 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provave shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se:

Vlerësimi në lidhje me burimin e parë

⁸⁷ Në analizën në vijim, Komisioni ka parashtuar vetëm pretendimet që lidhen me balancën prej 810.105 lekësh, e cila nuk ka të bëjë me huatë/dhuratat e palëve të treta, për të cilat është arsyetuar në paragrafët përkatës.

3.67 Duke qenë se në shkresën nr. *** prot., datë 14.09.2020, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, nuk përcaktohet periudha në të cilën është paguar ky detyrim tatimor, subjekti u pyet në seancë dëgjimore lidhur me kohën e kryerjes së këtij detyrimi. Në seancën dëgjimore, subjekti deklaroi se pagesën e detyrimeve tatimore ia kishte ngarkuar një personi tjetër dhe nuk kishte pasur dijeni që këto detyrime nuk ishin realizuar. Gjithashtu, subjekti deklaroi se ka treguar gjithmonë kujdes mbi pagesën e tatimit mbi fitim të të ardhurave të realizuara nga apartamentet e lëshuara me qira. Më tej, subjekti deklaroi se ligji i rezervon të drejtën që këto detyrime të paguhen edhe më vonë kundrejt aplikimit të një tarife shtesë në formë gjobe, pasi ligji nuk parasheh një afat kohor për pagesën e këtyre detyrimeve.

3.68 Komisioni çmon se tatimet e paguara gjatë procesit të rivlerësimit, për të ardhurat e realizuara nga shitja e automjetit, nuk e bindin trupin gjykues për ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, pasi duket qartë që kjo pagesë është bërë për efekt të procesit të rivlerësimit.

3.69 Gjithashtu, referuar jurisprudencës së Kolegjit⁸⁸, është vlerësuar se pagesa e detyrimeve tatimore pas dorëzimit të deklaratës *Vetting* në janar të vitit 2017, është e papranueshme dhe nuk e shmang subjektin nga përgjegjësia ligjore, pasi nuk mund të zhbëjë qasjen e subjektit të rivlerësimit në kundërshtim me ligjin, ndër vite, që u karakterizua nga mospagimi i detyrimeve tatimore në momentin dhe vitin përkatës kur ato duhej të shlyheshin.

3.70 Si konkluzion, shuma prej 6.000 euro, që përbën diferencën mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes nuk u konsiderua si e ardhur në analizën financiare, pasi nuk konsiderohet si e ardhur e ligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, subjekti ka mungesë të të ardhurave të ligjshme, në shumën 6.000 euro, sipas germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Vlerësimi në lidhje me burimin e dytë

3.71 Referuar pikës 1, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: *“Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklaratimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”*, dhe më tej, sipas pikës 4 të të njëjtit nen, parashikon se: *“Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”*.

3.72 Sipas pikës 6, të udhëzimit nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, udhëzues për mënyrën e plotësimit të deklaratës *Vetting* të vitit 2017, si dhe dokumentacionin që duhet të dorëzonin bashkë me deklaratën, parashikon se: *“Kur subjekti i rivlerësimit deklaroi këto lloj marrëdhëniesh juridike me persona të tjerë të lidhur, ai mbart detyrimin të paraqesë dokumentacionin justifikues ligjor, në momentin e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, për pronësinë dhe burimin e krijimit të pronës, që bëhet objekt i kësaj marrëdhënieje me subjektin e rivlerësimit.”*

⁸⁸ Vendimet nr. 8/2019, datë 16.4.2019 dhe nr. 2/2020, datë 13.3.2020.

3.73 Pra, subjekti i rivlerësimit referuar në këtë kuadër ligjor ka pasur detyrimin që me dorëzimin e deklaratës *Vetting* 2017, të dorëzonte të gjithë dokumentacionin justifikues për të ardhurat e motrës në cilësinë e dhurueses së shumës prej 16.150 euro.

3.74 Lidhur me pretendimin e subjektit se rezulton që nga Komisioni nuk i është kërkuar paraqitja e të ardhurave *neto*, Komisioni çmon të theksojë se në pyetësonin nr. 2, në përfundim të pesë pikave të pyetjes së parë, është kërkuar shprehimisht: “*Dokumentacioni për të ardhurat e përfituara jashtë Shqipërisë duhet të pasqyrojë në mënyrë të qartë të ardhurat bruto dhe neto, si dhe të jetë sipas formës së kërkuar ligjore (i përkthyer dhe i pajisur me vulë apostile)*”.

3.75 Komisioni mori në analizë raportin e realizuar nga një ekspert kontabël në shtetin Italian, shtetasit Dr. G.P., Studio P. dhe vëren se: **(i)** në vitin 2002 në këtë raport janë përfshirë 3.821 euro neto me shënimin “*të ardhura Cena*”, të cilat nuk janë të pasqyruara në dokumentin “Komunikim i llogarisë siguruese”, dorëzuar nga subjekti në pyetësonin nr. 2; dhe **(ii)** ky dokument nuk përmban vulën e entitetit që e ka lëshuar dhe nuk është sipas formës së kërkuar ligjore, pasi mungon vula apostile.

3.76 Megjithatë, edhe duke e marrë në vlerësim këtë raport, Komisioni arsyeton, si vijon: **(i)** Për shumën 14.900 euro të merret si bazë përlllogaritjeje të ardhurat e përfituara gjatë periudhës 2001 – 2015. Komisioni vlerëson se përlllogaritja e këtyre kursimeve duhet të fillojë në vitin 2001, për shkak se martesja e shtetasës E.C. me shtetasin G.G. daton në 11.11.2000 dhe se subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në deklaratën *Vetting* deklaratën noteriale nr. ***, datë 16.4.2016, ku shprehet: [...] deklaroj se nga kursimet e mia kam depozituar në bankën *Raiffeisen dhe Intesa San Paolo* këtu në Shqipëri, vlerat monetare në total afërisht prej 16.000 euro. Veç sa më sipër, deklaroj se këto depozita, së bashku me interesat përkatëse që mund të krijojnë, ia kam dhuruar pa kusht apo shpërblim vëllait tim [...], dhe pikërisht për arsyen se personi tjetër i lidhur ka deklaruar se shuma e dhuruar ka të bëjë me kursimet e saj, nuk mund të merret në konsideratë pretendimi i subjektit se kursimet e përlllogaritura duhet të përfshijnë të ardhurat e shtetasit italian G.G. që prej vitit 1979. Komisioni vlerëson se përlllogaritja e shumës së kursimeve prej 14.900 euro, duhet të përfundojë në vitin 2015, pasi mandati i B.P. me vlerë 10.000 euro mban datën 6.6.2014, ndërsa mandati me vlerë 4.900 euro vërtet mban datën 1.4.2016, por në lëvizjen e llogarisë së kursimit paraqitur nga subjekti në pyetësonin nr. 2, evidentohet se fondet e tërhequr kanë qenë gjendje në llogari në fund të vitit 2015. Në vijim, bazuar në raportin e dorëzuar nga subjekti, shuma e mundshme për kursim për këtë periudhë ka qenë 16.407 euro⁸⁹; **(ii)** Për shumën 1.500 euro, referuar dy depozitimeve të kryera nga personi tjetër i lidhur/E.C., konkretisht 1.000 euro në datën 7.4.2016 dhe 500 euro në datën 22.4.2016, u konsideruan të ardhurat e 3-mujorit të parë⁹⁰ të vitit 2016. Sipas raportit të Studio P., diferenca *neto* për periudhën 1.1.2016 – 31.3.2016 është 1.386 euro, e pamjaftueshme për te mbuluar vlerën 1.500 euro, pa marrë parasysh shpenzimet jetike.

3.77 Në përfundim të analizës së mësipërme, Komisioni vlerëson që është e pabesueshme që një familje me vetëm një të punësuar, familje e cila hipotetikisht ka jetuar në nivelin e

⁸⁹ Të ardhura *neto* 2001 – 2015 në shumën 179.825,47 euro; dëmshpërblim për aksidentin E.C. 4.094,64 euro; shpenzime në nivelin e varfërisë në shumën 167.512,20 euro.

⁹⁰ Në mënyre përpjestimore me të ardhurat vjetore të vitit 2016.

varfërisë dhe që gjatë dy viteve që paraprijnë vitin 2016 rezulton të kenë pasur të ardhura të papërfillshme⁹¹, të përdorë të gjitha kursimet e siguruara në 15 vjet punë për t'ia dhuruar subjektit të rivlerësimit, dhuratë e cila nuk rezulton të jetë përdorur për shkollimin e vajzave të tij, por për të blerë pasurinë e dytë të paluajtshme në shtetin gjerman.

3.78 Si konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimin e krijimit të të ardhurave të ligjshme të personit tjetër të lidhur/E.C., dhe nuk provoi se kishte të ardhura të mjaftueshme për t'i dhuruar subjektit shumën prej 16.150 euro, për blerjen e apartamentit në B., Gjermani, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga germa “b”, pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Vlerësimi për burimin e katërt

3.79 Prova që depozitoi subjekti në përgjigje të barrës së provës, për të vërtetuar bashkëjetesën nga viti 2013 me shtetasin E.A. dhe, më tej, dokumentacioni i dërguar për të provuar se personi tjetër i lidhur është ndihmuar nga bashkëjetuesi i saj për të jetuar, Komisioni i vlerëson se nga pikëpamja e mjaftueshmërisë së të ardhurave financiare të ligjshme, ato janë të mjaftueshme për të dhënë hua 9.000 euro, por Komisioni duke pasur parasysh deklaratimet e subjektit në lidhje me këtë hua në deklaratën *Vetting* dhe përgjigjet e pyetësorit nr. 2, ku subjekti nuk kishte deklaruar se personi i lidhur mund t'i kishte këto të ardhura nga bashkëjetuesi i saj. Për më tepër që bashkëjetesa nuk regjistrohet në gjendje civile dhe nuk ka ndonjë organ të posaçëm që e certifikon atë dhe subjekti depozitoi vetëm një deklaratë nga bashkëjetuesi për të vërtetuar që ato kanë qenë bashkë që nga viti 2013.

3.80 Për më tepër, duke analizuar lëvizjet në llogarinë e pagës së shtetases E.Sh., verëhet se shumatat e tërhequra nga llogaria janë në shuma të vogla, shpesh nën vlerën 10.000 lekë, çka të krijon bindjen se janë përdorur për shpenzimet e përditshmërisë dhe jo për t'u akumuluar. Për më tepër që një pjesë e huas së dhënë, konkretisht shuma 900.000 lekë është depozituar në datën 1.4.2016 vetëm pak muaj përpara dhënies hua subjektit.

3.81 Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij në përgjigje të barrës së provës nuk arriti të bindë Komisionin se personi tjetër i lidhur/E.Sh. ka pasur mundësi t'i jepte hua shumën prej 9.000 euro subjektit për shkak se: (i) nga analiza e të ardhurave në raport me shpenzimet jetike, për një person, me kosto në pragun e varfërisë dhe shpenzime për blerje automjeti, nuk arrin të mbulojë shumën e dhënë hua; (ii) shuma e dhënë hua përfaqëson 60% të të ardhurave të huadhënësës në një periudhë 4-vjeçare; (iii) huadhënësja i jep hua shumën 9.000 euro subjektit dhe një vit më vonë merr hua nga “Raiffeisen Bank” shumën 316.200 lekë; (iv) provat e reja të paraqitura në prapësimet e subjektit shtonin një burim tjetër krijimi nga ana personi tjetër i lidhur, të ardhurat e bashkëjetuesit nga vitit 2013, bashkëjetesë e cila nuk provohej para vitit 2018.

3.82 Si konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme nga personi tjetër i lidhur për shumën prej 9.000 euro hua për

⁹¹ Gjatë viteve 2014 dhe 2015 të ardhurat *bruto* të personave të tjerë të lidhur kanë qenë kanë qenë respektivisht 865 euro/vit dhe 123 euro/vit.

pagimin nga ky burim, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga germa “b”, pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016.

Vlerësimi për burimin e pestë

3.83 Lidhur me pretendimin e subjektit se shuma 6.000 euro duhet të merret parasysht në analizë financiare, referuar faktit që subjekti ka paguar detyrimet tatimore⁹² pas kalimit të barrës së provës, është trajtuar më sipër në vlerësimin e burimit të parë. Këto të ardhura nuk konsiderohen të ligjshme sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

3.84 Për sa i përket pretendimit të subjektit se duhet përfshirë qiraja që subjekti ka përfituar për periudhën 8.10.2016 – 31.12.2016 nga shtetasi sirian A.H. në shumën 222.064 lekë, Komisioni konstaton se pavarësisht se bazuar në nenin 4 të kontratës së qirasë marrëdhënia e qirasë parashikohet të fillojë në datën 15.10.2016, subjekti nuk ka deklaruar të ardhura nga qiraja për vitin 2016, as në deklaratën periodike/vjetore dhe as në deklaratën *Vetting* dhe nuk provoi me dokumentacion ligjor datën e arkëtimit/transferimit të këtyre të ardhurave në llogarinë bankare të shtetasit E.M.⁹³ dhe, më tej, marrjen e tyre nga subjekti. Vetëm pas kalimit të barrës së provës, subjekti i deklaroi këto të ardhura dhe kreu pagesën e detyrimeve tatimore dhe për këtë arsye nuk mund të konsiderohen në analizën financiare.

3.85 Lidhur me pretendimin e subjektit në vitin 2016 duhet përfshirë edhe garancia prej 1.330 euro të lënë nga qiramarrësi A.H., në zbatim kjo të kontratës së qirasë së datës 8.10.2016, Komisioni konstaton pavarësisht se bazuar në nenin 5 të kontratës së qirasë është parashikuar se qiramarrësi është i detyruar që me fillimin e marrëdhënies së qirasë t’i paguajë qiradhënësit një shumë prej 1.330 euro, subjekti nuk e ka deklaruar marrjen e kësaj garancie në vitin 2016 as në deklaratën periodike/vjetore dhe as në deklaratën *Vetting*. Për më tepër, nuk u provua me dokumentacion ligjor data e arkëtimit/transferimit të këtyre të ardhurave në llogarinë bankare të shtetasit E.M.⁹⁴ dhe, më tej, marrja e tyre nga subjekti.

3.86 Lidhur me pretendimin e subjektit se nga Komisionit nuk rezulton që të jenë marrë në konsideratë kursimet, ndër vite, të deklaruara prej tij dhe bashkëshortes, Komisioni vëren se në analizën financiare dorëzuar nga subjekti pas kalimit të barrës së provës, paraqiten gjendjet *cash* në fund të vitit, duke i konsideruar shumat e deklaruara çdo vit nga subjekti dhe bashkëshortja, si shtesa të gjendjes së likuideteve, ndërkohë që për vitet 2009, 2011, 2012, 2014, 2015 dhe 2016 subjekti deklaroi edhe pakësime. Konkretisht për vitin 2016, subjekti pretendon që ndryshimi i likuideteve *cash* të bëhet -290.000 lekë nga 0 lekë që është e pasqyruar në analizën e Komisionit.

3.87 Duke analizuar deklaratat periodike vjetore, Komisioni konstaton se në asnjë rast subjekti i rivlerësimit apo bashkëshortja, nuk kanë deklaruar pakësim të gjendjes *cash* dhe, për rrjedhojë, në rast se do të konsiderohej pretendimi i tij për t’i konsideruar shumat e deklaruara

⁹² Shkresë nr. *** prot., datë 14.9.2020, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, në të cilën përcaktohet pagesa e tatimit fitimit të realizuar nga shitja e automjetit me targa *** duke paguar për këtë qëllim shumën 101.667 lekë.

⁹³ Në nenin 3 të kontratës së qirasë specifikohet se qiraja dhe shpenzimet operationale do të paguhen si parapagim në fillim të periudhës së qirasë, jo më vonë se data 3 e çdo muaji në llogarinë e qiradhënësit në P.Bank E., mbajtës llogarie E.M.,

⁹⁴ Në nenin 3 të kontratës së qirasë specifikohet se qiraja dhe shpenzimet operationale do të paguhen si parapagim në fillim të periudhës së qirasë, jo më vonë se data 3 e çdo muaji në llogarinë e qiradhënësit në P.Bank E., mbajtës llogarie E.M.

çdo vit nga subjekti dhe bashkëshortja, si shtesa të gjendjes së likuideteve, balancat negative vjetore do të shtoheshin dhe do të duhej të shpjegonte gjendjen prej 2.830.000 lekë⁹⁵ të akumuluar në fund të vitit 2016 e të padeklaruar në deklaratën *Vetting*.

3.88 Gjithashtu, në procesverbalin e ILDKPKI-së, datë 24.10.2014⁹⁶, subjekti ka deklaruar se gjendja *cash* deri më 31.12.2013 ka qenë rreth 200.000 lekë, ndërkohë që në analizën financiare të dorëzuar prej tij kjo gjendje paraqitet 1.120.000 lekë. Kjo diferencë e theksuar midis dy deklarimeve të subjektit, e bën jo të besueshme llogaritjet e tij lidhur me gjendjen e likuideteve *cash* në fund të vitit, pas kalimit të barrës së provës.

3.89 Për sa më sipër, Komisioni vlerëson që gjendja e likuideteve *cash* në fund të cdo viti mbetet e pandryshuar.

3.90 Lidhur me pretendimin e subjektit se shpenzimet për jetesë duhet të reduktohen me 100.000 (njëqind mijë) lekë, si rezultat i jetesës së përbashkët me prindërit për periudhën 1.1.2016 – 1.10.2016, duke u bazuar në analizën financiare të babait të subjektit për vitin 2016 dhe deklaratën të subjektit në pyetësorin nr. 0⁹⁷, Komisioni çmon se pretendimi i subjektit qëndron dhe se shpenzimet jetike për vitin 2016 duhen reduktuar me shumën 100.000 lekë

3.91 Për sa i përket shpenzimeve për biletat e avionit për udhëtimin e datës 28.12.2016-3.1.2017, Komisioni e mori në konsideratë faturën e dorëzuar nga subjekti dhe i reduktoi shpenzimet e udhëtimit nga 945 euro në 796 euro.

3.92 Në përfundim të vlerësimit të burimit të pestë të krijimit, Komisioni vlerëson se subjekti dhe persona e lidhur kanë mungesë financiare burimesh të ligjshme në shumën **-689.950 lekë** për përballimin e shpenzimeve në vitin 2016, duke mos konsideruar këtu analizën e dhurimeve/huave, për të cilat është arsyetuar në paragrafët përkatës, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga germa “b”, e pikës 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

3.93 Në vlerësimin e përgjithshëm të burimeve të krijimit që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit në B., Gjermani, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit për blerjen e kësaj pasurie, ka mungesë të burimeve të ligjshme, shoqëruara me dokumentacion justifikues në shumën 31.150 euro, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga germa “b”, e pikës 5, e neni 33, të ligjit nr. 84/2016.

4. Llogaritë bankare

⁹⁵ Shtesë 200.000 lekë për vitin 2007, shtesë 280.000 lekë për vitin 2008, shtesë 350.000 lekë për vitin 2009, shtesë 500.000 leke për vitin 2010, shtesë 550.000 lekë për vitin 2011, shtesë 550.000 lekë për vitin 2012, shtesë 400.000 lekë për vitin 2013.

⁹⁶ Përcjellë nga ILDKPKI-ja me shkresë nr. *** prot., datë 5.5.2020.

⁹⁷ [...] Në vitin 2016 për periudhën nga data 1.1.2016 deri në muajin tetor 2016 kam jetuar me bashkëshorten S.C. dhe 2 (dy) vajzat e mia I. dhe A.C., si dhe me 2 (dy) prindërit e mi B. dhe E.C. Në këtë periudhë shpenzimet për jetesë janë përballuar bashkarisht si nga unë dhe bashkëshortja ime S.C. me të ardhurat e përfituara nga paga dhe honoraret e përfituara nga ana ime për mbledhjet e zhvilluara në Këshillin e Lartë të Drejtësisë me cilësinë e anëtarit, ashtu edhe nga prindërit e mi B. dhe E.C. me të ardhurat që këto kanë përfituruar dhe konkretisht babai im nga paga e tij si mjek dhe mamaja ime nga pensioni i invaliditetit që ajo përfiton [...]

4.1 Në deklaratën Vetting të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: (1) Gjendje në momentin e deklarimit në llogarinë *** në euro në “Raiffeisen Bank”. Vlera: 350,18 euro. Pjesa takuese: 100 %. Burimi i krijimit: kursimet nga paga si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë⁹⁸. (2) Gjendje në momentin e deklarimit në llogarinë *** në lekë në “Societe Generale Albania”. Vlera: 16.472,67 lekë. Pjesa takuese: 100 %. Burimi i krijimit: kursimet nga paga si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë⁹⁹. (3) Llogari rrjedhëse në lekë e pagës me nr. ***, në “Raiffeisen Bank”. Gjendja e kësaj llogarie në datën e deklarimit 725,42 lekë. Pjesa takuese: 100 %. Burimi i krijimit kursimet nga paga dhe honoraret e mbledhjeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë¹⁰⁰. (4) Llogari në euro me bashkëshorten nr. *** në “Raiffeisen Leasing”. Gjendja e kësaj llogarie në momentin e deklarimit 16 euro. pjesa takuese 50 %. Burimi i krijimit: të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortes nga paga¹⁰¹.

4.2 Në dokumentacionin e administruar nga “Raiffeisen Bank”, konfirmohet se në datën 25.1.2017 gjendja e llogarisë nr. *** ka qenë 350,18 euro dhe gjendja e llogarisë nr. *** ka qenë 752,42 lekë.

4.3 Në dokumentacionin e administruar nga OTP Bank (ish-Societe Generale), konfirmohet se në datën 25.1.2017 gjendja e llogarisë nr. *** ka qenë 16.472,67 lekë

4.4 Në lidhje me llogarinë nr. *** në “Raiffeisen Leasing”, bazuar në korrespondencën¹⁰² e Komisionit me “Raiffeisen Leasing”, konfirmohet se kjo llogari është në emër të “Raiffeisen Leasing”, ku subjekti dhe personi i lidhur kryejnë pagesën e kësteve.

4.5 Nga hetimi administrative kryesisht, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë këto llogari bankare dhe ka burime të ligjshme për krijimin e tyre.

5. Automjet “Citroen tip Elysee”, me targa ***

5.1 Në deklaratën vetting të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: marrë hua së bashku me bashkëshorten në datën 25.11.2013 shuma prej 5.000 euro nga shoqëria “****” sh.a. me kontratën nr. ***, me qëllim financimin e blerjes së autoveturës “Citroen tip Elysee” me targa ***. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur pa shlyer deri në datën e dorëzimit të deklaratës është 2.083 euro. Aktualisht detyrimi rezulton të jetë transferuar pranë shoqërisë “Raiffeisen Leasing” sh.a. Kontrata është e lidhur me afat 5-vjeçar dhe momenti i mbarimit të shlyerjes së detyrimit është data 16.11.2018.

⁹⁸ Nxjerrje llogarie e “Raiffeisen Bank”, datë 20.1.2017, e Neritan Cena, sipas së cilës gjendja në këtë datë është 350 euro.

⁹⁹ Vërtetim bankar nr. ***, datë 20.1.2017, nga “Societe Generale Albania”, sipas të cilit Neritan e S.C. kanë marrë një kredi me vlerë 700.000 lekë në datën 7.5.2015, me afat 60-mujor. Mbetja e principalit të kredisë është 498.928 lekë. Klienti ka paguar gjithsej 201.071 lekë principal. Gjendja e llogarisë së Neritan Cena në shumën 16.472 lekë në datën 20.1.2017.

¹⁰⁰ Nxjerrje llogari page e “Raiffeisen Bank”, datë 20.1.2017 Neritan Cena, ku evidentohet gjendja në këtë datë në shumën 725 lekë.

¹⁰¹ Vërtetim nr. ***, datë 24.1.2017 nga “Raiffeisen Leasing”.

¹⁰² E-mail datë 18.5.2020.

5.2 Subjekti për vërtetimin e deklarimeve të tij ka paraqitur dokumentacion ligjor provues¹⁰³.

5.3 Nga dokumentacioni i administruar nga DRSHTRr-ja¹⁰⁴, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka të regjistruar automjetin me targa ***, përfituar me kontratën nr. ***, datë 15.11.2018, nëpërmjet “Raiffeisen Leasing” dhe shtetasve Neritan e S.C. Gjithashtu, nga kontrolli i kryer në AMF, rezulton se ky automjet është në pronësi të subjektit dhe bashkëshortes, znj. S.C.

5.4 Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja/personi i lidhur/S.C., kanë lidhur kontratë qiraje financiare nr. ***, datë 25.11.2013, me shoqërinë “****” sh.a. për financim e blerjes së automjetit tip “Citroen Elyssee” me targa ***, në vlerë 10.000 euro. Qiraja e parë, e barabartë me 50 % të vlerës së sendit është paguar, qiratë në vijim në shumën 5.000 euro janë me bazë mujore duke filluar nga data 17.12.2013.

5.5 Nga hetimi i Komisionit, “Raiffeisen Leasing”¹⁰⁵ konfirmon se subjekti i rivlerësimit bashkë me bashkëshorten kanë pasur kontratën e qirasë financiare ***, transferuar nga “****” sh.a., në nëntor të vitit 2015. Kjo kontratë është mbyllur në datën 13.11.2018.

5.6 Në DPV-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar huan e marrë së bashku me bashkëshorten nga shoqëria “****” sh.a. në shumën 5.000 Euro me qëllim blerjen e autoveturës “Citroen tip Elysee” me targa ***. Gjithashtu, subjekti deklaroi huan e marrë nga kunata, znj. M.Sh. dhe bashkëshorti i saj në shumën 5.000 euro me qëllim financimin e blerjes së kësaj autoveture,

5.7 Në pyetësin nr. 2, subjekti ka deklaruar se fakti që bashkëshortja, znj. S.C. ka marrë hua shumën e sipërcituar nga motra, znj. M.Sh. dhe bashkëshorti z. A.Sh., provohet referuar përmbajtjes së dokumentit të emërtuar “*nxjerrje llogarie*” që mban datën 21.11.2013 të lëshuar nga “Raiffeisen Bank”, në të cilën pasqyrohet qartë se kunata e subjektit, znj. M.Sh. dhe bashkëshorti, z. A.Sh. të kenë transferuar nga llogaria e tyre bankare në shtetin Austriak në llogarinë e bashkëshortes së subjektit, znj. S.C. në “Raiffeisen Bank” shumën prej 5.000 euro me përshkrimin: “*Dhënie hua pa interes të shumës prej 5.000 (pesë mijë) euro motrës sime*”. Në dokumentacionin e administruar nga “Raiffeisen Bank”¹⁰⁶ konfirmohet që ky transaksion¹⁰⁷ është kryer në datën 19.11.2013.

5.8 Lidhur me shlyerjen e kësaj huaje, subjekti ka deklaruar shlyerjen e shumës 4.000 euro në deklaratën periodike/vjetore të vitit 2014 dhe të shumën 1.000 euro në deklaratën periodike/vjetore të vitit 2015.

Lidhur me ligjshmërinë e burimit që ka shërbyer për huan në shumën 5.000 euro nga kunata, motra e bashkëshortes, znj. M.Sh. dhe bashkëshorti

5.9 Subjekti ka shpjeguar se: “[...] Lidhur me mundësinë e tyre për t’i dërguar bashkëshortes sime me anë të transfertës bankare shumën prej 5,000 (pesë mijë) euro krahas dokumentacionit

¹⁰³ Vërtetim nr. ***, datë 24.1.2017, i “Raiffeisen Leasing” sh.a. për automjetin tip “Citroen C-Elyssee”, me targa ***, kontrata e qirasë financiare ***, kontratë themelore e qirasë financiare nr. ***, datë 25.11.2013, ndërmjet shoqërisë “****” sh.a. dhe S., e Neritan Cena.

¹⁰⁴ Shkresë nr. ***, datë 13.5.2020.

¹⁰⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 5.3.2019.

¹⁰⁶ Shkresë nr. *** prot., dt. 22.2.2019.

¹⁰⁷ Përshkrimi në gjuhën gjermane “*werden ohne Zinsen Und ohne Interessen an meine Schëester geborgt*”.

që do citohet më poshtë¹⁰⁸ parashtrij edhe faktin se shuma e sipërcituar rezulton që të jetë transferuar në rrugë bankare dhe konkretisht nga llogaria e tyre bankare në shtetin Austriak, i cili është pjesë e Bashkimit Evropian. Në rrethana të tilla arrihet në përfundimin se ligjshmëria e të ardhurave të kunatës sime M.Sh. dhe bashkëshortit të saj A.Sh. rezulton që të jetë verifikuar më parë nga ana e autoriteteve austriake, të cilët nuk do të lejonin realizimin e kësaj transferte bankare nëse do të kishin dyshime lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave të kunatës sime M.Sh. dhe bashkëshortit të saj A.Sh. Asnjë bankë e vendeve të Bashkimit Evropian pjesë e të cilit në kërkojmë të bëhemi nuk lejon kryerjen e ndonjë transferte bankare nëse shuma që kërkohet të transferohet nuk ka origjinë të ligjshme, si dhe shuma që transferohet i nënshtrohet edhe verifikimeve përkatëse nga ana e bankës që realizon kryerjen e transfertës [..]”

5.10 Komisioni konstaton se në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti nuk ka dorëzuar dokumentacion justifikues për të ardhurat e personave të tjerë të lidhur/M. dhe A.Sh., që kanë shërbyer si burim për këtë hua në vitin 2013. Për këtë arsye, kjo huamarrje nuk u përfshi në analizën financiare.

5.11 Bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqiste shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit se mungon dokumentacioni ligjor justifikues për burimin e ligjshëm të të ardhurave të personave të tjerë të lidhur/M. dhe A.Sh. lidhur me shumën e dhënë hua prej 5.000 euro për blerjen e këtij automjeti.

5.12 Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij, në përgjigje të rezultateve të hetimit, shpjegoi se: “Shuma prej 5.000 euro, rezulton të jetë transferuar në rrugë bankare dhe konkretisht nga llogaria bankare e A. dhe M.Sh. që kanë në ‘Raiffeisen Bank’, Austri në llogarinë bankare të bashkëshortes së subjektit S.C. në Raiffeisen Bank, Shqipëri. Referuar vërtetimit për të ardhurat e realizuara nga A. dhe M.Sh. për vitin 2013, duke përfshirë edhe ndihmën që shteti austriak jep për rritjen e fëmijëve totali i të ardhurave është 29.412,2 euro. Pra, duke iu referuar të dhënave të publikuara nga ana e Komisionit Evropian për vitin 2019 në mungesë të të dhënave për vitin 2013, vit në të cilin kostoja e jetesës natyrisht që rezulton të ketë qenë më e ulët, arrihet në përfundimin se për vitin 2013 mundësia e kursimit për A. dhe M.Sh. do të ishte 14.598,2 euro ose 12.678,2 euro. Në këto kushte në datë 19.11.2013, kur është dërguar transferta bankare, kanë pasur mundësi të jepnin hua shumën prej 5.000 euro. Në prapësime, subjekti kërkoi që kjo shumë të përfshihet në analizën financiare të vitit 2013.”

Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

5.13 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provave shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe

¹⁰⁸ Dokumentacioni i dorëzuar nga ana e subjektit ka të bëjë me të ardhura të përfituara në vitin 2015 e në vazhdim.

provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se:

5.14 Referuar arsyetimit në paragrafët 2.87 - 2.99 dhe konkluzionit të arritur në paragrafin 2.100, ku në analizë të të ardhurave dhe shpenzimeve jetike të personave të tjerë të lidhur/A. dhe M.Sh. për vitin 2013, rezulton një balancë pozitive prej 866,1 euro, e cila është e pamjaftueshme për dhënien hua të shumës prej 5.000 euro, në kushtet kur subjekti nuk dorëzoi dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e këtyre shtetasve përpara vitit 2013.

5.15 Si konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme nga personat e tjerë të lidhur për shumën prej 5.000 euro e përdorur për blerjen e automjetit, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga germa “b”, e pikës 5, të neni 33, të ligjit nr. 84/2016.

6. Automjet tip “Benz” me targa ***

6.1 Në deklaratën përpara fillimit të detyrës të vitit 2004, subjekti ka deklaruar autoveturë marka Benz tipi 124 (200 E), vit prodhimi 1990, dhuruar, në pronësi 100 %, datë 8.5.2004.

6.2 Në përgjigjen e DRSHTRR-së¹⁰⁹ është administruar dosja e automjetit me targa ***, ku ndër të tjera, ndodhet një deklaratë shitje e shtetasit G.C., ku deklaron se ia shet automjetin me targa *** subjektit të rivlerësimit në çmimin 100 euro. Ndërsa në deklaratën doganore të datës 8.5.2004, shuma e përlllogaritur e detyrimeve për taksën doganore dhe për TVSH është 155.512 lekë.

6.3 Në deklaratën periodike të vitit 2005, plotësuar në datën 14.3.2006, subjekti ka deklaruar që ky automjet është vjedhur në datën 17.2.2006. Kjo është konfirmuar sërish nga a subjekti në procesverbalin e mbajtur në datën 24.10.2014, në ILDKPKI.

6.4 Bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime në lidhje me mospërputhjet midis deklaramit të subjektit në DPF-në e vitit 2004 dhe dokumentacionit të administruar lidhur me automjetin me targa ***, pasi subjekti deklaron se i është dhuruar, ndërsa sipas informacionit nga DPSHTRR-së e ka blerë me vlerën 100 euro dhe ka paguar 155.512 lekë për detyrimet doganore, pra të japë shpjegime për sa konstatohet.

6.5 Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij në lidhje me këtë rezultat, shpjegoi se në momentin e deklaramit në vitin 2004 nuk e dispononte kontratën për shkak se gjendej e depozituar në DRSHTRR-në Tiranë. Vlera prej 100 euro ka qenë një vlerë simbolike e cila i është paguar shtetasit italian G.C. nga motra e subjektit, znj. E.C. Ky automjet është vjedhur në datën 17.2.2006.

6.6 Komisioni, referuar shpjegimeve të subjektit dhe provave të administruara gjatë hetimit, arrin në përfundimin se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në lidhje me këtë automjet, pasaktësi e cila nuk mund të përbëjë shkak për shkarkim.

7. Automjet tip “Mercedes Benz” me targa ***

¹⁰⁹ Shkresë nr. ***, datë 13.5.2020.

Faktet nga hetimi i administrativ kryesisht

7.1 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006, subjekti deklaroi blerjen e këtij automjeti në vlerën 250.000 lekë, por nuk deklaroi burimin e krijimit.

7.2 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, subjekti ka deklaruar shitjen e këtij automjeti shtetasit M.C. në vlerën 400.000 lekë. **Në deklaratën Vetting**, subjekti ka dorëzuar kontratën nr. ***, datë 9.12.2011, me palë shitëse subjektin e rivlerësimit dhe palë blerëse M.C. (*vëllai i subjektit*), për shitjen e automjetit “Mercedes Benz” tip 124, prodhim i vitit 1989, me targa ***, me çmim 400.000 lekë, shumë të cilën sipas kontratës blerësi e ka paguar të plotë në prezencë të noteres.

7.3 Nga dokumentacioni i administruar nga DRSHTRR-ja¹¹⁰, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka pasur në pronësi automjetin me targa ***. Ky automjet është blerë nga subjekti i rivlerësimit me kontratën nr. ***, datë 27.7.2006, me palë shitëse shtetasin I.B., në vlerë 250.000 lekë. Gjithashtu nga kontrolli i kryer në AMF, rezulton se ky automjet ka qenë në pronësi të subjektit.

7.4 Komisioni vëren se subjekti e ka shitur këtë automjet pas rreth 5 vjetësh me vlerë 150.000 lekë më shumë nga blerja, duke llogaritur normën e amortizimit për çdo vit dhe vitin e prodhimit të mjetit.

7.5 Në përgjigjen e përcjellë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë¹¹¹, nuk evidentohet pagesa e detyrimeve tatimore për vlerën e fitimit të realizuar nga shitja e këtij automjeti (diferenca prej 150.000 lekë mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes) dhe për këtë arsye vlera e fitimit të realizuar vlerësohet si e ardhur e paligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe kjo vlerë i zbritet të ardhurës të arkëtuar.

7.6 Më tej, në përgjigjen e DRSHTRR-së¹¹² është administruar një formular vetëdeklarimi, datë 27.2.2012, i shtetasit M.C., i cili ka kërkuar çrregjistrimin përfundimtar të mjetit për arsye skrapimi.

7.7 Bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, subjektit iu kërkuar të paraqiste shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit se: (i) duket e dyshimtë shitja e automjetit me targa *** pas rreth 5 vjetësh me vlerë 150.000 lekë më shumë nga blerja, duke llogaritur normën e amortizimit dhe vitin e prodhimit të mjetit dhe duke konsideruar faktin që, 3 muaj pasi e ka paguar, blerësi ka kërkuar çrregjistrimin e mjetit për arsye skrapimi; (ii) duket se ka mungesë dokumentacioni ligjor justifikues për pagesën e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit me targa ***.

7.8 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij lidhur me këtë rezultat të Komisionit, shpjegoi se:

¹¹⁰ Shkresë nr. ***, datë 13.5.2020.

¹¹¹ Shkresë nr. ***, datë 5.3.2019.

¹¹² Shkresë nr. ***, datë 13.5.2020.

7.9 Gjendja teknike e automjetit në momentin e blerjes nuk ishte e mirë dhe, si rrjedhojë, ka kryer shpenzime me qëllim rregullimin e tij, në shumën 350.000 lekë. Pra, vlera e automjetit pas shërbimeve të kryera ka arritur në shumën 600.000 lekë. Pas shitjes së automjetit, blerësi M. C. në datën 30.12.2011, ka pësuar një aksident të rëndë automobilistik si pasojë e të cilit automjeti është shkatërruar plotësisht dhe blerësi ka pësuar dëmtime. Si rrjedhojë e aksidentit të pësuar nuk është arritur të bëhet ndryshimi i pronësisë së automjetit nga subjekti te blerësi.

7.10 Lidhur me diferencën prej 150.000 lekësh, konsideruar si fitim për të cilin duhet të paguahej tatim fitimi subjekti deklaron se pas blerjes së automjetit në me çmim 250.000 lekë, subjekti ka shpenzuar edhe 350.000 lekë të tjera. Vlera e automjetit rezulton që të ketë arritur në shumën 600.000 lekë, si dhe rezulton të jetë shitur në vlerën 400.000 lekë, pra, rreth 200.000 lekë më pak. Në rrethana të tilla subjekti pretendon se nuk kishte detyrim të paguante tatim fitimin mbi diferencën e konstatuar prej 150.000 lekësh i konsideruar si fitim, pasi vlera e investuar për blerjen dhe shpenzimet e kryera për këtë automjet ishte më e lartë se vlera e shitjes.

7.11 Subjekti deklaron se dokumentacioni që vërtetonte vlerën e shpenzuar prej tij, ka qenë pjesë e dokumentacionit të makinës dhe se ky dokumentacion është humbur nga blerësi në datën e aksidentit automobilistik, për shkak se ky automjet është shkatërruar plotësisht duke dalë jashtë përdorimit. Gjithashtu, pretendon se ndodhet në rrethanat e parashikuara nga neni 32 dhe përcaktimet e nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për shkak se ndodhet në pamundësi objektive për të provuar vlerën prej 350.000 lekë të shpenzuar për automjetin dhe, për rrjedhojë, kërkon të përfshihet në analizën financiare të vitit 2011 edhe shuma prej 150.000 lekë e konsideruar si fitim për të cilin nuk është paguar tatimi.

Arsyetimi ligjor mbi faktet dhe ligjin e zbatueshëm

7.12 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provave shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se:

7.13 Pas analizimit të vendimit “Për mosfillimin e procedimit penal” datë 20.1.2012, vëren se ndër të tjera, është vendosur: *“Kthimi i një automjeti tip ‘Benz’ me targa ***, ngjyrë krem në gjendje të dëmtuar, kopje të kartës së identitetit, leja e qarkullimit, akti i shitblerjes së mjetit, certifikata e pronësisë, policë sigurimi nga kompania *** nr. ***, si dhe dokumentacioni shoqërues i mjetit ***, shtetasit M.C.”*¹¹³.

7.14 Referuar vendimit të prokurorisë rezulton se z. M.C. i është kthyer dokumentacioni i automjetit me targa ***, leja e qarkullimit, akti i shitblerjes së mjetit, certifikata e pronësisë, policia e sigurimit, si dhe dokumentacioni shoqërues i këtij mjeti. Për këtë arsye, pretendimet e subjektit se dokumentacioni që vërtetonte vlerën e shpenzuar prej tij, ka qenë pjesë e

¹¹³ Me anë të shkresës nr. *** prot., datë 3.2.2012, shtetasit M.C. i është dërguar një kopje e vendimit të mosfillimit të procedimit penal.

dokumentacionit të makinës dhe se ky dokumentacion është humbur nga blerësi në datën e aksidentit automobilistik, si rezultat i shkatërrimit të mjetit dhe humbjes së dokumenteve, nuk është i bazuar në prova dhe fakte. Për pasojë, Komisioni vlerëson se subjekti nuk gjendet në rrethanat e parashikuara nga pika 2, e nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

7.15 Për sa më sipër, duke qenë se subjekti i rivlerësimit i pretendon këto të ardhura të përfituara nga shitja e automjetit, sipas germës “g”, të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, duhet të kishte paguar tatimin mbi fitimin. Fakti që subjekti nuk provoi pagimin e detyrimit tatimor këto të ardhura nuk konsiderohen të ligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, si dhe bazuar në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit të Posacëm të Apelimit.

7.16 Në përfundim, Komisioni vlerëson se shuma prej 150.000 lekësh, që përbën diferencën mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes nuk duhet të konsiderohet si e ardhur në analizën financiare, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga pika 3, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germa “b”, e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

8. Automjet tip “Ford” me targa * (***) , me vlerë 3.000 euro**

Faktet nga hetimi i administrativ kryesisht

8.1 Në DPV-në e vitit 2008, bashkëshortja e subjektit, znj. S.C., ka deklaruar se në datën 28.8.2008, ka blerë autoveturën Ford, tip KA, viti i prodhimit 1999 me targa ***, çmimi 3.000 euro (366.000 lekë). **Si burim krijimi** deklaroi kredi nga “Credins Bank”, në shumën 300.000 lekë dhe të ardhurat nga paga si juriste pranë ALUIZNI-t Vlorë, shuma 66.000 lekë. Po këtë vit personi i lidhur/S.C. ka deklaruar edhe kredinë në shumën 300.000 lekë, marrë në “Credins Bank” në datën 19.3.2008, me qëllim blerjen e automjetit.

8.2 Në dokumentacionin e administruar nga “Credins Bank”¹¹⁴, konstatohet se kredia është disbursuar në datën 20.3.2008 dhe më 21.3.2008 është kryer një tërheqje në shumën 323.000 lekë nga personi i lidhur/S.C.

8.3 Në DPV-në e vitit 2014, subjekti deklaroi se bashkëshortja ia ka shitur e automjetin “Ford” shtetases A. V., me kontratën nr. ***, datë 1.8.2014, me çmim 2.000 euro.

8.4 Nga dokumentacioni i administruar nga DRSHTRR-ja¹¹⁵, rezulton se bashkëshortja e subjektit, znj. S.C. ka pasur të regjistruar automjetin me targa ***, aktualisht ka në pronësi automjetin me targa **. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur, znj. S.C. me kontratën nr. ***, datë 28.8.2008, ka blerë automjetin “Ford”, me çmim 3.000 euro (366.000 lekë), likuiduar jashtë zyrës noterale. Gjithashtu, nga kontrolli i kryer në AMF, rezulton se ky automjet ka qenë në pronësi të bashkëshortes së subjektit, znj. S.C.

¹¹⁴ Shkresë nr. ***, datë 12.4.2019,

¹¹⁵ Shkresë nr. ***, datë 13.5.2020.

8.5 Komisioni administroi kontratën e shitjes së këtij automjeti me anë të praktikës së noteres E.A., dërguar me shkresë, datë 11.5.2020, protokolluar me nr. ***, datë 13.5.2020.

8.6 Komisioni, bazuar në faktet dhe provat e sipërpërmendura, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe kanë pasur burime financiare të ligjshme për blerjen e këtij automjeti pasi si burim ka shërbyer kredia e marrë në “Credins Bank”.

9. Automjet tip “Mercedes Benz” me targa * (***)**

9.1 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, subjekti deklaroi blerjen e automjetit tip “Mercedes Benz 210E 300DT”, me targa ***, vit prodhimi 1997, në datën 16.12.2011 nga shtetasi A.G. në vlerën 8.000 euro ose 1.100.000 lekë. Në seksionin e detyrimeve financiare subjekti ka deklaruar se ka marrë borxh nga babai shumë prej 250.000 lekësh për blerjen e këtij automjeti, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit për diferencën (shumën 850.000 lekë).

9.2 Nga dokumentacioni i administruar nga DRSHTRR-ja¹¹⁶ konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka pasur në pronësi automjetin me targa *** (***) dhe se bazuar në kontratën e shitblerjes me nr. ***, datë 16.12.2011, shuma prej 8.000 euro është likuiduar plotësisht përpara përpilimit të kontratës jashtë zyrës noteriale.

9.3 Sipas dokumentacionit bashkëlidhur ky automjet është blerë në datën 9.7.2005, në Gjermani nga z. A.G. në vlerën 4.500 euro. Gjithashtu, nga kontrolli i kryer në AMF rezultoi se automjeti ka qenë në pronësi të subjektit.

9.4 Në DPV-në e vitit 2015, subjekti deklaroi shitjen e këtij automjeti në vlerën 850.000 lekë. Me kontratën nr. ***, datë 25.4.2015, me palë shitëse subjektin e rivlerësimit, i cili i ka shitur blerësit A.Xh. automjetin tip “Mercedes Benz E 300 DT”, prodhim i vitit 1997, me targa ***, me çmim 850.000 lekë.

9.5 Në lëvizjen e llogarisë bankare të subjektit të rivlerësimit, administruar nga “Intesa Sanpaolo Bank”, evidentohet një depozitim në datën 7.5.2015 me përshkrim: “*cash depozit A.Xh. për blerje makine Benz Mercedes me targa ****”.

9.6 Për të analizuar burimin e ligjshëm për blerjen e këtij automjeti, Komisioni kreu analizën financiare për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit dhe personave të lidhur për vitin 2011, nga ku rezultoi një balancë negative në shumën 570.748 lekë.

9.7 Nga analiza financiare e vitit 2011, në tabelën më sipër, konstatohet se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme, të mjaftueshme për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive, me një balancë negative në shumën 570.648 lekë.

9.8 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit se nga analiza financiare e vitit 2011 duket se subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme, të mjaftueshme

¹¹⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 13.5.2020.

për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive, me një balancë negative në shumën 570.648 lekë.

9.9 Subjekti i rivlerësimit, në prapësime të rezultatit të mësipërm të hetimit, paraqiti analizën e tij financiare lidhur me balancën negative të vitit 2011, ku balanca vjetore rezulton në shumën 59.352 lekë dhe shpjegoi qëndrimin e tij: (i) në analizën financiare duhet të përfshihet edhe shuma prej 150.000 lekësh nga shitja e automjetit me targa ***, trajtuar më lart në paragrafët 7.8 - 7.11; (ii) nga Komisioni nuk rezulton që të jenë marrë në konsideratë kursimet, ndër vite, të deklaruara prej tij dhe bashkëshortes, konkretisht për vitin 2011, referuar analizës së tij financiare, dhe pretendon që ndryshimi i likuiditeve *cash* të bëhet -430.000 lekë nga +50.000 lekë që është pasqyruar në analizën e Komisionit.

Arsyetimi ligjor mbi faktet dhe ligjin e zbatueshëm

9.10 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratën e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se:

9.11 Në lidhje me pikën (i), shuma prej 150.000 lekësh, që përbën diferencën mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes nuk u konsiderua si e ardhur në analizën financiare (sipërtrajtuar në paragrafët 7.12 - 7.16).

9.12 Në lidhje me pikën (ii), Komisioni vlerëson që gjendja e likuiditeve *cash* në fund të çdo viti mbetet e pandryshuar sipas arsyetimit në paragrafët 3.87 - 3.89.

9.13 Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti dhe persona e lidhur kanë mungesë financiare burimesh të ligjshme në shumën -570.648 lekë për përballimin e shpenzimeve në vitin 2011, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga germa “b”, e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

10. Automjet tip “Daimler Chrysler AG” me targa *, me vlerë 14.000 euro**

10.1 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015, subjekti ka deklaruar se ka blerë me aktin e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., nga shtetasi F.C. automjetin tip “Daimler Chrysler”, me targa ***, vit prodhimi 2008, pajisur me targa shqiptare ***, në shumën 14.000 euro (shuma 13.000 euro i është dërguar me bankë).

10.2 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka dorëzuar dokumentacion ligjor justifikues¹¹⁷.

¹¹⁷ Kontratë nr. ***, datë 16.5.2015, sipas së cilës z. Neritan Cena ble nga shtetasi F.C. automjetin tip “Daimler Chrysler”, prodhim i vitit 2008, me targa *** me çmim 14.000 euro + dokumente identifikimi të palëve + dokument zhdoganimi i datës 16.5.2015 për z. F.C. + urdhërçlirimimi i datës 16.5.2015, i DPD-së me importues F.C. + certifikatë pasurie italiane për automjetin me targa *** në emër të z. F.C. datë 18.5.2015 + vërtetim përkthimi nr. *** rep., datë 20.5.2015 + certifikatë pasurie italiane për automjetin me targa *** në emër të z. F.C. datë 13.5.2015 + vërtetim përkthimi nr. *** rep., datë 16.5.2015 + dokumente italiane për automjetin me targa ***.

10.3 Nga dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti në deklaratën *Vetting* dhe nga ai i administruar nga DRSHTRR-ja¹¹⁸, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka pasur në pronësi automjetin me targa ***, tip “Daimler Chrysler”, prodhim i vitit 2008. Ky automjet është blerë nga subjekti me kontratën nr. ***, datë 16.5.2015, në vlerën 14.000 euro, me palë shitëse z. F.C., pagesa është bërë jashtë zyrës noteriale. Gjithashtu nga kontrolli i kryer në AMF, rezulton se ky automjet ka qenë në pronësi të subjektit.

10.4 Komisioni vëren se ky automjet është blerë nga z. F.C. në shumën 17.200 euro + shpenzimet doganore në vlerën 487.778 lekë, zhdoganuar në datën 16.5.2015, në total 17.200 euro * 141.03 lekë (kursi datë 15.5.2015) = 2.425.716 + 487.778 = 2.913.494 lekë ose 20.659 euro.

10.5 Sa më sipër, duket se shitja e automjetit nga shtetasi F.C. me çmim 14.000 euro me një humbje prej 6.659 euro brenda ditës (datë 16.5.2015), përbën një veprim financiar të pajustificueshëm duke ngritur dyshime për caktim të një çmimi fiktiv në kontratën e shitblerjes së automjetit.

10.6 Nga hetimi i Komisionit rezulton se shtetasi F.C. ka lëshuar deklaratën noteriale¹¹⁹ nr. ***, datë 16.8.2019, ku deklaron se automjetin e mësipërm ia ka shitur subjektit në vlerën 14.000 euro, ku shumën prej 13.000 euro subjekti ia ka paguar me anë të transfertës bankare datë 7.5.2015, ndërsa diferenca 1.000 euro është paguar në datën e nënshkrimit të kontratës. Ky shtetas shprehet në deklaratë se shuma 13.000 euro e transfertës bankare nuk ka qenë kthim huaje¹²⁰, por pagim paraprak i pjesës më të madhe të automjetit dhe se kjo është arsyeja që pas marrjes së shumës është kthyer në Shqipëri për lidhjen e kontratës.

10.7 Komisioni konstaton se burimi i transfertës prej 13.000 euro kryer nga “Intesa Sanpaolo Bank” e ka burimin nga: **(1)** Konvertimi i shumës 850.000 lekë, të përfituara nga shitja e automjetit që ka pasur në pronësi me targa ***, të depozituara në datën 7.5.2015; **(2)** dy depozitime nga subjekti i rivlerësimit në datën 7.5.2015, të vlerës 4.975.12 euro dhe 2.000 euro.

Komisioni analizoi të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e këtij automjeti: (i) shuma prej 850.000 lekë, nga shitja e automjetit që ka pasur në pronësi me targa ***, me anë të kontratës nr. ***, datë 25.4.2015, shtetasit A.Xh. në shumën 850.000 lekë (trajtuar në pikën 9); **(ii)** shuma prej 3.988 euro, marrë hua kumatës M.Sh.

10.8 Në DPV-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar huan e marrë në shumën 3.988 euro, në datën 4.5.2015, me anë të transfertës bankare nga kunata M.Sh. dhe bashkëshorti i saj A.Sh., me qëllim blerjen e automjetit nga shtetasi F.C. dhe transferta është kryer në “Raiffeisen Bank”. Në deklaratën *Vetting* subjekti deklaron se kjo shumë ka mbetur pa shlyer deri në datën e dorëzimit të deklaratës.

¹¹⁸ Shkresa nr. *** prot., datë 13.5.2020.

¹¹⁹ Administruar nga praktika e noteres E.A., dërguar me shkresë datë 11.5.2020, protokolluar me nr. *** prot., datë 13.5.2020.

¹²⁰ Në lëvizjen e llogarisë së “Intesa Sanpaolo Bank”, përshtkrimi i transfertës në shumën 13.000 euro, datë 7.5.2015, nga llogaria e subjektit të z. F.C. është “*turn of debt*”, pra, kthim huaje.

10.9 Për të vërtetuar marrjen e kësaj huaje, në deklaratën *Vetting*, subjekti dorëzoi nxjerrje llogarie nga “Raiffeisen Bank”, datë 19.5.2015, të bashkëshortes S.C.

10.10 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2¹²¹, subjekti deklaroi se marrja e kësaj huaje provohet referuar përmbajtjes së dokumentit të emërtuar “*nxjerrje llogarie*” që mban datën 19.5.2015, të lëshuar nga shoqëria “Raiffeisen Bank” sh.a., në të cilën pasqyrohet qartë se kunata e tij, znj. M.Sh., dhe bashkëshorti i saj, z. A.Sh., të kenë transferuar në datën 4.5.2015, nga llogaria e tyre bankare në shtetin austriak në llogarinë e bashkëshortes së subjektit, znj. S.C., në shoqërinë “Raiffeisen Bank” sh.a., shumat 994 euro dhe 2.994 euro, gjithsej shumën 3.988 euro me përshkrimin: “për blerje makine”. Në dokumentacionin e administruar nga “Raiffeisen Bank”¹²² konfirmohen transaksionet¹²³ e deklaruara nga subjekti.

Lidhur me ligjshmërinë e burimit të huas me vlerë 3.988 euro

10.11 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka dorëzuar vërtetimet e të ardhurave për vitin 2015, ku të ardhurat *bruto* të shtetasve A. dhe M.Sh. janë në shumën 49.644,51 euro, ndërsa të ardhurat *neto* janë në shumën 34.594,35 euro. Subjekti nuk ka dorëzuar dokumentacion për të ardhurat e përfituara përpara vitit 2015.

10.12 Shpenzimet jetike vjetore për vitin 2015 për një familje me 4 persona kanë qenë në vlerën 29.308 euro¹²⁴. Diferenca vjetore e mundshme për kursim për vitin 2015 ka qenë 5.286,35 euro. Huaja prej 3.988 euro është dhënë në datën 4.5.2015. Për rrjedhojë, mundësia për kursim gjatë 4 muajve të parë duket të ketë qenë në vlerën 1.762,11¹²⁵ euro, e pamjaftueshme për dhënien e huas prej 3.988 euro.

Kursimet nga paga

10.13 Për të analizuar burimin e ligjshëm të kursimeve, konkretisht të shumës 3.945,35 euro¹²⁶, Komisioni kreu analizën financiare për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit dhe personave të lidhur për vitin 2015, ku konstatohet se subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme, të mjaftueshme për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive, me një balancë negative në shumën 1.321.161 lekë.

10.14 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, se nga analiza financiare e vitit 2015 subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme, të mjaftueshme për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive, me një balancë negative në shumën 1.321.161 lekë.

¹²¹ E-mail datë 11.5.2020, ora 10:45.

¹²² Shkresë nr. *** prot., datë 22.2.2019.

¹²³ Përshkrimi në gjuhën gjermane “*fur Autokauf*”.

¹²⁴ <http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/submitViewTableAction.do>

¹²⁵ 5.286,35 euro/12 muaj = 440.53 euro/muaj. Për periudhën 1.1.2015 – 30.4.2015: 440.53 euro x 4 = 1.762.11 euro.

¹²⁶ E përberë nga 1.000 euro të paguara datën e nënshkrimit të kontratës dhe 2.945,35 euro si diferencë e shumës së depozituar nga subjekti në llogarinë e tij në “Intesa Sanpaolo Bank” në datën 7.5.2015 (6.975,12 euro) me atë të tërhequr nga bashkëshortja (3.985 euro) nga llogaria e saj në “Raiffeisen Bank” në datën 5.5.2015, që e kanë burimin nga transfertat e znj. M.Sh.

10.15 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij të rezultatit të mësipërm, paraqiti analizën e tij financiare lidhur me balancën negative të vitit 2015, ku balanca vjetore rezultoi në shumën 57.787 lekë dhe shpjegoi qëndrimin e tij, si vijon: (i) në analizën financiare duhet të përfshihet huaja në shumën 3.988 euro, nga shtetasit M. dhe A.Sh., pasi të ardhurat e tyre për këtë vit rezultojnë të jenë në shumën 34.594,35 euro, ndërsa kostoja minimale e jetesës në shumën 14.814 euro ose në shumën 16.734 euro dhe, si rrjedhim, mundësia e kursimit për shtetasit A. dhe M.Sh. për vitin 2015 të jetë në shumën 19.780,35 euro ose në shumën 17.860,35 euro; (ii) subjekti shpjegon se nga Komisioni nuk rezultoi që të jenë marrë në konsideratë kursimet ndër vite të deklaruara prej tij dhe bashkëshortes, konkretisht për vitin 2015, referuar analizës së tij financiare, dhe pretendon që ndryshimi i likuiditeve *cash* të bëhet -730.000 lekë nga 0 lekë që është e pasqyruar në analizën e Komisionit; (iii) shpenzimet për jetesë duhet të reduktohen me 100.000 lekë si rezultat i jetesës së përbashkët me prindërit.

Arsyetimi ligjor mbi faktet dhe ligjin e zbatueshëm

10.16 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratat e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shpresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shpresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se:

10.17 Lidhur me pretendimin e subjektit sipas pikës (i), referuar arsyetimit në paragrafët 2.87 - 2.99 dhe konkluzionit të arritur në paragrafin 2.100, ku në analizë të të ardhurave dhe shpenzimeve jetike të personave të tjerë të lidhur/A. dhe M.Sh. për vitin 2015, rezultoi një balancë pozitive prej 5.902,75 euro, e cila është e mjaftueshme për dhënien hua të shumës prej 3.988 euro dhe, për rrjedhojë, u mor në konsideratë pretendimi i subjektit dhe kjo shumë u paraqiti në analizën financiare.

10.18 Lidhur me pretendimin e subjektit sipas pikës (ii), Komisioni vlerëson që gjendja e likuiditeve *cash* në fund të çdo viti mbetet e pandryshuar sipas arsyetimit në paragrafët 3.87 - 3.89.

10.19 Lidhur me pretendimin e subjektit sipas pikës (iii), duke u bazuar në shpjegimet e tij për balancat e viteve 2014 - 2015 dhe deklaratën në pyetësorin nr. 3¹²⁷, Komisioni çmon se pretendimi i subjektit qëndron dhe se shpenzimet jetike të tij për vitin 2015 duhen reduktuar me 100.000 lekë.

10.20 Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti dhe persona e lidhur kanë mungesë financiare burimesh të ligjshme në shumën -672.213 lekë për përbalimin e shpenzimeve dhe blerjen në vitin 2015, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga germa "b", e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

¹²⁷ [...] Në vitin 2015 sikurse kam deklaruar edhe në përgjigjet e pyetësorit shtesë nr. 2 kam jetuar me bashkëshorten S.C. dhe 2 (dy) vajzat e mia I. dhe A.C., si dhe me 2 (dy) prindërit e mi B. dhe E.C. Shpenzimet për jetesë janë përballuar bashkërisht si nga unë dhe bashkëshortja ime S.C. me të ardhurat e përfituara nga paga, ashtu edhe nga prindërit e mi B. dhe E.C. me të ardhurat që këto kanë përfituar dhe, konkretisht, babai im nga paga e tij si mjek dhe mamaja ime nga pensioni i invaliditetit që ajo përfiton. Në këtë vit shpenzimet për jetesë në pjesën më të madhe të tyre janë përballuar nga prindërit e mi B. dhe E.C. [...].

Konstatime të tjera

11. Në lidhje me shpenzimet e mobilimit të banesave në Gjermani

11.1 Në pyetësin nr. 2¹²⁸, subjektit i është kërkuar të deklarojë shpenzimet e arredimit të kryera në banesat e tij në Gjermani, duke qenë se në pyetësin standard subjekti ka deklaruar se ka qëndruar aty në disa prej udhëtimeve të tij në Gjermani.

11.2 Në përgjigjen e tij, subjekti ka deklaruar se: *“... gjatë kohës që unë kam qëndruar në banesat e mia nuk kam kryer ndonjë shpenzim arredimi apo mirëmbajtjeje referuar për këtë qëllim faktit se qëndrimet në banesë kanë qenë shumë të shkurtra dhe konkretisht disa ditore, si dhe banesat janë marrë në gjendje të mobiluar dhe të gatshme për banim. Në rrethana të tilla nuk ishte e nevojshme që të kryeja shpenzime për mobilim apo arredim”*.

11.3 Në dokumentacionin e dorëzuar në deklaratën *Vetting* dhe në atë të përcjellë nga subjekti në pyetësin nr. 2, janë administruar edhe kontratat e shitblerjes dhe kontratat e qirasë për këto pasuri.

11.4 Komisioni konstaton se në kontratën e shitjes së pasurisë të ndodhur në M., S. ***, lidhur në datën 15.12.2015, çmim blerje 25.000 euro, konkretisht në pikën II – shitja, citohet se: *“Pjesë e shitjes nuk janë aksesore apo sende të tjera të lëvizshme, sidomos ndonjë kuzhinë e instaluar apo mobilje të tjera”*.

11.5 Ndërkohë që në kontratën e qirasë së lidhur në datën 8.10.2016 për këtë objekt, ku subjekti është në cilësinë e qiradhënësit, në nenin 1, “objekti i qirasë”, citohet: *“qiradhënësi i jep me qira qiramarrësit për qëllime banimi banesën (nr. ***) e ndodhur në ***B., në katin *** (djathtas), të mobiluar plotësisht”*.

11.6 Më tej, në nenin 17, “marrëveshje individuale”, citohet se në banesën e marrë me qira të gjitha mobiljet dhe pajisjet elektroshtëpiake duhen trajtuar me kujdes, pasi kuzhina ishte e re dhe banesa ishte restauruar dhe e sapolyer.

11.7 Më tej, subjekti deklaron se gjatë vitit 2017 ka shpenzuar shumën prej 4.106 euro për rikonstrukcionin e kësaj banese, i cili është bërë me të ardhurat e përfituara nga dhënia me qira e banesës. Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti faturën nr. ***, datë 30.12.2017, të lëshuar nga shoqëria “****” ***, sipas së cilës vlera e punimeve të kryera gjatë periudhës 27.3.2017 – 12.12.2017 është në shumën 4.106 euro.

11.8 Po kështu, edhe në kontratën e shitjes së pasurisë të ndodhur në ***, lidhur në datën 28.9.2016, çmim blerjeje 48.500 euro, në pikën II – shitja, citohet se: *“... pjesë e shitjes nuk janë aksesore apo sende të tjera të lëvizshme, sidomos ndonjë kuzhinë e instaluar apo mobilje të tjera”*.

11.9 Ndërkohë që në kontratën e qirasë së lidhur në datën 31.12.2017, ku subjekti është në cilësinë e qiradhënësit, në pikën 5, të nenit 15, shprehet se: *“... nëse gjatë dorëzimit të objektit me qira konstatohet një dëm/dëmtim në këtë apo në pajisjet/mobilimet dhe qiramarrësi ka faj për këtë, atëherë qiramarrësi është i detyruar për kompensimin e dëmit të shkaktuar”*.

¹²⁸ E-mail datë 27.2.2019, ora 15:44.

11.10 Për më tepër, në disa prej udhëtimeve të tij jashtë vendit, konkretisht në periudhat 28.12.2016 – 4.1.2017; 1.5.2017 – 4.5.2017 dhe 25.11.2017 – 29.11.2017, subjekti ka deklaruar në pyetësorin standard se ka qëndruar në pasurinë e tij të ndodhur në *** (sipas rastit, vetëm ose së bashku me familjen e tij).

11.11 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime në lidhje me konstatimin se: deklaratimet e subjektit në lidhje me shpenzimet e mobilimit të pasurive në B., Gjermani duket të jenë kontradiktore dhe ka dyshime për mosdeklarim të këtyre shpenzimeve, pasi: **(i)** subjekti deklaron që banesat janë marrë të mobiluara dhe të gatshme për banim; **(ii)** në kontratat e shitjes citohet se pjesë e kontratës së shitjes nuk janë aksesorë apo sende të tjera të lëvizshme; **(iii)** ndërkohë që në kontratën e qirasë së njëjës banesë shprehet qartë që është e mobiluar plotësisht dhe në kontratën e qirasë së banesës tjetër nënkuptohet që banesa është e mobiluar, çka do të thotë se banesat janë mobiluar pasi janë blerë.

11.12 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, mbi rezultatin e mësipërm të hetimit, shpjegoi se banesat ishin të mobiluara. Referuar legjislacionit gjerman, vijon subjekti, shitësi është i detyruar që në momentin që i dorëzon banesën blerësit të heqë të gjitha mobiljet. Meqenëse për shitësit heqja e mobiljeve kishte shpenzime që duhet të përballoheshin nga ana e tyre, si dhe në kushtet kur subjektit i interesonin mobiljet, ranë dakord që mobiljet të mbeteshin në banesë.

11.13 Subjekti, gjithashtu, shpjegon se përveç shumës prej 4.106 euro, nuk ka shpenzuar ndonjë shumë tjetër për mobilim apo rikonstruksion lidhur me banesat e ndodhura në B., Gjermani.

Arsyetimi ligjor mbi faktet dhe ligjin e zbatueshëm

11.14 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se:

11.15 Subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm mospërputhjet që ekzistonin midis dokumentacionit të administruar dhe deklaratimeve të tij në lidhje me shpenzimet për mobilimin e këtij apartamenti.

11.16 Pretendimi i subjektit se banesat ishin të mobiluara dhe se referuar legjislacionit gjerman shitësi është i detyruar që në momentin që i dorëzon banesën blerësit të heqë të gjitha mobiljet, ngelet vetëm në nivel deklarativ dhe i paprovuar.

11.17 Si konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shpenzimet e kryera për mobilimin e këtyre dy apartamenteve, blerë në B. Gjermani, duke u përpjekur të fshehtë këto shpenzime, të cilat duhet të ishin pjesë e kontrollit të pasurisë, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga pikat 1 dhe 5, të

nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nga gërmat “a” dhe “ç”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

12. Analiza financiare

12.1 Komisioni kreu analizën financiare për periudhën tetor 2002 – 2018, duke marrë në konsideratë pasuritë, të ardhurat, detyrimet dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, duke i vendosur në dispozicion subjektit edhe analizën e detajuar.

12.2 Bazuar në këtë analizë, Komisioni konstatoi në rezultatet e hetimit administrativ kryesisht dhe njoftoi subjektin, si vijon:

- i. Për vitin 2011, ka mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën 570.648 lekë, për të cilën ka kaluar barra e provës në pikën 9.7 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht.
- ii. Për vitin 2015 ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën 1.321.161 lekë, për të cilën ka kaluar barra e provës në pikën 10.13 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht.
- iii. Për vitin 2016 ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën 7.042.672 lekë, për të cilën ka kaluar barra e provës në pikën 3 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

12.3 Subjekti i rivlerësimit, krahas pretendimeve për balancat negative vjetore, për të cilat Komisioni ka argumentuar në paragrafët përkatës të këtij vendimi, ka parashtruar edhe pretendimin e tij lidhur me shpenzimet e jetesës të përllogaritura nga Komisioni.

12.4 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, ka pretenduar se: **(i)** nga Komisioni nuk është përmbushur detyrimi ligjor për ta informuar dhe për ta sqaruar se cilët janë elementët që përfshihen në këto shpenzime; **(ii)** rezulton se është përdorur e njëjta kosto jetese si për një të rritur ashtu edhe për një fëmijë; **(iii)** shpenzimet e jetesës janë në kundërshtim me shifrat e publikuara nga INSTAT-i, pasi për vitin 2014 konsumi mujor për një familje është në vlerën 833.304 lekë sipas INSTAT-it, ndërsa Komisioni e ka përllogaritur në vlerën 879.992 lekë; për vitin 2015 konsumi mujor për një familje është 849.192 lekë sipas INSTAT-it, ndërsa Komisioni e ka përllogaritur në vlerën 897.104 lekë; për vitin 2016 konsumi mujor për një familje është 877.716 lekë sipas INSTAT-it, ndërsa Komisioni e ka përllogaritur në vlerën 940.368 lekë.

12.5 Në vijim, subjekti i rivlerësimit shpjegon se referuar tabelës së INSTAT-it, në të cilën përfshihen elementët që përbëjnë grupet kryesore të konsumit, rezulton se: **(i)** në këtë grup përfshihet edhe komunikimi (shpenzimet telefonike), të cilat zënë një peshë prej 3.2 % për vitin 2014, 2.9 % për vitin 2015 dhe 3.2 % për vitin 2016, ndërkohë që në analizën financiare të Komisionit shpenzimet telefonike janë pasqyruar më vete duke e rënduar padrejtësisht me shpenzime të përfshira në shpenzimet e jetesës; **(ii)** në këtë grup përfshihet edhe mobilimi, pajisjet shtëpiake dhe mirëmbajtje të zakonshme të banesës, të cilat zënë një peshë prej 5.5 % për vitin 2014, 5 % për vitin 2015 dhe 4.8 % për vitin 2016, ndërkohë që, në kushtet që mobilimi është deklaruar në vitin 2015, shpenzimet lidhur me këtë zë duhet të zbriten për shkak se janë përfshirë dy herë në analizën financiare; **(iii)** në këtë grup përfshihet edhe zëri “restorante dhe hotele”, të cilat zënë një peshë prej 2.9 % për vitin 2014; 2.8 % për vitin 2015 dhe 4.3 % për vitin 2016, ndërkohë që rezulton se shpenzimet e udhëtimit dhe të fjetjes të jenë llogaritur si zë i veçantë; **(iv)** në këtë grup rezulton që është i përfshirë zëri “ushqime dhe pijet

joalkolike”, i cili zë një peshë prej 44.4 % për vitin 2014; 48.6 % për vitin 2015 dhe 45.4 % për vitin 2016, ndërkohë që fëmijët e subjektit arsimohen në shkolla private (ku përfshihet mëngjesi dhe dreka) dhe, për rrjedhojë, shpenzimet për ushqime duhet të zbriten minimalisht me 10 %.

Arsyetimi ligjor mbi faktet dhe ligjin e zbatueshëm

12.6 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se:

12.7 Lidhur me pretendimet e subjektit për mosinformimin dhe sqarimin e elementëve të përfshirë në vlerën e shpenzimeve jetike të përdorur në analizën financiare, përllogaritjen e kostos së njëjtë për një të rritur dhe një fëmijë dhe diferencat e evidentuara midis vlerës së përdorur nga Komisioni dhe vlerës që është specifikuar nga subjekti, Komisioni thekson se për përllogaritjen e shpenzimeve jetike është bazuar në shkresën nr. ***, datë 4.3.2019, nga ILDKPKI-ja, ku specifikohet niveli i shpenzimeve jetike për çdo vit kalendarik dhe bashkëlidhur së cilës ndodhet e gjithë korrespondenca zyrtare ndërmjet ILDKPKI-së dhe INSTAT-it, ku ky i fundit është institucioni ekspert në vlerësimin e këtyre shpenzimeve në Republikën e Shqipërisë. Në vijim, Komisioni analizon se subjekti i është vënë në dispozicion shkresa e sipërcituar nr. ***, datë 4.3.2019 e ILDKPKI-së dhe, së bashku me relacionin mbi rezultatet e hetimit kryesisht, i është vendosur në dispozicion edhe Aneksi 02, ku është cituar pikërisht kjo shkresë, e më tej është sqaruar vlera e përdorur për shpenzimet jetike të vitit 2007.

12.8 Për sa i përket pretendimeve të mësipërme të subjektit të rivlerësimit për reduktimin e shpenzimeve jetike me përqindje të caktuara sipas grupeve të konsumit, Komisioni vlerëson se këto pretendime nuk mund të merren në konsideratë, kjo duke konsideruar rrethanat konkrete të tilla si përpjekjen për të rritur cilësinë e jetesës nëpërmjet shtimit të pasurive të paluajtshme me anë të blerjes së dy banesave në Gjermani dhe një banese në bregdet, arsimimin e fëmijëve në shkolla private dhe kurimi jashtë vendit, rrethana që janë tregues se subjekti dhe familja e tij kanë jetuar normalisht duke kapërcyer nivelin e minimumit të shpenzimeve.

12.9 Si konkluzion, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë burimesh të ligjshme financiare për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve në shumën -570.648 lekë për vitin 2011, në shumën -700.000 lekë (ekuivalenti 5.000 euro) për vitin 2013, në shumën -672.213 lekë për vitin 2015, në shumën -4.180.341 lekë (ekuivalenti 31.150 euro) dhe -689.950 lekë për vitin 2016, në total shuma -6.813.152 lekë.

Vlerësimi tërësor në lidhje me rivlerësimin e pasurisë

Bazuar në arsyetimin më lart për secilën pasuri të deklaruar veçmas dhe të tjera dalë nga hetimi administrativ, Komisioni, sipas bindjes së brendshme dhe bazuar në rezultatin tërësor të procesit të rivlerësimit, çmon se faktet në lidhje me kriterin e pasurisë nuk të krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë pasuritë dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit.

Komisioni, në vlerësim tërësor të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, nuk krijon bindjen se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit janë të vërteta dhe të arsyeshme, për shkak se:

1. Subjekti i rivlerësimit ka blerë tri pasuri të paluajtshme brenda 2 viteve, nga të cilat 2 apartamente në B. të Gjermanisë dhe një apartament në Tiranë, me një vlerë totale prej 25.000 euro + 45.000 euro + 5.400.000 lekë dhe si burim për blerjen e këtyre pasurive, subjekti ka deklaruar dhurime nga babai (25.000 euro), motra (16.150 euro) dhe hua nga kunatat (5.400.000 lekë dhe 9.000 euro), hua nga djali i xhaxhait 2.000 euro. Nga e gjithë kjo pasuri e krijuar, subjekti ka paguar nga të ardhurat e veta shumën 1.350 euro, nga të ardhurat si gjyqtar dhe 20.000 euro nga shitja e një automjeti, të cilin e ka shitur 6.000 euro më shumë se çmimi i blerjes.
2. Babai i subjektit të rivlerësimit nga njëra anë i dhuron subjektit të rivlerësimit shumën 25.000 euro (550.000 lekë + 22.757 euro) në vitin 2015 për blerjen e apartamentit në B. Gjermani dhe nga ana tjetër në vitin 2016 babai përfiton nga subjekti shumën prej 5.400.000 lekë nga shitja e apartamentit në Tiranë, shumë e cila ka si burim një hua marrë nga motra e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit. Pra, një baba i cili e ndihmon të birin/subjektin gjatë gjithë kohës duke i dhuruar dhe dhënë hua, i merr të birit/subjektit shumën 5.400.000 lekë marrë hua nga ky i fundit, duke pasur parasysh që babai një pjesë të mirë të këtyre të ardhurave i ka mbajtur në llogari bankare dhe më vonë, në vitin 2018, sërish i jep hua subjektit për të blerë banesë në Lukovë. I gjithë ky transaksion duket i pabesueshëm për Komisionin.
3. Nëse analizojmë nevojën, kohën dhe vendin e blerjes së apartamentit nga babai i subjektit, rezulton se babai nuk kishte nevojë për një apartament në Tiranë, kur kishte në pronësi një shtëpi dhe truall në Yzberisht me sip. prej 100 m², të blerë që në vitin 1998 dhe kohë kur punonte dhe jetonte të shumtën e kohës në Kukës. Për më tepër, në vitin 2014 porositi një apartament tjetër me vëllain e subjektit në Selitë, Farkë, Tiranë. Porositja e këtij apartamenti në Selitë në vitin 2014 dhe dorëzuar në vitin 2015, përkon me kohën kur babai i subjektit të rivlerësimit shet shtëpinë në Kukës dhe transferohet në Tiranë tek apartamenti i blerë në Selitë, Farkë.
4. Nga hetimi administrativ kryesisht rezultoi se babai i subjektit të rivlerësimit ka mungesën e burimeve financiare të ligjshme në shumën -4.924.958 lekë për blerjen e apartamentit në zonën Kodra e Diellit, Tiranë, duke marrë në analizë pasuritë e krijuara dhe kryerjen e shpenzimeve, referuar të ardhurave për periudhën 1994 – 2011.
5. Subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e rezultateve të hetimit duke pretenduar se babai nuk ishte person tjetër i lidhur dhe që analiza duhet të ishte proporcionale. Komisioni vlerëson se analizimi i pasurive, të ardhurave dhe shpenzimeve të babait të subjektit, gjen mbështetje në nenet 30 dhe 45 të ligjit nr. 84/2016, të cilët përcaktojnë se Komisioni heton çdo situatë, fakt apo cilësi që është e nevojshme në funksion të verifikimit të kontrollit të pasurisë. Në këto kushte, mbetet i paprovuar pretendimi i subjektit të rivlerësimit.
6. Babai i subjekti ka blerë një apartament në Tiranë, por që nuk e ka përdorur pasi ka jetuar dhe punuar në Kukës. Përdorues direkt i këtij apartamenti është bërë subjekti i rivlerësimit

me bashkëshorten e tij nga viti 2012, vërtetuar kjo me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe deklaratës *Vetting* të vitit 2017.

7. Motra e subjektit të rivlerësimit i dhuron 16.150 euro nga të ardhurat e saj në vitin 2016 për blerjen e apartamentit të dytë në Gjermani, duke pasur parasysh se i kishte dhuruar edhe pjesën e saj takuese 1/3 në apartamentin e shitur nga babai i saj në vitin 2015 (pjesë e shumës 22.757 euro). Ndërkohë që motra e subjektit jeton në Itali dhe nga dokumentacioni i paraqitur nuk ka të ardhura në vlera të konsiderueshme për të dhënë këto shuma dhuratë subjektit të rivlerësimit.
8. Përpjekja për të fshehur shpenzimet e kryera për mobilimin e dy apartamenteve në B. Gjermani.
9. Mungesa e burimeve të ligjshme financiare për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur në shumën -570.648 lekë për vitin 2011, në shumën -700.000 lekë (ekuivalenti 5.000 euro) për vitin 2013, në shumën -672.213 lekë për vitin 2015, në shumën -4.180.341 lekë (ekuivalenti 31.150 euro) dhe -689.950 lekë për vitin 2016, në total shuma -6.813.152 lekë.

Duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga:

Pika 1, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon se: “*Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklaratimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.*”, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë pasuritë në përdorim dhe pronësi.

Pika 3, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon se: “*Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj.*”, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të përmendura në këtë vendim.

Pika 5, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon se: “*Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën*”, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi dhe në përdorim të tij dhe është përpjekur të fshehtë këto pasuri.

Subjekti gjendet në kushtet e gërmave “a”, “b” dhe “ç”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin, ka mungesë dokumentacioni justifikues për të justifikuar pasuritë dhe ka kryer fshehtë të pasurisë.

Në përfundim, Komisioni çmon se konkluzionet në lidhje me vlerësimin e pasurisë, të marra së bashku, përbëjnë shkak për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

1. Aneksi i Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016. Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresat nr. *** prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 1.3.2019, të KDZH-së dhe shkresën e përditësuar nr. *** prot., datë 13.12.2019, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 6.2.2020, të KDZH-së për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

2. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit, z. Neritan Cena: (a) ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar; (b) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej tij në deklaratën për kontrollin e figurës; (c) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

3. **Si konkluzion**, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Neritan Cena.

4. Pavarësisht raportit të dërguar nga DSIK-ja, Komisioni ka kryer hetim administrativ, prej të cilit rezulton se konstatimet e Grupit të Punës për kontrollin e figurës janë të sakta.

5. Më tej, Komisioni konstatoi se nuk ka asnjë informacion apo *indicie* që të implikojë subjektin në kryerjen e ndonjë vepre penale apo cenim të figurës, nuk ka denoncime apo të dhëna të tjera që të rezultojë se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

6. Në përfundim, nga hetimi administrativ kryesisht ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në kohën e përcaktuar nga ligji nr. 84/2016, nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe nuk ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

7. **Si konkluzion**, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Neritan Cena, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Subjekti i rivlerësimit Neritan Cena ka marrë titullin “jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 5.7.2000 dhe titullin “Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2005. Pas studimeve, në datën 3.10.2005, është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Më pas, në datën 1.4.2010, është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku vazhdon edhe aktualisht. Gjithashtu ka mbajtur edhe detyrën e anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore më 24.3.2016 deri më 12.12.2018, kur është krijuar Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka dorëzuar raportin profesional për subjektin e rivlerësimit. Nga vlerësimi i tri dokumenteve të përzgjedhura nga subjekti dhe pesë dosjeve të përzgjedhura me short, lidhur me kriteret e vlerësimit, sipas ligjit nr. 96/2016, janë vënë re këto gjetje:

Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, z. Neritan Cena, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Gjyqtari kualifikon drejt marrëdhënien juridiko-civile objekt shqyrtimi gjyqësor, i kushton rëndësinë e duhur identifikimit të kërimit të palëve, dëgjon kërkimet procedurale të tyre, shprehet në çdo rast me urdhra dhe vendime të ndërmjetme të arsyetuara. Identifikon rastet kur, për sqarimin e fakteve që kanë lidhje me mosmarrëveshjen, duhen njohuri të posaçme, duke thirrur ekspertë të fushës dhe duke parashtruar pyetje të qarta për ta. Subjekti njih parimet e përgjithshme të së drejtës dhe i zbaton ato gjatë gjykimit, por nuk i përdor shprehimisht në tekstin e vendimeve përfundimtare.

Ndër pesë dosjet e vëzhguara, janë ankimuar 3 vendime gjyqësore përfundimtare të dhëna prej tij, ndërsa ndaj 2 vendimeve nuk është ushtruar ankim dhe vendimi ka marrë formë të prerë. Lidhur me vendimet e ankimuara, Gjykata e Apelit Tiranë, në të tre rastet, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, në 2 prej tyre palët kanë paraqitur rekurs dhe çështjet janë ende në pritje për t’u gjykuar në Gjykatën e Lartë. Për sa i përket tri dokumenteve ligjore nga aktet e paraqitura, për dy prej tyre evidentohet se vendimi ka marrë formë të prerë, pra ndaj tyre nuk është ushtruar ankim, ndërsa për çështjen tjetër evidentohet se është paraqitur ankim në apel, ku është vendosur lënia në fuqi e vendimit të shkallës së parë dhe rekurs në Gjykatën e Lartë, ku është vendosur mospranimi i rekursit.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit, z. Neritan Cena, ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare plotësojnë elementet e përcaktuara nga ligji, niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Nuk është identifikuar asnjë rast nga tri dokumentet ligjore dhe pesë dosjet e vëzhguara, që të jetë cenuar nga Gjykata e Apelit ose Gjykata e Lartë për shkak të procesit të rregullt ligjor në aspektin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Në dispozitivin e vendimit, në rastet e vëzhguara, është konstatuar se disponohet për shpenzimet gjyqësore, si dhe tregohet e drejta e ankimit për palët. Janë respektuar rregullat e drejtshkrimit dhe përdorur të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në

funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Dispozitivi i vendimit është i plotë dhe i qartë, kur është rasti shoqërohet edhe me urdhrin e ekzekutimit, i cili formalisht tregon shërbimin përmbartimor, por që nuk bën ndarje midis përmbartimit privat dhe shtetëror.

Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti rivlerësimi, z. Neritan Cena, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016 ka kryer detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dhomën civile. Në formularin e vetëdeklarimit, në rubrikën e të dhënave statistikore, ka deklaruar se i janë caktuar për gjykim për vitet 2014 – 2016, në cilësinë e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjithsej 1450 çështje gjyqësore, nga të cilat 1252 çështje civile dhe 198 masa sigurimi. Për këtë periudhë ka deklaruar se ka përfunduar gjithsej 1176 çështje gjyqësore, nga të cilat 978 çështje civile dhe 198 masa sigurimi. Gjithashtu ka deklaruar se ka mbartur gjithsej 55 çështje të vitit 2016. Rendimenti i përfundimit të çështjeve si gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, bazuar në këto të dhëna është 81.1 %. Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, subjekti i rivlerësimit, ka gjykuar gjithsej 1279 çështje gjyqësore, nga të cilat 1080 çështje civile (577 civile të përgjithshme, 2 tregtare dhe 501 civile të veçanta), si dhe 199 masa sigurimi. Bazuar në germën “e”, të pikës 3, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë, që është organizuar në dhomën civile, seksioni i përgjithshëm, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 120 gjykime çështjesh civile që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje me palë kundërshtare, pra, për 3 vjet jo më pak se 360 çështje. Sipas të dhënave statistikore rezultojnë se gjyqtari Neritan Cena, për periudhën e rivlerësimit, ka gjykuar 577 çështje civile të përgjithshme me palë kundërshtare, 2 çështje tregtare. Rrjedhimisht, ngarkesa e tij sasimore ka qenë dukshëm mbi standardin minimal.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka treguar aftësi për të kryer procedurat gjyqësore duke shmangur rrethanat, të cilat nuk varen prej tij dhe që kanë efekt negativ në rezultatet e vlerësimit, sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga analizimi i dosjeve gjyqësore, përgjithësisht, nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale.

Nga analizimi i tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë dosje gjyqësore të përzgjedhura me short ka rezultuar se kohëzgjatja e gjykimeve nga subjekti i rivlerësimit ka qenë në intervale kohore nga 1 ditë deri në 1 vit e 27 ditë. Në analizimin e kohëzgjatjes së gjykimeve, Komisioni ka marrë parasysh ngarkesën e subjektit dhe kompleksitetin e çështjeve, por përsëri është konstatuar se në shumicën e rasteve nuk është respektuar afati standard i gjykimit, më konkretisht si vijon:

1) Vendimi gjyqësor nr. 12308, datë 23.12.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me paditës z. N.Y., me objekt: “konstatimi i zgjidhjes se kontratës/marrëdhënies së punës me efekt të menjëhershëm, pa shkaqe të justifikuar dhe dëmshpërblimin për zgjidhjen e saj”. Çështja është gjykuar në seancë gjyqësore publike me trup gjykues të përbërë vetëm nga subjekti i rivlerësimit. Seanca është zhvilluar në datën 23.12.2014 dhe vendimi është dhënë në datën 23.12.2014. Në përfundim është vendosur rrëzimi i kërkesëpadisë. Nga aktet evidentohet se vendimi nuk është ankimuar dhe ka marrë formë të prerë në datën 7.1.2015. Evidentohet se çështja është regjistruar në datën 20.5.2014 dhe vendimi është dhënë në datën 23.12.2014. Gjykimi ka zgjatur 7 muaj e 3 ditë, ky afat është jashtë afatit 6-mujor të caktuar nga germa “e”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit. Subjektit iu kërkuan shpjegime në lidhje me këtë vonesë. Në seancë dëgjimore, subjekti i rivlerësimit bëri një shpjegim të përgjithshëm të arsyeve se përse kishte pasur vonesa, por pa u fokusuar në rastin konkret. Trupi gjykues vlerëson se tejkalimi i afatit standard të gjykimit nuk përbën shkak autonom për shkarkimin e subjektit, por mbetet një element i cili është konsideruar nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor që i është bërë kriterit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit.

2) Çështja civile nr. *** regj., datë 5.10.2015, që i përket paditësit shoqërisë “****” sh.a., kundër të paditurit B.R., me objekt “detyrimin e të paditurit të paguajë shumën 30.470 lekë, si detyrim i papaguar nga shërbimi telefonik fiks”. Gjykata, bazuar në nenet 310/1, 510/a, 511/a e 511/1 të Kodit të Procedurës Civile ka vendosur lëshimin e urdhrin të ekzekutimit. Nuk rezulton të jetë paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit apo rekurs në Gjykatën e Lartë. Nga aktet e paraqitura nga gjykata, rezulton se gjykimi ka zgjatur gjithsej 8 muaj e 3 ditë, në intervalin kohor 6.10.2015 – 9.6.2016. Ky afat është jashtë afatit 6-mujor të caktuar nga germa “e”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit. Subjektit iu kërkuan shpjegime në lidhje me këtë vonesë. Në seancë dëgjimore, subjekti bëri një shpjegim të përgjithshëm të arsyeve se përse kishte pasur vonesa, por pa u fokusuar në rastin konkret. Trupi gjykues vlerëson se tejkalimi i afatit standard të gjykimit nuk përbën shkak autonom për shkarkimin e subjektit, por ai mbetet një element i cili është konsideruar nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor që i është bërë kriterit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit.

3) Çështja civile nr. *** regj., datë 17.2.2015, që i përket paditësit K.S., kundër të paditurit ***, me objekt “pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, që i përket faturave të energjisë elektrike për periudhën dhjetor 2014 - janar 2015. Zgjidhje e pasojave ku *** të zbresë të gjithë energjinë e mbifaturuar të pakonsumuar nga paditësi sipas faturave për të cilën kundërshtohet titulli ekzekutiv”. Nga hetimi rezultoi se gjykimi ka zgjatur gjithsej 6 muaj e 17 ditë, në intervalin kohor 18.3.2015 – 5.10.2016. Ky afat është jashtë afatit 6-mujor të caktuar nga germa “e”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit. Gjithashtu rezultoi se dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsyetuar, është dorëzuar në datën 23.10.2015 – pas 18 ditëve nga shpallja e vendimit, jashtë afatit 10-ditor të përcaktuar nga neni 308/2 i Kodit të Procedurës Civile. Subjektit iu kërkuan shpjegime në lidhje me këtë vonesë. Në seancë dëgjimore, subjekti bëri një shpjegim të përgjithshëm të arsyeve se përse kishte pasur vonesa, por pa u fokusuar në rastin konkret. Trupi gjykues vlerëson se tejkalimi i afatit standard të gjykimit nuk përbën shkak autonom për shkarkimin e subjektit, por mbetet një element i cili

është konsideruar nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor që i është bërë kriterit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit.

4) Çështja civile nr. *** regj., datë 6.6.2013, që i përket paditësit Xh.S., kundër të paditurit shoqëria “***”, me objekt “dëmshpërblim nga marrëdhëniet e punës”. Nga hetimi rezultoi se gjykimi ka zgjatur gjithsej 11 muaj e 10 ditë, në intervalin kohor 7.6.2013 – 27.5.2014. Ky afat është jashtë afatit 6-mujor të caktuar nga germa “e”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit. Subjektit iu kërkuan shpjegime në lidhje me këtë vonesë. Në seancë dëgjimore, subjekti bëri një shpjegim të përgjithshëm të arsyeve se përse kishte pasur vonesa, por pa u fokusuar në rastin konkret. Trupi gjykues vlerëson se tejkalimi i afatit standard të gjykimit nuk përbën shkak autonom për shkarkimin e subjektit, por mbetet një element i cili është konsideruar nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor që i është bërë kriterit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit.

5) Çështja civile nr. *** regj., datë 17.6.2013, që i përket paditësit B.H., kundër të paditurit zyra përmbarimore “***”, person i tretë “***” sh.a., me objekt: “deklarimin e pavlefshmërisë pjesërisht të titullit ekzekutiv nr. *** akti, datë 9.11.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kundërshtimin e veprimeve të përmbarimit dhe pezullimin e ekzekutimit të veprimeve përmbarimore”. Nga hetimi rezultoi se gjykimi ka zgjatur gjithsej 1 vit e 27 ditë, jashtë afatit 6-mujor të caktuar nga germa “e”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit. Seanca e shtyrë për konkluzionet përfundimtare të palëve është caktuar jashtë afatit 5-ditor parashikuar nga neni 302 i Kodit të Procedurës Civile dhe seanca për shpalljen e arsytuar të vendimit e caktuar jashtë afatit 5-ditor, parashikuar nga neni 308/2 i Kodit të Procedurës Civile. Subjektit iu kërkuan shpjegime në lidhje me këtë vonesë. Në seancë dëgjimore, subjekti bëri një shpjegim të përgjithshëm të arsyeve se përse kishte pasur vonesa, por pa u fokusuar në rastin konkret. Trupi gjykues vlerëson se tejkalimi i afatit standard të gjykimit nuk përbën shkak autonom për shkarkimin e subjektit, por mbetet një element i cili është konsideruar nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor që i është bërë kriterit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit.

6) Mosrespektimi i këtyre afateve është bërë objekt ankesash, nga të dhënat arkivore të KLD-së ka rezultuar se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 - 8 tetor 2016”, janë paraqitur 6 ankesa (1 në vitin 2013, 1 ankesë në vitin 2014, 2 në vitin 2015 dhe 2 ankesa në vitin 2016) në Inspektoratin e KLD-së, nga të cilat: (i) 3 ankesa (1 e vitit 2014, 1 e vitit 2015 dhe 1 e vitit 2016) janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, ndër të cilat 1 ankesë me arsyetimin se nuk ka fakte apo rrethana për verifikim të ankesave dhe 2 ankesa arkivuar për shkak se zgjidhen me anë të apelimit gjyqësor; (ii) 3 ankesa janë verifikuar dhe rezultatet janë: 1 ankesë e vitit 2013, verifikuar për zvarritje të gjykimit nga gjyqtari dhe është vendosur evidentimi për efekt vlerësimi etik dhe profesional të gjyqtarit, 1 ankesë e vitit 2015, verifikuar për zvarritje të gjykimit nga ana e gjyqtarit dhe është vendosur evidentimi për efekt vlerësimi etik dhe profesional të gjyqtarit, 1 ankesë e vitit 2016, verifikuar për mospërputhje në vendimin e dhënë me arsyetimin e vendimit të zbardhur është vendosur mbajtja në vijim deri në përfundim nga Gjykata e Lartë.

Nga regjistri statistikor me të dhëna mbi procedimet disiplinore rezulton që Ministria e Drejtësisë ka sjellë pranë KLD-së një kërkesë për procedim disiplinor me nr. *** prot., datë

21.10.2014¹²⁹ "vërejtje me paralajmërim". Kërkesa është shqyrtuar në mbledhjen e ish-Këshillit në datën 4.2.2015, ku dhe është rrëzuar bashkë me propozimin e dytë "vërejtje".

Hetimi i Komisionit

Referuar në parashikimet e pikës 1, të nenit 42, të ligjit nr. 84/2016, për të kryer një vlerësim të plotë dhe të gjithanshëm, Komisioni administroi dhe analizoi të gjitha burimet e parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve. Komisioni kërkoi informacion pranë Ministrisë së Drejtësisë¹³⁰ dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor¹³¹ në lidhje me ankesat e paraqitura ndaj subjektit të rivlerësimit dhe masat disiplinore të marra ndaj tij, nga periudha 2006 e deri më sot.

➤ Pas administrimit të shkresës nr. *** prot., datë 23.6.2020, të Ministrisë së Drejtësisë, Komisioni vëren se ndaj subjektit Neritan Cena janë depozituar 7 ankesa¹³², dhe se Ministria e Drejtësisë me anë të shkresës nr. *** prot., datë 21.10.2014, ka bërë kërkesë për procedim disiplinor të gjyqtarit Neritan Cena, lidhur me veprimtarinë e subjektit të rivlerësimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar raportit të paraqitur, Komisioni konstatoi se:

1) Për sa i përket çështjes civile me palë paditëse shoqërinë "****" sh.p.k., të paditur Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me objekt "shfuqizim njoftim vlerësimi tatimor", me vendimin nr. ***, datë 15.4.2013, është vendosur pranimi i padisë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim ZVAShtetit Tiranë më 2.5.2013. Nga verifikimi i regjistrit themeltar civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se ky vendim është dorëzuar në sekretari më 2.7.2013, për një afat kohor prej 2 muaj e 17 ditë. Nga përmbajtja e procesverbaleve të seancave gjyqësore rezultoi se seanca e parafundit gjyqësore është zhvilluar më 9.4.2013, në përfundim të së cilës gjykata ka vendosur të shtyjë shpalljen e vendimit përfundimtar në datën 15.4.2013, datë në të cilën gjykata ka shpallur dispozitivin e vendimit, ndërkohë që dosja me vendimin e arsyetuar është dorëzuar në sekretari në datën 2.7.2013. Në bazë të nenit 308 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata kur shtyn shpalljen e vendimit ka detyrimin ligjor të respektojë afatin 5-ditor të shtyrjes, si dhe detyrimin e zbardhjes së vendimit brenda 10 ditëve, detyrime të cilat nuk janë zbatuar nga subjekti. Më tej, Komisioni konstatoi se gjykimi ka zgjatur rreth 1 vit e 10 muaj, në intervalin kohor 8.6.2011 – 14.4.2013. Ky afat është jashtë afatit 6-mujor të caktuar nga germa "e", e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

2) Çështja civile me palë paditëse bashkimi i shoqërive "****" sh.p.k., të paditur Komisioni i Prokurorimeve Publike, Posta Shqiptare, objekti i padisë "shpërblim dëmi". Me shortin e

¹²⁹ Protokolluar me nr. *** prot., datë 21.10.2014, në KLD.

¹³⁰ Shkresa nr. *** prot., datë 5.6.2020.

¹³¹ Shkresa nr. *** prot., datë 5.6.2020.

¹³² 1. Ankesa e shtetasës A.Sh./zyrë avokatie ADCA e vitit 2017; 2. ankesa e shtetasit B.Gj. e vitit 2017 (dy anesa); 3. ankesa e shtetasës V.H. e vitit 2017; 4. ankesa e shtetasit G.L. e vitit 2018; 7. ankesa e shtetasit M.I. e vitit 2018; 5. ankesa e shtetasës D.K. e vitit 2019. Komisioni vëren se shtetasit B.Gj., M.I., D.K. dhe G.L. kanë paraqitur denoncime edhe pranë Komisionit. Në vlerësim të fakteve të paraqitura, duket se nuk ka *indicie* për hetime të mëtejshme ndaj subjektit të rivlerësimit.

datës 6.9.2010 kjo çështje i ka rënë për gjykim subjektit, me vendimin nr. ***, datë 16.4.2013, është vendosur pranimi i padisë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim pala e paditur Posta Shqiptare në datën 29.4.2013, Komisioni i Prokurimit Publik në datën 24.7.2013 dhe ZVA-Shtetit Tiranë më 30.4.2013. Nga verifikimi i regjistrimit rezultoi se ky vendim është dorëzuar në sekretari në datën 1.7.2013, pra për një afat kohor prej 2 muaj e 15 ditë. Më tej, Komisioni konstatoi se gjykimi ka zgjatur rreth 2 vjet e 7 muaj, në intervalin kohor 2.9.2010 – 16.4.2013. Ky afat është jashtë afatit 6-mujor të caktuar nga germa “e”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

3) Çështja civile me palë paditëse shoqëria “****” sh.p.k., të paditur Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, objekti i padisë “anulim akti administrativ, pezullimi i zbatimit të aktit administrativ”. Me shortin e datës 26.10.2012, kjo çështje i ka rënë për gjykim subjektit dhe me vendimin nr. ***, datë 29.4.2013 është vendosur pranimi i padisë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave Tiranë më 16.8.2013. Nga verifikimi i regjistrimit rezultoi se ky vendim është dorëzuar në sekretari më 6.8.2013, pra për një afat kohor prej 3 muaj e 7 ditë.

4) Çështja civile me palë paditëse S.K., i paditur Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, objekti i padisë “ndryshim vendimi të caktimit të pensionit të parakohshëm”. Detyrimin e palës së paditur të paguajë diferencat e krijuara. Kërkesëpadia është depozituar më 13.9.2012 dhe me shortin e po kësaj date i ka rënë për gjykim subjektit. Me vendimin nr. ***, datë 29.4.2013, është vendosur pranimi i pjesës së padisë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim paditësi S.K. më 10.5.2013. Nga verifikimi i regjistrimit rezultoi se ky vendim është dorëzuar në sekretari më 29.7.2013, pra për një afat kohor prej 3 muaj. Më tej, Komisioni konstatoi se gjykimi ka zgjatur rreth 7 muaj, në intervalin kohor 13.9.2012 – 9.4.2013. Ky afat është jashtë afatit 6-mujor të caktuar nga germa “e”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

5) Çështja civile me palë paditëse M.R., të paditur Arkivi Qëndror Shtetëror Tiranë, Arkivi i Ministrisë së Brendshme, Tiranë, objekti i padisë “pavërtetësi dokumenti”. Me shortin datë 5.2.2013, kjo çështje i ka rënë për gjykim subjektit dhe me vendimin nr. ***, datë 30.4.2013, është vendosur pranimi i padisë. Ky vendim ka marrë formë të prerë pa u ankimuar më 2.7.2013. Nga verifikimi i regjistrimit rezultoi se ky vendim është dorëzuar në sekretari në datën 11.6.2013, pra për një afat kohor prej 1 muaj e 11 ditë.

6) Çështja civile me palë paditëse R.A., të paditur DRS Shoqërore Tiranë, ISSh-ja Tiranë, objekti i padisë “detyrimi i palës së paditur për rrillogaritje të pensionit të parakohshëm”. Pagimi i diferencave të papaguara. Me shortin e datës 23.4.2012, kjo çështje i ka kaluar për gjykim subjektit dhe me vendimin nr. ***, datë 6.5.2013, është vendosur pranimi pjesërisht i padisë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim pala e paditur DRSSH në datën 17.5.2013 dhe paditësi R.A. më 22.8.2013. Nga verifikimi i regjistrimit rezultoi se ky vendim është dorëzuar në sekretari në datën 5.8.2013, pra për një afat kohor prej 2 muaj e 29 ditë. Më tej, Komisioni konstatoi se gjykimi ka zgjatur gjithsej 1 vit e 13 ditë, në intervalin kohor 23.4.2012 – 6.5.2013. Ky afat është jashtë afatit 6-mujor të caktuar nga germa “e”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

7) Çështja civile me palë paditëse Sh.M., e paditur AKK Pronave, objekti i padisë: “shfuqizim vendimi”. Me shortin datë 17.1.2011, kjo çështje i ka kaluar për gjykim subjektit dhe me vendimin nr. ***, datë 13.5.2013, është vendosur pranimi i padisë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim pala e paditur në datën 20.5.2013, si dhe ZVA Shtetit më 7.8.2013. Nga verifikimi i regjistrit rezultoi se ky vendim është dorëzuar në sekretari më 23.7.2013, pra për një afat kohor prej 2 muaj e 10 ditë. Më tej, Komisioni konstatoi se gjykimi ka zgjatur rreth 2 vjet e 4 muaj, në intervalin kohor 17.1.2011 – 13.5.2013. Ky afat është jashtë afatit 6-mujor të caktuar nga germa “e”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit. Vlen të theksohet që objekti ka qenë çështje pronësie.

8) Çështja civile me palë paditëse shoqërinë ” ****” sh.a., pala e paditur shoqëria “****”, KRT Komuna Kashar, person i tretë Bashkia Tiranë, objekti i padisë “anulim vendimi, shpërblim dëmi”. Kërkesëpadia është paraqitur në datën 4.7.2011 dhe i ka rënë fillimisht për gjykim gjyqtarit A.G. dhe më pas i ka kaluar subjektit të rivlerësimit në datën 9.5.2011. Me vendimin nr. ***, datë 14.5.2013, është vendosur miratimi i pajtimit të arritur ndërmjet palës paditëse dhe palës së paditur. Nuk rezulton të ketë ankim. Në seancën e fundit gjyqësore gjykata është njohur me marrëveshjen e arritur midis palëve dhe ka vendosur miratimin e saj. Nga verifikimi i regjistrit rezultoi se ky vendim është dorëzuar në sekretari në datën 5.7.2013, pra për një afat kohor prej 1 muaj e 21 ditë. Më tej, Komisioni konstatoi se gjykimi ka zgjatur rreth 2 vjet, në intervalin kohor 9.5.2011 – 14.5.2013. Ky afat është jashtë afatit 6-mujor të caktuar nga germa “e”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

9) Çështja civile me palë paditëse Z.L., i paditur AKKP Tiranë, objekti i padisë “ndryshim vendimi, detyrimi për njohje, kthim dhe kompensim”. Me shortin e datës 14.4.2013, çështja i ka kaluar për gjykim subjektit. Me vendimin nr. ***, datë 21.5.2013, është vendosur pranimi i padisë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim ZVA Shtetit më 22.7.2013 dhe pala e paditur AKK Pronave në datën 28.8.2013. Nga verifikimi i regjistrit rezultoi se ky vendim është dorëzuar në sekretari në datën 5.8.2013, pra për një afat kohor prej 2 muaj e 14 ditë.

10) Çështja civile me palë i paditur Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj, Drejtoria e Përgjithshme dhe ajo e Apelimit Tatimor Tiranë, objekti “kundërshtim njoftim vlerësimi për detyrimet dhe shfuqizim vendimi”. Më shortin e datës 17.4.2012, kjo çështje i ka kaluar për gjykim subjektit. Me vendimin nr. ***, datë 22.5.2013 është vendosur pranimi i padisë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim pala e paditur në datën 23.5.2013. Nga verifikimi i regjistrit rezultoi se ky vendim është dorëzuar në sekretari në datën 9.8.2013, pra për një afat kohor prej 2 muaj e 17 ditë. Më tej, Komisioni konstatoi se gjykimi ka zgjatur rreth 1 vit e 1 muaj, në intervalin kohor 17.4.2012 – 22.5.2013. Ky afat është jashtë afatit 6-mujor të caktuar nga germa “e”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

11) Çështja civile me palë paditëse A.A., i paditur Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Bashkia Tiranë, objekti “shfuqizim vendimi”. Me shortin datë 10.10.2012 çështja i ka kaluar për gjykim subjektit. Me vendimin nr. ***, datë 17.5.2013, është vendosur pranimi i padisë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim pala e paditur INUK në datën 31.5.2013. Nga verifikimi i regjistrit rezultoi se ky vendim është dorëzuar në sekretari në datën 23.7.2013, pra për një afat kohor prej 2 muaj e 6 ditë. Më tej, Komisioni konstatoi se gjykimi ka zgjatur rreth

7 muaj e 7 ditë, në intervalin kohor 10.10.2012 – 17.5.2013. Ky afat është jashtë afatit 6-mujor të caktuar nga germa “e”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

12) Gjatë hetimit të Komisionit rezultoi se subjektit të rivlerësimit i është tërhequr dy herë vëmendje me shkrim nga zëvendëskryetari i KLD-së dhe, pavarësisht kësaj, gjyqtari nuk ka marrë asnjë masë për mospërsëritje të shkeljeve të konstatuara për të cilat është paralajmëruar paraprakisht. Më konkretisht: (a) shqyrtimi i ankesës së shtetasit S.A. për mosrespektim formal të ligjit në shqyrtimin e çështjes civile me palë paditëse I.A., i paditur ZQRPP-ja Tiranë. Në përfundim të verifikimit, ankesa ka rezultuar e drejtë, është cenuar e drejta e ankimit në afatin ligjor, parashikuar nga neni 43 i Kushtetutës, pasi kopja e fashikullit dhe vendimi i ndërmjetëm i gjyqtarit është nisur në Gjykatën e Apelit pas 9 muajsh. Për këtë arsye, me shkresën nr. *** prot., datë 25.3.2013, në zbatim të nenit 34/2 të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të KLD-së”, subjektit të rivlerësimit, z. Neritan Cena, i është tërhequr vëmendja me shkrim; (b) shqyrtimi i ankesës lidhur me vendimet gjyqësore nr. ***, datë 5.3.2012, me palë M.T., etj., kundër AKKPronave Tiranë dhe vendimi nr. ***, datë 30.4.2012 me palë paditëse shoqërinë “****” sh.p.k., palë e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj. Të dyja vendimet rezultojnë të jenë dorëzuar në sekretari tej afatit 1-mujor (6 muaj e 20 ditë dhe 5 muaj e 2 ditë). Për këtë arsye, me shkresën nr. *** prot., datë 18.10.2013, në zbatim të nenit 34/2 të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të KLD-së”, subjektit të rivlerësimit, z. Neritan Cena, përsëri i është tërhequr vëmendja me shkrim.

Analiza e Komisionit

Referuar vendimeve të mësipërme, rezulton se: **1.** Evidentohen 2 vendime përfundimtare: nr. ***, datë 30.4.2013, i cili ka zgjidhur çështjen në themel dhe nuk është ankimuar. Arsyetimi dhe dorëzimi me vonesë¹³³ ka sjellë ekzekutimin me vonesë të tij, në favor të palës paditëse.

Vendimi nr. ***, datë 14.5.2013, i cili ka miratuar marrëveshjen e palëve për zgjidhjen me pajtim, gjithashtu i paankimuar. **2.** Evidentohen 9 vendime përfundimtare¹³⁴ me palë kundërshtarë të cilat kanë zgjidhur çështjen në themel dhe kundër të cilave është paraqitur ankim. Këto vendime janë dorëzuar me vonesë në intervalet kohore të analizuara më lart. Për secilin prej vendimeve të mësipërme, rezulton se gjykata për shkak të kompleksitetit të çështjes ka shtyrë shpalljen e tyre në një seancë tjetër, seancë në të cilën rezulton të jetë shpallur vetëm dispozitivi i vendimit, i pashoqëruar me arsyetimin e tij, në shkelje të detyrimit ligjor të parashikuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon se: *‘Në çështje të ndërlikuara, gjykata mund të shpallë vetëm dispozitivin e vendimit, duke e dorëzuar atë të arsyetuar në sekretari jo më vonë se dhjetë ditë ose të shtyjë shpalljen e arsyetuar të vendimit deri në 5 ditë’*. Konstatohet gjithashtu se në 8 raste nuk rezulton të jetë respektuar as afati deri në 5 ditë i shtyrjes së seancës për shpalljen e arsyetuar të vendimit. **3.** Jo vetëm kaq, por mosdorëzimi i vendimit të arsyetuar nga subjekti i rivlerësimit ka kapërcyer edhe afatin ligjor të ankimit të parashikuar në paragrafin e parë, të nenit 443, të Kodit të Procedurës Civile.

¹³³ Dorëzuar i arsyetuar në sekretari për një periudhë prej 1 muaj e 11 ditë.

¹³⁴ Vendimet nr. ***, datë 15.4.2013; nr. ***, datë 16.4.2013; nr. ***, datë 29.4.2013; nr. ***, datë 29.4.2013; nr. ***, datë 6.5.2013; nr. ***, datë 13.5.2013; nr. ***, datë 21.5.2013; nr. ***, datë 22.5.2013 dhe nr. ***, datë 17.5.2013.

Konstatohet se në 3 raste palët kanë paraqitur ankim, pa pasur një vendim të arsyetuar në kohën e duhur, çfarë i ka kushtëzuar ato në kohë për përgatitjen e ankimit duke i sjellë pengesa për ushtrimin efektivisht të së drejtës së ankimit në një gjykatë me të lartë për sa kohë që nuk kanë akses në aryetimin e vendimit të gjykatës dhe, për pasojë, kufizimin e mundësisë për të ngritur argumente kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Vetëm në një rast ankimi është paraqitur pas arsyetimit të vendimit.

➤ Komisioni gjithashtu analizoi ankesat e paraqitura në Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë¹³⁵, nga ku rezultoi se ndaj subjektit Neritan Cena janë depozituar 24 ankesa¹³⁶ dhe u konstatuan parregullsi në proceset gjyqësore, si vijon:

1) Shtetasi K.Dh. ka paraqitur 3 ankesa në KLD, ku ndër të tjera ankohet për zvarritje të procesit gjyqësor. Evidentohet se gjykimi ka zgjatur rreth 10 muaj, pra jashtë afatit 6-mujor të caktuar nga germa “e”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

2) Lidhur me ankesën e shtetasit P.B., Komisioni konstaton se gjykimi ka zgjatur rreth 19 muaj (duke përfshirë këtu edhe dy periudhat e lejes së zakonshme të viteve 2006 dhe 2007), pra, jashtë afatit 6-mujor të caktuar nga germa “e”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit. Duke analizuar shkaqet e shtyrjes së seancave gjyqësore, konkludohet se pjesa më e madhe e tyre janë shtyrë me kërkesë të palëve, megjithatë me një organizim më të mirë të punës mund të ishte evituar moszhvillimi i ndonjë seance gjyqësore.

3) Lidhur me ankesën e shtetasit V.H., evidentohet se nga dita e regjistrimit të çështjes deri në përfundim të saj kanë kaluar 3 vjet e 6 muaj. Për gjykimin e kësaj çështjeje janë zhvilluar 5 seanca veprimesh përgatitore. Nga subjekti janë konstatuar të meta të padisë pas regjistrimit të çështjes, ndërkohë që në bazë të nenit 154/a të Kodit të Procedurës Civile duhet që ky fakt të ishte konstatuar që në momentin e regjistrimit të çështjes (objekti “konstatimi i pavlefshmërisë absolute të kontratës...”). Po kështu janë kryer 14 seanca gjyqësore deri në vendosjen e pezullimit të çështjes. Zvarritja ka ardhur dhe për shkak të pezullimit të çështjes, e cila në total ka zgjatur rreth 2 vjet, megjithatë që nga momenti i dorëzimit të padisë deri në momentin e vendosjes së pezullimit ka kaluar një periudhë kohe, rreth 11 muaj, kohë e mjaftueshme për përfundimin e gjykimit. Bazuar në pikën 2, të nenit 34 të “Rregullores për Inspektoratin e KLD-së”, lidhur me këtë ankesë është sugjeruar t’i tërhiqet vëmendja subjektit dhe t’i bëhen rekomandime Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me qëllim që raste të tilla të mos përsëriten në të ardhmen.

4) Lidhur me ankesën e Kishës Ortodokse për zvarritje të procesit gjyqësor me objekt “kundërshtim i titullit ekzekutiv”, evidentohet se deri në ditën e paraqitjes së ankesës gjykimi ka zgjatur 5 muaj e 18 ditë, jashtë afatit 5-ditor të vendimit nr. ***, datë 15.9.2006, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”. Bazuar në pikën 2, të nenit 34 të “Rregullores për Inspektoratin e KLD-së”, lidhur me këtë ankesë është sugjeruar t’i tërhiqet vëmendja subjektit të rivlerësimit.

¹³⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 14.8.2020, e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

¹³⁶ Shtetasit M.I. dhe A.Sh./zyrë avokatie ADCA D.K. kanë paraqitur denoncime edhe në Komision.

5) Lidhur me ankesat për mosdorëzimin në kohë të vendimeve civile nr. ***, datë 2.3.2012 (dorëzuar pas një periudhe kohe 6 muaj e 20 ditë) dhe vendimit nr. ***, datë 30.4.2012 (dorëzuar pas një periudhe kohe 5 muaj e 2 ditë). Me anë të shkresës nr. *** prot., datë 18.10.2013, subjektit të rivlerësimit i është tërhequr vëmendje për herë të dytë lidhur me rëndësinë që duhet t'i kushtojë procesit të rregullt ligjor në drejtim të kohëzgjatjes.

6) Lidhur me ankesën e shtetasit I.F., evidentohet se gjykimi është regjistruar në datën 26.4.2010 dhe nuk ka përfunduar deri në ditën e verifikimit të ankesës për një periudhë kohore prej 3 vjet e 2 muaj e 13 ditë (çështja me objekt “shfuqizimin e vendimeve të AKKPronave”), ndërkohë që bazuar në germën “c”, të nenit 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit, gjykimet e mosmarrëveshjeve civile në gjykatën e shkallës së parë nuk mund të zgjasin më tej se 1 muaj.

Analiza e Komisionit

Referuar raportit të KLD-së, zvarritja e gjykimit ka ardhur si rezultat i organizimit të dobët të punës dhe mospërdorimit të mjeteve të duhura procedurale për të minimizuar rastet e shtyrjes së seancave gjyqësore, duke sjellë si pasojë shkelje të standardit kushtetues të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për realizimin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm kohor. Në këto rrethana, bazuar në pikën 2, të nenit 34, të Rregullores “Për Organizimin dhe Funksonimin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, subjektit të rivlerësimit i është tërhequr vëmendje me shkrim mbi këtë shkelje. Ky rezultat të jetë akti i tretë i tërheqjes së vëmendjes ndaj subjektit Neritan Cena.

Nga analiza e veprimtarive profesionale të subjektit të rivlerësimit janë konstatuar vonesa në zbardhjen e vendimeve, zvarritje/shtyrje të procesve dhe seanca joproduktive. Në këto kushte, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka respektuar afatet ligjore, plotësimin e standardeve minimale kohore dhe kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje pasi: (i) *bazuar në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata ka detyrimin ligjor të dorëzojë vendimin e arsyetuar brenda 10 ditëve nga shpallja, si dhe të respektojë afatin 5-ditor kur shtyn shpalljen e vendimit, detyrime të cilat nuk janë zbatuar nga ana e subjektit;* (ii) *gjykimet kanë zgjatur jashtë afatit 6-mujor të caktuar nga germa “e”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.*

➤ Për sa më sipër, duke qenë se Komisioni konstatoi shkelje në mënyrë të përsëritur, iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku kërkoi informacion lidhur me: (1) listën e të gjitha vendimeve gjyqësore të dorëzuara në tejkalim të afateve të parashikuara nga legjislacioni procedural civil nga subjekti i rivlerësimit, z. Neritan Cena, për të gjithë periudhën që ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në këtë gjykatë; (2) ngarkesën në punë të gjyqtarit Neritan Cena për të gjithë periudhën që ka ushtruar detyrën e gjyqtarit. Pas administrimit të shkresës nr. *** prot., datë 13.7.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë evidentohet, si vijon:

1. Për vitin 2010 ngarkesa e subjektit ka qenë 276 çështje (civile themeli 168, kërkesa civile 6, urdhra ekzekutimi 73, masa sigurimi 29) dhe janë konstatuar 89 vendime gjyqësore të dorëzuara në tejkalim të afateve të parashikuara nga legjislacioni procedural civil, që përbëjnë rreth 32 % vonesa në zbardhjen e vendimeve.

2. Për vitin 2011 ngarkesa e subjektit ka qenë 471 çështje (civile themeli 264, kërkesa civile 14, urdhra ekzekutimi 145, leje votimi 4, penale themeli 2, kërkesa penale 7, masa sigurimi 35) dhe janë konstatuar 185 vendime gjyqësore të dorëzuara në tejkalim të afateve të parashikuara nga legjislacioni procedural civil, që përbëjnë rreth 39 % vonesa në zbardhjen e vendimeve.
3. Për vitin 2012 ngarkesa e subjektit ka qenë 593 çështje (civile themeli 250, kërkesa civile 16, urdhra ekzekutimi 275, kërkesa penale 3, masa sigurimi 49) dhe janë konstatuar 115 vendime gjyqësore të dorëzuara në tejkalim të afateve të parashikuara nga legjislacioni procedural civil, që përbëjnë rreth 19 % vonesa në zbardhjen e vendimeve.
4. Për vitin 2013 ngarkesa e subjektit ka qenë 509 çështje (civile themeli 273, kërkesa civile 21, urdhra ekzekutimi 161, leje votimi 6, penale themeli 2, kërkesa penale 2, masa sigurimi 44) dhe janë konstatuar 120 vendime gjyqësore të dorëzuara në tejkalim të afateve të parashikuara nga legjislacioni procedural civil, që përbëjnë rreth 23 % vonesa në zbardhjen e vendimeve.
5. Për vitin 2014 ngarkesa e subjektit ka qenë 509 çështje (civile themeli 224, kërkesa civile 21, urdhra ekzekutimi 147, masa sigurimi 85) dhe janë konstatuar 22 vendime gjyqësore të dorëzuara në tejkalim të afateve të parashikuara nga legjislacioni procedural civil, që përbëjnë rreth 4 % vonesa në zbardhjen e vendimeve.
6. Për vitin 2015 ngarkesa e subjektit ka qenë 468 çështje (civile themeli 156, kërkesa civile 20, urdhra ekzekutimi 206, masa sigurimi 86) dhe janë konstatuar 156 vendime gjyqësore të dorëzuara në tejkalim të afateve të parashikuara nga legjislacioni procedural civil, që përbëjnë rreth 33 % vonesa në zbardhjen e vendimeve.
7. Për vitin 2016 ngarkesa e subjektit ka qenë 231 çështje (civile themeli 138, kërkesa civile 13, urdhra ekzekutimi 53, masa sigurimi 27) dhe janë konstatuar 37 vendime gjyqësore të dorëzuara në tejkalim të afateve të parashikuara nga legjislacioni procedural civil, që përbëjnë rreth 16 % vonesa në zbardhjen e vendimeve.
8. Për vitin 2017 ngarkesa e subjektit ka qenë 231 çështje (civile themeli 142, kërkesa civile 5, urdhra ekzekutimi 17) dhe janë konstatuar 50 vendime gjyqësore të dorëzuara në tejkalim të afateve të parashikuara nga legjislacioni procedural civil, që përbëjnë rreth 22 % vonesa në zbardhjen e vendimeve.
9. Për vitin 2018 ngarkesa e subjektit ka qenë 231 çështje (civile themeli 154, kërkesa civile 9, urdhra ekzekutimi 13) dhe janë konstatuar 101 vendime gjyqësore të dorëzuara në tejkalim të afateve të parashikuara nga legjislacioni procedural civil, që përbëjnë rreth 44 % vonesa në zbardhjen e vendimeve.
10. Për vitin 2019 ngarkesa e subjektit ka qenë 294 çështje (civile themeli 113, kërkesa civile 23, urdhra ekzekutimi 43, OJF 112, leje votimi 3) dhe janë konstatuar 113 vendime gjyqësore të dorëzuara në tejkalim të afateve të parashikuara nga legjislacioni procedural civil, që përbëjnë rreth 38 % vonesa në zbardhjen e vendimeve.

11. Për vitin 2020, deri në datën 27.2.2020, ngarkesa e subjektit ka qenë 175 çështje (civile themeli 45, kërkesa civile 5, urdhra ekzekutimi 89, OJF 36) dhe janë konstatuar 22 vendime gjyqësore të dorëzuara në tejkalim të afateve të parashikuara nga legjislacioni procedural civil, që përbëjnë rreth 13 % vonesa në zbardhjen e vendimeve.

Sa më sipër, Komisioni vëren se dorëzimi i vendimeve gjyqësore nga subjekti është në tejkalim të afateve të parashikuara nga legjislacioni procedural civil, gjithashtu në disa prej çështjeve të gjykuara nga subjekti vërehen zgjatje të afateve gjyqësore tej normave të parashikuara nga ligji.

Lidhur me konstatimet e Komisionit gjatë hetimit të thelluar, subjekti i rivlerësimit dha këto shpjegime në seancë dëgjimore: *“Në referencë të përfundimeve të arritura nga ana e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimet nr. ***, datë 12.12.2013 (rasti T. kundër Këshillit të Lartë të Drejtësisë) dhe nr. ***, datë 13.10.2014 (rasti Ç. kundër Këshillit të Lartë të Drejtësisë), që mosdorëzimi në kohë i dosjeve të konsiderohet shkelje duhet të ketë një mungesë kujdesi, neglizhence, operativiteti të tilla që kalojnë kufirin e të arsyeshmes dhe që një sjellje e tillë nuk mund të justifikohet duke çuar në cenimin e prestigjit të gjyqtarit dhe humbjen e besimit ndaj tij. Në rastet kur merret në shqyrtim veprimtaria e një gjyqtari dhe, për më tepër, kur ai ngarkohet me përgjegjësi disiplinore, në vendim duhet domosdoshmërisht të argumentohen dhe të arsyetohen jo vetëm faktet dhe provat që mbështesin atë e që përbëjnë shkeljet, por duhet të argumentohen dhe të pasqyrohen edhe pasojat konkrete për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim, si dhe cenimin konkret të imazhit të gjyqtarit që përbën cenim të imazhit të drejtësisë”.*

Subjekti deklaroi se përqindja e dosjeve të dorëzuara me vonesë në raport me ato jo të dorëzuara në vonesë rezulton që të jetë e ulët. Kjo vonesë ka ardhur si rezultat i ngarkesës së jashtëzakonshme. Nga Komisioni nuk është marrë në konsideratë mungesa e kohës fizike e nevojshme për arsyetimin e vendimeve, kompleksiteti i çështjeve, cilësia e vendimeve, vonesat administrative, nuk rezulton që të jetë përcaktuar nëse ka ardhur apo jo ndonjë pasojë konkrete nga vonesat e shkaktuara, nuk rezulton të jetë analizuar nëse fenomeni i vonesave është një fenomen individual apo kolektiv. Në përfundim, subjekti shpjegoi se në kushtet e një ngarkese të jashtëzakonshme në punë, është e pamundur të mos çetohet ose në kohë, ose në sasi ose në cilësi. Ai ka zgjedhur të çetohet në kohë për shkak se cilësia e një vendimmarrjeje, si dhe sasia e dosjeve të mbyllura është me e rëndësishme se koha.

Analiza ligjore e Komisionit

Shkeljet e konstatuara konsistojnë në mosrespektim në mënyrë të përsëritur të afateve të gjykimit dhe se zvarritja e gjykimeve nga subjekti i rivlerësimit ka ardhur si rezultat i organizimit të dobët të punës nga ana e tij dhe mospërdorimi i mjeteve të duhura procedurale për të minimizuar rastet e shtyrjes së seancave gjyqësore, duke sjellë si pasojë shkelje të standardit kushtetues të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për realizimin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Komisioni vlerëson se mosarsyetimi dhe dorëzimi i dosjes është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e subjektit të rivlerësimit dhe lidhet me efektivitetin e ankimit, shkaqet e ankimit, shtyrjen e

afatit të gjykimit të çështjes nga gjykata e apelit, si dhe ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në rregullshmërinë e procesit gjyqësor¹³⁷. Arsyetimi në kohë i vendimit nga gjyqtari është pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor dhe sidomos i parimit kushtetues të “gjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm kohor”. Mungesa e arsyesimit dhe dorëzimit të vendimit brenda afatit kohor të përcaktuar në Kodin e Procedurës Civile pengon palët të gëzojnë ushtrimin efektiv të së drejtës së ankimit, si pjesë e procesit të rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Për pasojë, mosdorëzimi i vendimeve të arsyetuara nga subjekti i rivlerësimit ka kapërcyer afatet ligjore të ankimit të parashikuar në paragrafin e parë, të nenit 443, të Kodit të Procedurës Civile. Këto vonesa kushtëzojnë palët në përgatitjen e ankimit duke sjellë pengesa për ushtrimin efektivisht të së drejtës së ankimit në një gjykatë me të lartë për sa kohë që nuk kanë akses në arsyetimin e vendimit të gjykatës dhe, për pasojë, kufizimin e mundësisë për të ngritur argumente kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Komisioni, gjithashtu, çmon të theksojë se në referencë të germës “e”, të nenit 102/1, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vonesat dhe zvarritja e përsëritur dhe e pajustificuar e veprimeve procedurale përbën shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit gjyqësor.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarit Neritan Cena. Dy ankesa që janë regjistruar për vlerësim etik dhe profesional lidhen me aftësitë e tij organizative dhe nuk i përkasin etikës në punë.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Neritan Cena dhe dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga dosjet e analizuara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, z. Neritan Cena, nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Evidentohet se subjekti i rivlerësimit ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse, gjuha e përdorur në akte është normale dhe komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

¹³⁷ Neni 43 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë sanksionon parimin: “Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe. Neni 310, paragrafi 3, pika 3 e Kodit të Procedurës Civile parashikon se pjesa urdhëruese e vendimit duhet të përmbajë të drejtën e ankimit dhe afatin për paraqitjen e tij. Neni 443, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Civile përcakton se: “Afati i ankimit në gjykatën e apelit, kundër vendimeve përfundimtare të gjykatës së shkallës së parë, është 15 ditë”.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit Neritan Cena për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Në periudhën e rivlerësimit, subjekti ka marrë pjesë në 12 seminare të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, është angazhuar gjithashtu edhe në procesin e mësimit, bazuar në vërtetimin nga Universiteti Ismail Qemali Vlorë, ku evidentohet se ka qenë personel akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2007 - 2008 dhe vërtetimin nga Universiteti European i Tiranës, ku evidentohet se ka qenë lektor i ftuar në Fakultetin Juridik për vitin akademik 2009 - 2010. Gjithashtu, subjekti ka përfunduar master në shkencat juridike me Drejtim Civil, të cilin e ka përfunduar në vitin 2006, si dhe ka deklaruar se është në proces doktorature në fushën e të Drejtës Civile.

DENONCIMET NGA PUBLIKU

1. Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Neritan Cena, janë administruar 21 denoncime nga publiku: denoncimet nr. *** prot., datë 23.11.2017 dhe nr. *** prot., datë 23.1.2018, të shtetasit S.P., i cili ankohet për shkelje të etikës profesionale, zvarritje të procesit gjyqësor, si dhe dyshon se subjekti i rivlerësimit ka pranuar rryshfete nga pala tjetër duke dhënë një vendim në kundërshtim me ligjin; denoncimi nr. *** prot., datë 1.12.2017, i shtetasit H.M., i cili ankohet për subjektin e rivlerësimit se ka zhvilluar 20 seanca, prej të cilave 3-4 të zhvilluara me sistem audio, pjesa tjetër në zyrën e tij. Denoncuesi ankohet se nuk i është dhënë kohë të paraqesë argumentet dhe mbrojtjen e tij duke dyshuar se gjyqtari dhe eksperti kishin një marrëveshje në disfavor të tij; denoncimi nr. *** prot., datë 1.12.2017, i shtetasit H.M., i cili denoncon 7 subjekte rivlerësimi, ndër ta edhe Neritan Cena, për përfshirje në korrupsion, pasi kanë dhënë vendime në kundërshtim me ligjin dhe bazuar në dokumentacion të falsifikuar; denoncimi nr. *** prot., datë 8.1.2018, i shtetasit B.Gj., i cili pretendon se subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendim të padrejtë në kundërshtim me ligjin, duke mos marrë në konsideratë asnjë provë dhe faktet që vërtetojnë të drejtat e tij në gjykim; denoncimi nr. *** prot., datë 16.1.2018, i shtetasit R.Ç., e cila pretendon se subjekti i rivlerësimit nuk ka kallëzuar pranë organeve kompetente falsifikimin e deklaratës së palës së paditur në procesin gjyqësor, si dhe i ka dhënë provat e dosjes një gjyqtari tjetër të po kësaj gjykate; denoncimi nr. *** prot., datë 3.9.2018, i shtetasit G.B.L., i cili pretendon se subjekti i rivlerësimit ka dhënë një vendim të padrejtë, në shkelje me ligjin duke i mohuar të drejtën e pronësisë; denoncimi nr. *** prot., datë 12.2.2019, i shtetasit A.B., i cili ankohet për 18 subjekte rivlerësimi, ndër ta edhe Neritan Cena. Denoncuesi nuk paraqet asnjë pretendim apo provë ndaj subjektit; denoncimet nr. *** prot., datë 24.5.2018, nr. *** prot., datë 27.6.2018 dhe nr. *** prot., datë 8.10.2018, të shtetasit M.M.I., i cili ankohet për disa subjekte rivlerësimi, ndër ta edhe Neritan Cena. Denoncuesi ankohet për procesin gjyqësor të zhvilluar nga subjekti në vitin 2006 dhe raportin e ekspertizës lidhur me konfliktin gjyqësor që ka për objekt çështje pronësie; denoncimi nr. *** prot., datë 13.4.2018, i shtetasit A.P., i cili pretendon se subjekti i

rivlerësimit ka dhënë vendim të padrejtë duke favorizuar palën tjetër në dëm të tij; denoncim nr. *** prot., datë 25.10.2018, i shtetases V.Xh., e cila denoncon subjektin Neritan Cena për shkelje të etikës profesionale, sjellje arrogante dhe zhvillimin e një procesi gjyqësor në kundërshtim me ligjin; denoncim nr. *** prot., datë 19.12.2018, i shtetasi R.M., i cili ankohet se subjekti në gjykim është bazuar në një vendim inekzistent i konfirmuar nga institucionet përkatëse. Më tej, sipas tij, tri seancat e fundit gjyqësore janë përshpejtuar me qëllim për ta mbyllur gjykimin sa më shpejt.

2. Komisioni, pasi mori në shqyrtim ankesat e mësipërme konstaton se pretendohen fakte që kanë lidhje me korrektësinë e vendimeve dhe themelin e çështjeve të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, rrethana të cilat nuk mund të shqyrtohen nga Komisioni, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit E, fjalës e fundit, faqja 60 nga 64 e Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016. Në këto kushte, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerësohet se këto denoncime nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

3. Ndërkohë nga Komisioni janë konstatuar parregullsi në denoncimet e mëposhtme:

1) Denoncimet nr. *** prot., datë 2.4.2019 dhe nr. *** prot., datë 2.5.2019, të shtetasi J.B., i cili ankohet për zvarritje të procesit dhe vonesë në zbardhjen e vendimit gjyqësor. Komisioni i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë¹³⁸ për të vënë në dispozicion dosjen gjyqësore. Në përgjigjen nr. *** prot., datë 25.6.2020, gjykata na informon se dosja gjyqësore e vendimit nr. ***, datë 25.3.2019, është ankimuar dhe përcjellë në Gjykatën e Apelit Tiranë, në datën 5.7.2019. Më tej, Komisioni me shkresën nr. ***, datë 30.6.2020, kërkoi të vihet në dispozicion kopja e regjistrimit themeltar civil lidhur me zbardhjen e vendimit. Nga përgjigja e administruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë¹³⁹, evidentohet se kjo çështje është regjistruar në datën 24.11.2017. Vendimi është shpallur në datën 25.3.2019 dhe është dorëzuar në datën 28.5.2020. Komisioni konstaton se: (i) gjykimi i çështjes është jashtë afatit 6-mujor të caktuar në germën “e”, të pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit; (ii) vendimi i arsyetuar është dorëzuar pas rreth 2 muajve nga shpallja, jashtë afatit 10-ditor të përcaktuar nga neni 308/2 i Kodit të Procedurës Civile. Në seancë dëgjimore, subjekti bëri një shpjegim të përgjithshëm të arsyeve se përse kishte pasur vonesa, por pa u fokusuar në rastin konkret.

Trupi gjykues vlerëson se tejkalimi i afatit standard të gjykimit nuk përbën shkak autonom për shkarkimin e subjektit, por mbetet një element, i cili është konsideruar nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor që i është bërë kriterit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit.

2) Denoncimi nr. *** prot., datë 20.7.2018, i shtetases R.Rr., e cila ankohet për zvarritje të procesit gjyqësor për 3 vjet rresht dhe dhënien e vendimit të padrejtë nga subjekti i rivlerësimit. Komisioni vëren se pretendimet për dhënien e një vendimi të padrejtë ngrihen mbi themelin e vendimit, i cili nuk është objekt shqyrtimi nga Komisioni, ndërkohë lidhur me

¹³⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 18.6.2020.

¹³⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 6.7.2020.

pretendimet për zvarritjen e procesit gjyqësor, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë¹⁴⁰ për të vënë në dispozicion dosjen gjyqësore. Në përgjigjen nr. *** prot., datë 25.6.2020, gjykata informon se dosja gjyqësore me nr. *** akti, datë regjistrimi 11.10.2011, me palë Gj.B., palë paditëse Gj.B., palë e paditur R.M. etj, me objekt “pjesëtim sendi”, ndodhet në Gjykatën e Lartë, regjistruar me nr. ***. Më tej, Komisioni me shkresën nr. ***, datë 30.6.2020, kërkoi administrimin e dosjes nga Gjykata e Lartë. Pas administrimit të dosjes me shkresën nr. *** prot., datë 10.7.2020, rezulton se çështja me objekt “përpjesëtim sendi në bashkëpronësi” është regjistruar në datën 11.10.2011 dhe ka qenë në gjykim të subjektit A. M., i cili ka dhënë dorëheqjen. Më tej, çështja i ka kaluar subjektit të rivlerësimit, z. Neritan Cena, në datën 14.2.2013 dhe vendimi është dhënë nga subjekti në datën 10.3.2014. Pra, gjykimi nga ana e tij ka zgjatur rreth 13 muaj, jashtë afatit 6-mujor të caktuar në germëb “e”, të pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit. Në seancë dëgjimore, subjekti bëri një shpjegim të përgjithshëm të arsyeve se përse kishte pasur vonesa, por pa u fokusuar në rastin konkret.

Trupi gjykues vlerëson se tejkalimi i afatit standard të gjykimit nuk përbën shkak autonom për shkarkimin e subjektit, por mbetet një element, i cili është konsideruar nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor që i është bërë kriterit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit.

3) Denoncimet nr. *** prot., datë 12.9.2019 dhe nr. *** prot., datë 19.9.2019, të shtetasës D.K., e cila ankohet për zvarritje të procesit gjyqësor nga ana e subjektit të rivlerësimit, si dhe lidhur me dokumentacionin e administruar në gjykim dhe legjitimitetin e avokatit mbrojtës të palës tjetër në proces. Më tej, denoncuesja pretendon se ka kërkuar përjashtimin e subjektit, kërkesë e cila nuk është pranuar.

Komisioni i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë¹⁴¹ për të vënë në dispozicion dosjen gjyqësore. Në përgjigjen nr. *** prot., datë 25.6.2020, gjykata informon se dosja gjyqësore me nr. *** akti, datë regjistrimi 13.12.2018, me palë paditëse D.K., me objekt “lirim, dorëzim sendi... etj”, është akoma në gjykim pranë subjektit të rivlerësimit. Më tej, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë¹⁴² ka përcjellë pranë Komisionit një kopje të dosjes gjyqësore, ku evidentohet se çështja gjyqësore nr. *** është regjistruar në datën 13.12.2018 dhe me shortin e datës 17.12.2018 i është caktuar subjektit Neritan Cena. Gjykimi i kësaj çështjeje është jashtë afatit 6-mujor të caktuar në germën “e”, të pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit. Në seancë dëgjimore subjekti bëri një shpjegim të përgjithshëm të arsyeve se përse kishte pasur vonesa, por pa u fokusuar në rastin konkret.

Trupi gjykues vlerëson se tejkalimi i afatit standard të gjykimit nuk përbën shkak autonom për shkarkimin e subjektit, por mbetet një element i cili është konsideruar nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor që i është bërë kriterit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit.

4) Denoncimet nr. *** prot., datë 4.11.2019 dhe nr. *** prot., datë 22.1.2020, të shtetasve R. dhe I.K., të cilët ankohen për zvarritje të qëllimshme të procesit gjyqësor nga subjekti i

¹⁴⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 18.6.2020.

¹⁴¹ Shkresë nr. *** prot., datë 18.6.2020.

¹⁴² Shkresë nr. *** prot., datë 6.7.2020.

rivlerësimit në çështjen civile nr. ***, datë 15.1.2019, ku nuk është kryer asnjë procedurë e seancës gjyqësore. Komisioni i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë¹⁴³ për të vënë në dispozicion dosjen gjyqësore. Në përgjigjen nr. *** prot., datë 25.6.2020, gjykata informon se dosja gjyqësore me nr. *** akti, datë regjistrimi 15.1.2019, me palë paditëse I. dhe R.K., me objekt “deklarimi i pavlefshëm i të gjitha veprimeve të kryera nga I. P. si administrator i shoqërisë “***” është ende në gjykim pranë subjektit të rivlerësimit. Më tej, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë¹⁴⁴ ka përcjellë në Komision një kopje të dosjes gjyqësore, nga ku rezultoi se gjykimi i kësaj çështjeje është jashtë afatit 6-mujor të caktuar në germën “e”, pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit. Në seancë dëgjimore, subjekti bëri një shpjegim të përgjithshëm të arsyeve se përse kishte pasur vonesa, por pa u fokusuar në rastin konkret.

Trupi gjykues vlerëson se tejkalimi i afatit standard të gjykimit nuk përbën shkak autonom për shkarkimin e subjektit, por mbetet një element i cili është konsideruar nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor që i është bërë kriterit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit.

Në konkluzion të rivlerësimit të aftësive profesionale

Ligji nr. 84/2016 ka përcaktuar se subjektet e rivlerësimit vlerësohen sipas rastit për: (i) cilësi të pranueshme apo të papranueshme në punë; (ii) gjykim të drejtë apo të dobët; (iii) respektim apo mosrespektim të të drejtave të palëve ose viktimave; si dhe (iv) të qenit eficient dhe efektiv në masë të pranueshme apo të qenit joefektiv për të mbërritur përfundimisht në kualifikimin “i aftë”, “me mangësi” apo “i papërshtatshëm”, sipas përcaktimit të pikave “a”, “b” dhe “c”, të nenit 44.

Sipas përcaktimit të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, kriteri i aftësive profesionale të gjyqtarit vlerësohet bazuar në aspektet e njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor, por pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet. Më tej, sipas përcaktimit të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, kriteri i aftësisë organizative, vlerësohet duke shmangur rrethanat, të cilat nuk varen nga magjistrati dhe që kanë efekt negativ në rezultatet e vlerësimit, vlerësohet në drejtim të aftësisë për të përballuar ngarkesën e punës, për të kryer procedurat gjyqësore, si dhe për të administruar dosjet gjyqësore.

Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka demonstruar mangësi të theksuara në mënyrë të përsëritur në një numër të konsiderueshëm çështjesh në aftësitë e tij organizative, duke u gjendur në parashikimet e nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, i cili parashikon se: *“Me anë të kriterit të aftësisë organizative vlerësohet aftësia e magjistratit për të përballuar ngarkesën e punës dhe për të kryer procedurat hetimore ose gjyqësore, si dhe aftësia për të administruar dosjet gjyqësore, duke shmangur rrethanat, të cilat nuk varen nga magjistrati dhe që kanë efekt negativ në rezultatet e vlerësimit. 2. Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës matet duke u bazuar në treguesit për respektimin e afateve ligjore, plotësimin e standardeve minimale kohore, kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje në rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore dhe kohën mesatare për marrjen e vendimit përfundimtar gjyqësor ose të*

¹⁴³ Shkresë nr. *** prot., datë 18.6.2020.

¹⁴⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 6.7.2020.

prokurorisë për një çështje. 3. Në rastin e gjyqtarit, aftësia e gjyqtarit për të kryer procedurat gjyqësore matet duke u bazuar në treguesit për numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje, kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, për shmangien e seancave gjyqësore joproduktive, duke përfshirë edhe mbikëqyrjen e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit”.

Këto konkluzione, duke qenë se lidhen me kriteret e vlerësimit të magjistratëve sipas dispozitave të ligjit nr. 96/2016, kriteret mbi të cilat bazohet Komisioni për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, sipas parashikimit të pikës 1, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, të vlerësuara në harmoni me njera-tjetrën, e çojnë Komisionin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, për shkak të këtyre mangësive në indikatorët e kriterit të aftësisë profesionale, sipas parashikimeve të pikës 4, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “c”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, gjatë ushtrimit të profesionit ka sjellë shkelje të të drejtave të palëve në proceset gjyqësore të trajtuara prej tij, në nivel të tillë që shihen të pamundura të riparohen nëpërmjet programit trajnues në Shkollën e Magjistraturës. Për të gjitha sa arsyetohet më lart, subjekti konsiderohet se është i papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës së gjyqtarit dhe se ndaj tij duhet të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, sipas parashikimit të pikës 4, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Vlerësimi tërësor

Pas vlerësimit tërësor në kuptim të nenit 4, paragrafi 2, të ligjit nr. 84/2016, të kriterit të kontrollit të pasurisë e kontrollit të aftësive profesionale, Komisioni arrin në përfundimin se problematikat e konstatuara në vlerësimin e pasurisë në lidhje me transaksione financiare shumë të diskutueshme dhe paaftësia profesionale për të kryer detyrat tij brenda një standarti të pritshëm, krijojnë dyshimin e arsyeshëm tek cdo qytetar se gjyqtari me sjelljet e tij ka vendosur interesin personal mbi atë të shoqërisë/publikut dhe sundimit të paanshëm të ligjit, duke cënuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë, dhe duke bërë që subjekti të ndodhet në kushtet e pamundësisë për të plotësuar këto mangësi nëpërmjet programit të trajnimit, i gjendur në kushte e parashikimeve të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr.84/2016.

Në përfundim, Komisioni, mbështetur në konkluzionet e mësipërme lidhur me rivlerësimin e kriterit të pasurisë, kontrollin e kriterit të aftësive profesionale dhe vlerësimin tërësor të procedurave të rivlerësimit, konstaton se subjekti i rivlerësimit, z. Neritan Cena, gjendet në kushtet e parashikuara në pikat 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, në pikën 4, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në pikat 3, 4 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në provat që disponon për vlerësimin e pasurisë, vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, vendosi që subjektit të rivlerësimit, z. Neritan Cena, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, t'i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në pikat 3 dhe 5, të nenit D, pika 4, e nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pikat 3, 4 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Neritan Cena, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
 2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
 3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
 4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 6.10.2020.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Roland ILIA

Kryesues

Etleda ÇIFTJA
Relatore

Firdes SHULI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Olsida Goxhaj